Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (159) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
ju uron Gëzuar
Kurban Bajramin!
Shih ofertat në faqen 24

Reportazh

Sa qetësi në Lisivalle!

Nga **ILMI DERVISHI**



11

Histori

Grindja për kufijtë ndërmjet Zogollit dhe Çidhnës

Nga **MUNIR SHEHU**




21

Profil

Publicistika dhe prirjet letrare të Isuf Rashës

Nga **HALIL RAMA, SAKIP CAMI**



19

Reportazh



Lura, parajsa jonë e humbur

Nga **NDUE DEDAJ**

FAQE 10

Turizëm



Bujtina "Shahini"

Nga **OSMAN XHILI**

FAQE 7

RRUGA E ARBRIT:

Janë realizuar 40% e punimeve

Shembjet në tunelin e Murrizit, për herë të parë diskutohet për zgjidhje alternative



RROK GJOKA, PRESIDENTI I KOMPANISË "GJOKA KONSTRUKSION": **"Tuneli do të bëhet! Shembja në tunelin e Murrizit është në një gjatësi 60 metra. Inxhinierët po merren me studimin dhe shumë shpejt do t'i propozojmë Ministrisë së Infrastrukturës zgjidhjet teknike".**

BELINDA BALLUKU, MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË: **"Për ne është shumë e rëndësishme që gjithë vendimmarrja që do të marrim nga ky moment e tutje për sa i përket tunelit të Murrizit të jetë e bazuar në analiza. Për sa kohë marrim vendime bazuar mbi fakte teknike, sigurisht zgjidhja do të jetë e mirë. Nuk e vëmë në dyshim që do të na harxhojë pak më shumë kohë, por ndërkohë jemi zotuar që ky projekt i gjithi duhet të mbarojë para afatit. Shpresojmë që rezultatet që do të dalin nga i gjithë sondimi që ju po bëni në nëntokë të jetë rezultatet që do të na japin një zgjidhje që nuk do na marrë shumë kohë. Megjithatë, ne kemi një plan B, pra, ndërtimin e by pass-it mbi këtë tunel, në rast se nuk kemi mundësi për të proceduar më tutje".**

(lexoni në faqet 2-3)

KONFERENCA SHKENCORE / STUDIMI

Ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive administrative të Klosit e Burrelit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit

Autorë: **SALI BUSHI, RAMAZAN CENI, ZENEL HYSA, AGIM SHENJATARI**

Ndërtimi i rrugës së Arbërit do të zgjojë interes për zhvillimin e turizmit historik e malor. Krahina e Matit nga Qaf Murriza në Qaf të Buallit, Macukull e Shkopet, kudo që të shkelësh është pëllëmbë e histori. Ka të dhëna hitorike që të parët e kastriotëve e kanë origjinën nga Shqefni i Matit ku kemi toponimet, Rrahu i Kastriotit, lagja Kastriot, Varret e Mark Shqefnit (Kastriotit), etj. Vendet dhe objektet historike që mund të vizitohen për gjatë Rrugës së Arbërit e në vazhdim që do t'i shërbejnë njohjes së mëtejshme të historisë nga të gjithë vizitorët vendas e të huaj



NË BRENDËSI:

- Mirë se vini në bujtinën e Haxhi Himës!
- Shoqata Atdhetare "Dibra": "E duam Dibrën"
- Fillimi i punës në Ekspeditën Gjeologjike Peshkopi
- Ramazan Melani i Pejkës
- Turi historik - në gjurmët e Skënderbeut
- Fshati që s'bzan
- Ariu i fshatit tim
- Shërbëtori dhe zotëria
- Udha e mundimshme drejt lirisë
- Një letër që më solli mall dhe se mbaj dot
- I rilindur bashkë me "Rilindësit e kohës sonë"
- Fis shekullor me kontribut për çështjen kombëtare
- Legjenda e legjendave
- Dëshmorët e Sofraçanit
- Homazh për Luan Pustinën dhe Agim Pirdenin

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

RRUGA E ARBRIT: **“Janë**



Presidenti i Kompanisë “Gjoka”: Tuneli do të bëhet! Shembja në tunelin e Murrizit është në një gjatësi 60 metra. Inxhinierët po merren me studimin dhe shumë shpejt do t’i propozojmë Ministrisë së Infrastrukturës zgjidhjet teknike.

Më 18 korrik, ashtu siē është bërë zakon vazhdimisht nga zyra e Kryeministrit, në profilin e tij në facebook është përcjellë një video-informacion 50 sekonda mbi ecurinë e punimeve në Rrugën e Arbërit. Për ndonjë që e njeh terrenin mund të dallojë në to ndryshimet ne ecurinë e rrugës, por për të tjerët është e vështirë. Kjo e ka rritur edhe më shumë spekulimin nëse punimet po vazhdojnë në rrugë apo ato janë ndërprerë.

Gjatë një konference për shtyp më 30 korrik me gazetarët, kryeministri Edi Rama, duke folur për arritjet e qeverisë në infrastrukturë, ka përmendur edhe Rrugën e Arbërit.

“Janë realizuar 40% e punimeve në Rrugën e Arbrit. Është një progres shumë i kënaqshëm dhe falë partneritetit publik, privat, një termi të kriminalizuar si rezultat i shfrenimit propagandistik, shumë shpejt, Dibra dhe gjithë ajo zonë e izoluar prej dekadash, për të mos thënë shekujsh, do të jetë e lidhur me kryeqytetin dhe do të jetë faktikisht një territor i ri, që do të zbulohet në sytë tanë, një jastëk i gjelbër i Tiranës, në një aks me bukuri përrallore dhe me potenciale fantastike”, - tha kryeministri Edi Rama.

Shembja e tunelit të Murrizit ndodhi në mes të majit, por ajo u bë publike në fillim të qershorit, kur një foto iu shpërnda disa portaleve dhe mediave online. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe vetë kompania e pranuan lajmin, por nuk specifikuan se në çfarë gjatësie kishte ndodhur shembja dhe pasojat e saj.

Më datën 2 gusht, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpërndau një video në faqen e saj zyrtare në facebook, ku tregonte një vëzhgim të punës që ministrja Balluku po bënte në dalje të Tunelit të Murrizit, në anën e Klosit.

Duke folur për vështirësitë e hasura gjatë punës, presidenti i Kompanisë “Gjoka” i tha ministres se edhe këtu janë hasur vështirësi, por shpresojmë se pas 30 metrash do të takojmë formacione gëlqerore dhe do të na ndihmojnë për një ecuri më të mirë të punës.

“Para dy ditësh patëm shumë prurje, si përrua dilte, - tha Gjoka. - Tani ka rënë pak uji, pasi po punojnë pompat. Shpresojmë që pas rreth 30 metrash të rregullohet formacioni dhe puna të ecë normalisht”.

Një inxhinier i huaj, që punon pranë Kompanisë, ishte më konkret në shpjegimet e tij. Me një gur në dorë ai tha se: “Ky është një gur, në të cilin po shpojmë tani, që quhet rreshpe argjilore, një lloj guri balte. Ndërsa po gërmojmë, ky lloj shkëmbi, siç e shikoni, mbahet me grila çeliku dhe bulona shkëmborë. Por, kur ky lloj guri has në ujë edhe presion, siç mund ta shikoni, bëhet baltë; është një lloj balte, konsiderohet si një shkëmb shumë i dobët, por mund të punohet me një sistem të fortë mbështetës...”.

Ai shtoi se “presim të hasim gur gëlqeror pas 30-40 metrash, pasi tani jemi në zonën e thyerjes (një thyerje e zgjatur brenda një shkëmbi që shkakton jonjëtrajtshmëri në shtresat shkëmbore të tij- shënim i përkthyesit) mes rreshpës argjilore dhe gurit gëlqeror. Kur të arrijmë gurin gëlqeror, që është me fortësi mesatare, presim që puna të lehtësohet shumë”.

“Nga të dhënat gjeologjike të të gjithë njerëzve këtu në Shqipëri mendohej se rreth 2 km nga Qafë Murrizi në drejtim të Xibrit, do të ishte pjesë gëlqerore-shkëmbore, - thotë në videon e transmetuar presidenti i Kompanisë “Gjoka Konstruksion”. Ai tha se “nga krahu i Tiranës e dinim që është formacioni i dobët, por jo që ka rrëshqitje, dhe rrëshqitje në thellësi shumë të madhe. Dhe kjo pastaj e ka ngatërruar pak punën”.

Ministra Balluku kërkoi të dinte nga Presidenti i Kompanisë “Gjoka” se si po e analizonin këtë situatë dhe cilat do të ishin zgjidhjet.

Rrok Gjoka gjatë fjalës së tij bëri një panoramë të vështirësive të punimeve që kur ato kanë nisur dhe pavarësisht tyre, ai është i bindur se tuneli do të bëhet.

“Që në fillimet e para kur kemi filluar punën vumë re që nuk ishte e njëjta situatë siç ishte parashikuar, - thotë Rrok Gjoka. Bëmë investigimet e para duke vazhduar, duke mos ndërprerë punimet, duke ecur përpara me tunel. Dhe erdhi një moment që konstatuam që situata është shumë më tepër e komplikuar. Mendonim që rrëshqitja në hyrjen e tunelit, ku situata është më e keqe, rrëshqitjet mund të ishin te 20-metërshi dhe pas investigimeve me mjete, me specialistë, rezulton se rrëshqitja është mbi 60 m. Dhe kjo pastaj na detyroi që ta ndalonim në hyrje, ta kalonim këndej nga dalja (Në Xibër- shënimi ynë) për të mos ulur ritmet dhe jemi në përfundim të investigimeve. Besoj se shumë shpejt, punë ditësh, do t’i dalim Ministrisë me propozim e një apo dy variante, të cilat do të vlerësohen se si mund të zgjidhen.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (159). Korrik 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Gusht 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Bernard ZOTAJ
Selman MËZIU
Ndue DEDAJ
Zaim ELEZI
Sali BUSHI
Ramazan CENI
Zenel HYSA
Agim SHENJATARI
Halil RAMA
Sakip CAMI
Munir HOXHA
Beqir SINA
Ilmi DERVISHI
Luan KABA
Zabit Lleshi

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Shembjet në tunel, për herë të parë diskutohet për zgjidhje alternative. Ministrja Balluku: “Shpresojmë që rezultatet që do të dalin nga i gjithë sondimi që ju po bëni në nëntokë të jetë rezultatet që do të na japin një zgjidhje që nuk do na marrë shumë kohë. Megjithatë, ne kemi një plan B, pra, ndërtimin e by pass-it mbi këtë tunel, në rast se nuk kemi mundësi për të proceduar më tutje”.

realizuar 40% e punimeve”

Ministrja Belinda Balluku: “Për ne është shumë e rëndësishme që gjithë vendimmarrja që do të marrim nga ky moment e tutje për sa i përket tunelit të Murrizit të jetë e bazuar në analiza. Për sa kohë marrim vendime bazuar mbi fakte teknike, sigurisht zgjidhja do të jetë e mirë. Nuk e vëmë në dyshim që do të na harxhojë pak më shumë kohë, por ndërkohë jemi zotuar që ky projekt i gjithi duhet të mbarojë para afatit.

Kryeministri Rama: “Janë realizuar 40% e punimeve në Rrugën e Arbrit. Është një progres shumë i kënaqshëm dhe falë partneritetit publik - privat. Shumë shpejt, Dibra dhe gjithë ajo zonë e izoluar prej dekadash, për të mos thënë shekujsh, do të jetë e lidhur me kryeqytetin dhe do të jetë faktikisht një territor i ri, që do të zbulohet në sytë tanë, një jastëk i gjelbër i Tiranës, në një aks me bukuri përrallore dhe me potenciale fantastike”.



Fotot: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

RRUGA E ARBRIT, BALLUKU INSPEKTON PUNIMET NË TUNELIN E MURRIZIT:

Zgjidhje problematikës së rrëshqitjeve, me synim përfundimin para afatit

Mendojmë se mund t’i dalim me një by pass rrëshqitjes, por për momentin nuk kemi akoma një përgjigje përfundimtare. Fjalën e fundit do ta thonë specialistët dhe inxhinierët që po merren me këtë punë. Por, gjithsesi, tuneli do të bëhet.”

“Për ne është shumë e rëndësishme që gjithë vendimmarrja që do të marrim nga ky moment e tutje për sa i përket tunelit të Murrizit të jetë e bazuar në analiza dhe në skanime që vijnë nga nëntoka. Sigurisht, këto të vlerësuara nga ekspertët tuaj dhe inxhinierët”, - tha ministrja Balluku.

Në fjalën e saj Balluku vuri theksin në përfundimet e punimeve para afatit, siç është premtuar, por ndërkohë edhe në gjetjen e zgjidhjeve teknike të specializuara dhe përfundimtare.

“Për sa kohë marrim vendime bazuar mbi fakte teknike, sigurisht zgjidhja do të jetë e mirë. Zgjidhja është komplekse. Nuk e vëmë në dyshim që do të na harxhojë pak më shumë kohë, por ndërkohë jemi zotuar që ky projekt i gjithi duhet të mbarojë para afatit” - tha Ministrja Balluku.

Për të përfunduar punimet në afat, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku përmendi për herë të parë edhe zgjidhje alternative.

“Shpresojmë që rezultatet që do të dalin nga i gjithë sondimi që ju po bëni në nëntokë të jetë rezultatet që do të na japin një zgjidhje që nuk do na marrë shumë kohë. Megjithatë, ne kemi një plan B, pra, ndërtimin e by pass-it mbi këtë tunel, në rast se nuk kemi mundësi për të proceduar më tutje”, tha ajo.

B.KAROSHI

Ruga e Arbrit do të jetë gati dhe e aksesueshme për të gjithë përdoruesit para afatit të parashikuar në kontratë, pavarësisht problematikave të hasura gjatë zbatimit të projektit. Aktualisht në të gjitha veprat e këtij aksi projekti po ecën me ritme të mira dhe punimet po kryhen me cilësi.

Situatë problematike është krijuar vetëm në zonën ku po ndërtohet tuneli i Murrizit, ku përbërja gjeologjike e nëntokës ka shkaktuar rrëshqitje duke krijuar vonesa në ecurinë e punimeve. Prezenca e formacioneve të dobëta të kësaj pjesë të nëntokës ka bërë që inxhinierët dhe specialistët e kompanisë që po kryen punimet kanë nisur punën për gjetjen e një zgjidhjeje që i jep fund kësaj situate.

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, ishte në tunelin e Murrizit për t’u njohur nga afër me ecurinë e punimeve por edhe me problematikat e hasura në këtë pjesë të rrugës si dhe mënyrën sesi po procedohet nga ana e kompanisë që realizon punimet.

“Pas investigimeve me mjete, me specialistë, rezulton që rrëshqitja është mbi 60 metër. Dhe kjo pastaj na detyroi që ta ndalonim në hyrje, të kalonim, për të mos lënë ritmet këtej nga dalja, dhe jemi në përfundim të investigimeve dhe besoj shumë shpejt, punë ditësh do t’i dalim Ministrisë me propozimin e një apo dy varianteve të



cilat do të vlerësohen sesi mund të zgjidhen”, bëri të ditur përfaqësuesi i kompanisë “Gjoka Konstruksion”.

Nga ana e saj, ministrja Balluku u shpreh se pavarësisht problematikave kompania që po kryen punimet është duke e menaxhuar situatën në mënyrë profesionale.

“Çfarëdo që është duke ndodhur sot në këtë tunel tregon profesionalizimin me të cilin ju po e menaxhoni situatën. Kjo është një situatë e vështirë, pavarësisht studimeve që janë bërë, edhe nga Ministria në fillim të projektit, edhe nga vetë kompania, por ka rezultuar që shtresat nëntokësore, formacionet shkëmbore të kësaj zone janë formacione të dobëta, të cilat shpesh herë kanë pësuar rrëshqitje duke krijuar vonesa në punë”, u shpreh Balluku.

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë garantoi se zgjidhja që do t’i jepet këtij shqetësimi do të jetë ajo më optimale, që do të dalë nga analizat dhe vlerësimet që do të bëjnë specialistët dhe ekspertët e fushës.

“Përsa kohë marrim vendime, të cilat do të jenë të bazuara në fakte teknike, sigurisht zgjidhja do jetë e mirë. Është një zgjidhje komplekse. Nuk e vëmë në dyshim që do na harxhojë pak më shumë kohë, por ndërkohë jemi zotuar që ky projekt i gjithi duhet të mbarojë para afatit dhe shpresojmë që rezultatet që do dalin nga i gjithë sondimi që ju po bëni në nëntokë të jenë rezultate të cilat na japin një zgjidhje që nuk do na marri shumë kohë. Megjithatë, siç ju thatë, ne kemi një plan B për krijimin e një bypass-i mbi këtë tunel në rast se nuk do kemi mundësi për të proceduar më tutje”, nënvizoi Balluku.

Përfaqësuesi i “Gjoka Konstruksion” theksoi edhe një herë se pavarësisht problematikave tuneli do të ndërtohet sipas afateve të parashikuara më herët.

Rruga e Arbërit nr. 159

speciale

Me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit do t'i jepet një hop zhvillimit të mëtejshëm jo vetëm ekonomisë, por dhe zhvillimit tëturizmit historik e malor të kësaj treve.

Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Klosit e Burrelit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit të kësaj zone

Autorë: SALI BUSHI, RAMAZAN CENI, AGIM SHENJATARI, ZENEL HYSA

Bashkitë e Klosit dhe Burrelit së bashku me fshatrat të cilat bëjnë pjesë në këto bashki vendosen në pjesën perëndimore të Qarkut të Dibrës. Në Bashkinë e Klosit bëjnë njësitë administrative Klos, Xibër, Suç e Gurrë, ndërsa në Bashkinë e Burrelit bëjnë pjesë njësitë administrative Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis e Ulëz dhe fshatrat që bëjnë pjesë në këto njësi administrative.

RRUGËT LIDHËSE ME RRUGËN E ARBËRIT

Rruga e Arbërit në lashtësi lidhte pjesën lindore të Shqipërisë me portet e Durrësit,Vlorës e Shëngjinit. Ajo ishte nje nyje e rëndësishme transballkanike së bashku me rrugën Egnatia që kalonte më në perëndim. Degëzimet e saj shtriheshin deri ne Prizren, Shkup, Preshevë e më në lindje.

Degëzimet e Rrugës së Arbërit në Mat fillojnë nga Qafa e Murrizës e vendosur në jug-perëndim të luginës së Matit, në kufi me Zall Bastarin.

Nga qafa e Murrizës kalonin dy rrugë:

Qaf Murrize-Guri i Bardhe-Ura e Vashes-Plani i Bardhë-Qaf Buall-Bulqizë-Dibër dhe

Qaf Murrizë-Qafë Shkallë-Klos. Në Klos kemi ndarjen në tre drejtime :

Klos (Dars)-Ura e Halilit-Bel Unjate-Gurrë (krahu perëndimor i luginës së Matit).

Klos-Suç-Shoshaj-Urakë-Perlat-Rrëshen-Lezhë-Shkodër

Klos-Ura e Allamanit-Cërujë-Patin, me dy variante: Varianti veror: Patin-Qaf Dardhë-Qaf Mesi-Qaf Murrë dhe Varianti dimëror: Patin-Kurdari-Gjalish-Lis-Qafë Murrë.

Këto variante mbi dymijë vjeçare, janë të shoqëruara me kala, ura, karakolle, kalldrëme të cilat ruhen pjesërisht deri në ditët e sotme. Rruga e Arbërit ka patur aktivitet të plotë deri në fillim të viteve gjashtëdhjetë.

Deri tani ajo shfrytëzohet nga banorët e Xibrit, Gurit të Bardhë e Valit të Martaneshit si varianti më i shkurtër për t'u lidhur me Tiranën dhe Durrësin. Pothuajse të gjitha fshatrat lidhen me rrugë automobilistike më qendrat e tyre Klosin dhe Burrelin. Rrugët që duan përmirësime, mirëmbajtje dhe ndonjë shtesë rruge e re me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit janë :

Rruga Fundi i Planit të Bardhë-Stavec-Gjon-Krastë (rreth 6 km. rrugë e re) për t'u lidhur me rrugët ekzistuese të zonës së Martaneshit, Batër, Thekën e deri tek Liqeni i Sopeve të cilat duan vetëm përmirësim e mirëmbajtje.

Rruga Qaf Burrel-Qaf Ujku-Maja Burrelit-Liqejt e Allamanit(Kurdarisë,Hysen Begut, etj.)-Qaf Murrë-Kepi i Skënderbeut, nga të cilat 6 km. rrugë e re, pjesa tjetër përmirësim e mirëmbajtje.

Rruga Vinjollë-Manazdre-Qaf Murrë-Kepi Skënderbeut-Guri Vashës-Liqejt e Lurës, nga të cilat 3 km. rrugë e re, pjesa tjetër përmirësim e mirëmbajtje.Rruga Vig-Qaf Kishë-Linos-Daznjan-Shkalla e Deshëve-Macukull, kërkon vetëm përmirësim e mirëmbajtje.

Rruga Qaf Shënkoll-Gjoçaj-Lami i Madh-Kurbnesh-Lurë kërkon përmirësim e mirëmbajtje. Rruga Xibër Hane-Llapush të Gurrës-Qaf Shtamë, nga të cilat 4km. rrugë e re dhe pjesa tjetër përmirësim e mirëmbajtje.



Në foto: Sali Bushi duke mbajtur referimin.

BUQËSIA. BLEGTORIA E FRUTIKULTURA

Rajoni i Matit ka karakteristika të ndryshme klimatike e mjedisore gjë që ka kushtëzuar dhe zhvillimin e orientuar lokal të tyre. Kështu, Xibri, Vinjolli, Manazdreni, Macukulli e Zall Gjoçaj, me një mikroklimë të ashpër, në shekuj kanë qenë shquar për mbarshtrimin e bagëtive të imta, kryesisht dhen dhe dhi. Vetë pozicioni gjeografik me klimë të ftohtë dhe të freskët, me verë relativisht të shkurtër dhe dimër të gjatë nuk favorizonte të mbjellat bujqësore, pemtarinë e vitikulturën.

Nga ana tjetër lugina e Matit karakterizohet nga një mikroklimë e nxehtë dhe e thatë në verë, ndërsa e lagësht dhe e butë në dimër. Një mikroklimë e tillë në shekuj ka favorizuar kutivimin e bimëve bujqësore(misër, grurë, perime, etj.) dhe kultivimin e pemtarisë, veçanërisht vreshtarisë. Matjani në shekuj nuk mund ta konceptonte shtëpinë dhe arën e tij të parrethuar me lloje-lloje pemësh frutore e variatete rrushi, deri në kultivaret lokale me emër në prodhimin e rakisë, verës, mushtit, hardallisë si; rrushi i "Cërujës", "Gjalishit", "Tajga" etj. Aq favorizuese është mikroklima në këtë rajon për rrushin, sa, kronikani i Perandorisë Osmane, Elvia Çelebi, kur kaloi nga Qafa e Thanës (mali i Bejnit), nëpër Shëngjun, Bejnë, Fullqet, Gurra, Frankth për në Qaf Shtamë e Krujë thekson *" ... ishte korrik, por nuk pashe dielle me sy nga tendat e rrushit..."*. Në ditët e sotme në kushtet e ekonomisë së tregut, matjani i është kthyer traditës së herëshmë të kultivimit të gjithë llojeve të frutave deri tek fiku që kultivohet deri në fshatrat e Klosit.



Qafa e Buallit, nyja lidhese e Matit me Dibrën.



Pamje nga kultivaret bujqësore të Fshatit German, pranë qytetit të Burrelit

Ka filluar e vazhdon me inensitet mbjellja e pemëve frutore, rrushit e krahas tyre mbajtja në një numër më të vogël e bagëtive. Produktet e prodhuara, megjthëse cilësore nuk kanë infrastrukturën e nevojshme të përpunimit në rrugë industriale si baxho, punishte rakije dhe vere, fabrikë përpunimi mishi, fabrikë përpunim bimësh industriale etj. Dihet se në botë, por dhe rreth nesh, ka krahina të njohura për prodhim të orientuar si p.sh. krahina e Shampanjës në Francë e njohur për prodhimin e verërave, rajonet e Napolit në Itali, të njohur për prodhimin domates për salcë, rajone të tjerë të njohur për prodhimin e djathrave, proshutës etj. Natyrisht ndërtimi i Rrugës se ArbËrit është mjaft i dobishëm për tregtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale ***Bio,*** të kësaj treve, në tregun e madh të Tiranës.

Hapja e Rrugës se Arbërit do të zgjojë interesin e banorëve të larguar këto vitet e fundit në Tiranë e Durrës, t'ju kthehen trojeve të të parëve të tyre të lëna djerr, për t'i punuar dhe mbjellë, pasi distanca shkurtohet gati ne 1/3 dhe ashtu si dhe bota e përparuar rreth nesh, edhe ne, të banojmë në metropol, dhe të punojme 50 apo 100 km larg. Kjo natyrshëm do të sillte dhe një zbutje të papunësise, por dhe një treg atraktiv, të leverdishëm, cilësor dhe me kosto relativisht të ulët.

Natyrisht kjo rrugë në shekuj nuk ka sherbyer vetëm për transport udhëtarësh, por veçanërisht edhe për transport mallrash. Janë të njohura në shekuj pazaret e Klosit dhe të Lisit që ishin në aks të Rrugës së Arbërit. Në këto pazare tregtarët matjanë, dibranë, krutanë tiranas dhe elbasanas, shkëmbenin mallrat industrial me prodhime bujqësore e blegtorale, traditë që vazhdon deri në ditët e sotme.

PASURITË MINERALE

Me zhvillimin e ekonomisë së vendit veçanërisht pas viteve '50 në Mat morën zhvillim të vrullshëm investimet në industrinë e kromit, energjitikë, mekanikën bujqësore etj. Nga minierat e kromit të Matit dhe Martaneshit janë prodhuar dhe transportuar për në portin e Durrësit mbi 8.5 milion ton krom, me dhjetra milion m^3 lëndë drusore, mermere e gëlqerorë të mermerizuar etj. të cilët kanë të faturuar në koston e tyre për çdo ton dhe m^3 dhe taksën e rëndë të transportit që për fat të keq vazhdon të merret dhe në ditët e sotme nga djersa dhe mundi i banorëve të këtyre trevave. Krahina e Matit dhe është e njohur për pasuritë e mëdha industriale që zotëron. Kështu, përllogariten në disa dhjetra milion ton rezervat e mineralit të kromit (Cr_2O_3), në disa dhjetra milion m^3 rezervat në mermere e gëlqerorë të mermerizuar, gelqerorë pllakorë, argjila industriale e materiale ndertimi, bimë industriale e medicionale, me rëndësi të madhe ekonomike për të sotmen e të ardhmen e kesaj krahine. Duhet theksuar se 90% e pasurive që përmendëm ndodhen në skajin jug-lindore dhe lindore të luginës se Matit, vetëm 10-20 km nga porta e Qaf Murrizës dhe vetëm 40-60km nga metropoli Tiranë-Durrës. Venburimet kryesore të kromit përqëndrohen kryesisht në pjesën veri-perëndimore, qëndrore e jug-perëndimore e perëndimore të masivit ultrabazik të Bulqizës. Në krahinën e Matit bëjnë pjesë vendburimet, objektet dhe shfaqjet e kromit të pjesës veri-perëndimore e perëndimore të këtij masivi, të vendosura në krahun lindor të krahinës së Matit si : Vendburimet e kromit të Cërrujës, Shkallës, Qaf Burrelit, Qaf Dardhës, Majës së Kunorës, Qaf Gjelas, Liqeni i Dhive, Manazdreni lindor e perëndimor, Vinjoll, Vanas e Daznjan. Rezervat gjeologjike prognozë të përllogaritura në disa milionë ton krom nga specialistët e fushës së gjeologjisë, ndodhen afër dhe për rreth këtyre vendburimeve të njohur.




Vendburimi i kromit Shkallë



Vendburimi i kromit Cërrujë

Përveç kromit nga mineralet metalore, në krahinën e Matit kemi dhe vendburimin sulfureve të Nikelit të Qaf Dardhës e shfaqjet e mineraleve sulfure nga Qafë Dardha në Patin, Cërrujë e Shahinaj, Objektet dhe shfaqjet e mineralit të bakrit në zonën Baz-Stojan dhe shfaqjet dhe shenjat e arit në konglomeratet terrigjene të zonës së Kurvajës, për kuarc dhe ar.

Gurët dekorativë karbonatikë e ofiolitikë përfaqësohen nga Gëlqeroret e mer-



Paraqitja grafike e prodhimit të mineralit të kromit, ton/vit në Shqipëri

merizuar të vendburimit të Qaf Shtamës dhe daljeve të Llapush-Xibër-Guri i Bardhë si dhe gëlqerorët pllakorë të Trisaikut të mesëm dhe ranorët pllakorë Cr-Pg të luginës së Burrelit mjaft te perdorshem ne kushtet e sotme te ekonomise se tregut, ne krah te Rruges se Arberit, vetem 10-12 km, ne sasi prej disa dhjetra milion m^3 dhe Me cilesi të mirë. Po ashtu në afërsi të Lisit takojmë vendburimin e gëlqerorëve të mermeriauar të Lisit dhe objektet e Burgajetit e Qaf Kishës, shtrese trashe deri ne masiv me karakteristika fiziko-mekanike cilesore dhe ngjyrë nga të kuqe mishi deri në gri me ndërtim konglomeratik.Nga gurët dekorativë ofiolitikë kemi *Vb i Gurëve dekorativë Lis*

gabrot e Cërrujës e të Krastës dhe dunitet masive të vendburimit të Krastës.

Argjilat industriale ndodhen ne Shoshaj dhe Shëngjun ne sasi prej disa milion ton. Argjilat e Shoshajve, duke u bazuar në vetite fiziko-mekanike dhe përbërjen kimike të tyre, janë të përshtatëshme për prodhim tullash dhe tjegullash. Argjilat kanë kushte të mira tekniko-minerare, për pasojë, shfrytëzimi i tyre nuk kërkon shpenzime të mëdha.

Shkëmbinjtë karbonatikë e ofolitikë, ranorët e inertet lumore si lëndë e parë ndërtimore takohen në të gjithë teritorin e Matit nga Vinjolli, Mbas Deja e Lami i Madh në lindje dhe nga Vali, Guri i Bardhë e Qaf Shtama në perëndim, në gropën e Burrelit dhe shkëmbinjtë ofiolitikë nga Plani i Bardhë në Shahinaj, Qaf Dardhë e deri në Vinjoll, Vanas e Daznjan. Në zonën e Matit kemi dhe inertet lumore të shtratit të lumit Mat dhe daljet kuarcore të zonës Derjan-Urxallë-Rremull-Shtjefën dhe shfaqjet e qymyreve në zonën Rripë-Gurrë.

Duhet theksuar se për të ardhmen, mbetet e hapur perspektiva për kërkimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e mineraleve dhe shkëmbinjeve industrial të territorit të Matit, për të zbuluar dhe vënë në shërbim të ekonomise potenciale te reja mineralmbajtëse dhe fusha të reja kërkimi, zbulimi e shfrytëzimi.

PASURITË UJORE TË KRAHINËS SË MATIT

Ndër pasuritë ujore më të rëndësishme të krahinës së Matit janë lumi i Matit që e përshkon krahinën nga Martaneshi në Klos, Suc e deri sa dershet ne liqen, Liqeni i Ulzës, liqeni i Shkopetit, liqejt malorë të Balgjajt e Fush Balgjajt e të Allamanit (Kurdarisë, Hysen Begut, Petritit, Dhive, etj.), përrejt që derdhen në lumin e Matit në të dy anët e luginës si Përrejt e Bejnit, Cërrujës, Lusës, zalli i Kurvajës, Përroi i Flimit, e lumi i Urakës në krahun lindor dhe Përrejt e Mashnorit, Darsit, Rripës, Batrës, Germanit,



Liqeni i Shkopetit



Liqejt e Balgjajt

Bazit, Bushkashit, Ulzës e Shkopetit në krahun përëndimor, si dhe burimet e freskëta të Gurrës së Linosit, Gurrës së Vinjollit e Gurrës së Shlliut, si dhe shumë burime të tjera të vogla me ujë të pjshëm në të gjithë krahinën e Matit.



Burimi i Shutrisë



Stalagtite të shpellës së Blazit

TURIZMI HISTORIK E MALOR

Ndërtimi i rrugës së Arbërit do të zgjojë interes për zhvillimin e turizmit historik e malor. Krahina e Matit nga Qaf Murriza në Qaf të Buallit, Macukull e Shkopet, kudo që të shkelësh është pëllëmbë e histori. Ka të dhëna hitorike që të parët e kastriotëve e kanë origjinën nga Shqefni i Matit ku kemi toponimet, Rrahu i Kastriotit, lagja Kastriot, Varret e Mark Shqefnit (Kastriotit), etj. Vendet dhe objektet historike që mund të vizitohen për gjatë Rrugës së Arbërit e në vazhdim që do t'i shërbejnë njohjes së mëtejshme të historisë nga të gjithë vizitorët vendas e të huaj janë :

Pjesë kalldrëmi i Rrugës së Arbërit në Gur të Bardhë, Ura e gurit me hark e Gurrës në hyrje të Gurit të Bardhë, Urat e gurit me hark e Kulmares, Ura e Gurit e Hoxhës, Ura e Gurit e Cime Toskës në Gur të Bardhë, Ura e Gurit me hark e Vashës mbi lumin Mat, Kalaja e Petralbës përball Gurit të Bardhë shtëpia e dytë e Skënderbeut, Kalaja e Xibrit dhe Kalaja e Cërrujës, Lugina e Valit, Kisha e Varri monumental (Suç), Kuvendi i Dukagjinit (dhjetor 1601-shkurt 1602) në Qafën e Shën Kollit ku muarën pjesë 2656 delegatë nga 14 krahina të vendit, Përmendorja e formulës së pagëzimit në Qaf Kishë (Macukull) (shkruar nga Pal Engjëlli kryepeshkop i Durrësit, këshilltar i Skënderbeut, më 1462),etj. Në këtëteritor ndeshen edhe shumë ndërtesa guri me frengji, me dritare të vogla me kapakë, me shkallë druri e guri nga brenda e nga jashtë, me telis dhe me oxhaqe si : banesat e Veli Domit, Elmaz Dezhgiut e Xhelal Bodës (Guri i Bardhë), Rexhep Karait (Dars), Bajram Allushit e Rexhep Lleshit (Klos Katund), Hysen Dodollit (Bejn), kulla e Çelës (Patin), Kullat e Abdulla Zylfit e Ali Selës (Kurdari), kullat e Emaz Muharemit e Sul Lëkursit (Gurrë e Madhe), banesat e Asllan Hutës e Jakup Kurtit (Plani i Bardhë) etj.



Kalaja e Petralbës, në sfond lugina e Matit,Klosi



Fshati Shkalle, në sfond kalaja ilire e Xibrit



Ura e gurit me hark e Vashës



Lapidari Kuvendit Dukagjinit



Lapidari Formulës së Pagëzimit

GJEOMONUMENTET, HIDROMONUMENTET E MONUMENTET E NATYRËS

Ndërtimi i rrugës së Arbërit dhe përmirësimi e ndërtimi i rrugëve të reja lidhëse më atë do t'i japë një zhvillim të mëtejshëm edhe turizmit rural e malor në krahinën e bukur të Matit. Gjatë zhvillimit të turizmit malor në gjithë teritorin e Matit ndeshen gjeomonumente, hidromonumente e monumente të natyrës si :

Vendburimi i kromit të Shkallës (në formë tubi), Vendburimi Cërrujë, Guri i Gjatë në Urxuall (Derjan), Kepi i Skënderbeut (Varosh), Guri i Vashës (Mbas Dejë), Maja e Boshtrës, Puset e Valcës (Macukull), Kanjoni i Urakës, Kanjoni i Flimit (Dukagjin) Kanjonet e Unxës-Shqefën-Rremull, Kroi i Gjeneralit (Vakëf Guri Bardhë), Burimi i Shutresë (Laç,Urakë), Shpella e Sekes, Shpella Urxall, Shpella e Nezirit, Shpella e Blazit, Guri i Hijes, Lisi i Qershizës (JL Ulzës), Lisi i Tushës(Frankth), Lisat e Shkollës, Ram Pores, Lisi i Varrit të mirë, Lisi te varret e Kurmetës (Macukull), Lisi i Qaf Shënkolit (Dukagjin), Lisi i Bërshinit (Klos), Lisi i Kodrës Varreve (Urxall), Lisi te varret e Shqypit (Barbullej), Lisi te varret e Kurmetës (Shqefën), Lisi i Teqesë Domit (Batër,Komsi), Lisat e Kishës dhe Bërshini (Groshot,Dukagjin), Lisat e Mbas Dejës(Vinjoll), Rrapi i Çelës (Patin),Rapi i Marqethit (Lis) e Rrapi i Zabelit (Gurrë e Madhe), etj.



Shpella e Sekes



Shpella në Urxallë



Guri i Hijes



Shpella e Nezirit



Shpella e Blazit

Mbështhtetur në këto bukuri të natyrës së luginës së Matit dhe maleve për rreth në çdo drejtim mund të organizohen Guida turistike malore. Me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit do ti jepet një hop zhvillimit të mëtejshëm jo vetëm ekonomisë, por dhe zhvillimit tëturizmit historik e malor të kësaj treve.

Pritja tradicionale, gatimi tradicional e mbi të gjitha njerëz të mirë, bujarë e mjaft mikpritës.

Mirë se vini *në bujtinën e Haxhi Himës!*

Nga **MUNIR HOXHA**



Ekush ka kaluar qoftë edhe njëherë të vetme nëpër Radomirë dhe nuk është magjepsur me mrekullitë që natyra është treguar bujare duke ua falur të gjitha këtyre banorëve fisnik, bujar e mikpritës.

Radomira është një ndër ata fshatra të Dibrës që është vizituar dhe vazhdon të vizitohet si rrallë fshat tjetër nga vendas por edhe turistë të huaj. Mjafton njëherë të futesh në këtë fshat e do të mbetesh mysafir i përhershëm. Këtu jo vetëm natyra por edhe bujaria e mikpritja e vetë banorëve ka bërë të mundur që miq e të ardhur të ketë vazhdimisht, jo vetëm tani në stinën e bukur të verës por edhe në dimër. Ka hotele të bukur me të gjitha kushtet që pa frikë konkurrojnë me hotelet më të bukura në metropolin shqiptar, ka shtëpi të thjeshta fshati që presin mysafir, por ka edhe bujtina.

Dhe një bujtinë e bukur, e veçantë e kthyer edhe në hotel është edhe ajo e Haxhi Kasem Himës. Sapo futesh në Radomirë të gjithë të drejtojnë tek bujtina e Haxhiut. Sofra është e shtruar, ajo pret e përcjell miq, shokë e mysafirë. Pritja tradicionale, gatimi tradicional e mbi të gjitha njerëz të mirë, bujarë e mjaft mikpritës.

Në bujtinën e Haxhi Himës harron të flesh e harron edhe të zgjohesh në mëngjes. Këtu jo vetëm ushqimi por edhe gjumi bëhet ndryshe. Veleshica, ky përrua është një orkestër gjigante që mbart brenda dhjetëra e dhjetëra instrumente muzikor ku melodia ndryshe është në stinën e verës e krejt ndryshe në stinën e dimrit. Stinës së verës në këtë bujtinë në dhomën tuaj mundësisht dritaren mbaje hapur se jo vetëm melodia karakteristike e Veleshicës, por futen furishëm dhe cicërimat e shumtë të zogjve si dhe aroma gudulisëse e luleve të ndryshme. Ndërsa në stinën e dimrit ngrohja është edhe me dru, me një oxhak karakteristik në qoshe, edhe me sistem ngrohje, kaldajë.

Në bujtinën e Haxhi Himës harron të flesh e harron edhe të zgjohesh në mëngjes. Këtu jo vetëm ushqimi por edhe gjumi bëhet ndryshe. Veleshica, ky përrua është një orkestër gjigante që mbart brenda dhjetëra e dhjetëra instrumente muzikor ku melodia ndryshe është në stinën e verës e krejt ndryshe në stinën e dimrit.

E veçanta e bujtinës së Haxhiut është kryesisht guzhina, gatimi tradicional i zonës dhe ku të gjitha janë natyrale. Kosi i deles që nuk dallon shumë me djathin, zarzavatet të gjitha prodhime në vend e pa shumë pesticide pasi vetë klima e Radomirës ndikon pozitivisht në rritjen e tyre të shëndetshme e mjaft të shijshme dhe me kalori.

Mishi, që jo vetëm nga gatimi apo pjekja në tavë, por edhe cilësia, pasi bagëtitë këtu ushqehen me lulet e bjeshkëve dhe pinë ujë nga burimet e shumta që ka zona.

Gatimi i krahinës dhe i veçantë domosdo që është flija një gatim i lodhshëm dhe mjaft i vështirë, por që amvisat e Radomirës kurrë nuk lodhen për të gatuar për miq e mysafirë të ndryshëm.

Ne treguam vetëm pak. Të tjera ju presin kur të shkoni dhe qëndroni një natë në këtë bujtinë rrëzë Korabit. Kuajt janë të gati. Mbi samar qëndrojnë lëkurët e dashit ogiç, ku vetëm presin kalorësit ti shalojnë për tu ngjitur lart deri në Korab, për të takuar diellin , hënën, yjet, bukuritë e rralla të këtij mjedisi që nuk ua ka parë syri kurrë më parë. Provojeni miqtë e mi se do të mbeteni gjithmonë peng i Radomirës, peng i bujtinës së Haxhi Himës. Mirë se vini në bujtinën e Haxhi Himës!

Shoqata Atdhetare "Dibra" nga SHBA: "E duam Dibrën"

Aktiviteti i radhës në qytetin e Dibrës, Shoqatës Atdhetare "Dibra" nga SHBA, në bashkëpunim me Klubin Bjeshktar & Çiklist "Dibra", që e organizuan një ngjitje në malin e Stogovës

Nga **BEQIR SINA**

DIBËR: Kryetari Dashnor Miftari, dhe disa anëtar të kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dibra", nga New York - SHBA, të cilët ndodhen me pushime verore në qytetin e Dibrës së Madhe, vendlindjes së tyre, së bashku me familjet, shkruan në faqen e tyre në rrjetin social Facebook, se: "Në emër të SHAD, falënderojnë Klubin Bjeshktar & Çiklist "Dibra", për këtë bashkëpunim si dhe për angazhimin e tyre maksimal që ç'do gjë të shkojë në mënyrën më të mirë të duhur".

Gjithashtu, ata falënderojnë të gjithë vëllezërit dhe motrat tona nga SHBA-të dhe Europa, të cilët ju bashkëngjitën këtij aktiviteti, duke i dhënë edhe më shumë peshë dhe rëndësi veprimtarisë. "Na ndajnë oqeane dhe kilometra, por kur dëshirojmë të organizojmë diçka sëbashku nuk na ndalon asgjë, këtë e dëshmon edhe e diela e fundit që sapo kaloi me rreth 100 pjesëmarrës u ngjitëm në majën e Stogovës," shkruan SHAD në satusin e saj në rrjetin social FB.

Më tej ata sqarojnë në këtë njoftim se në këtë aventurë të bukur nuk mungoi zbavitja, bisedat me bashkatdhetarët tanë, ajri i pastër, peizazhet e bukura të qytetit tonë të dashur të Dibrës, që më së shumti i emocionoin pjesëmarrësit e këtij marshi. Dibranët në Amerikë, të cilët për çdo verë nuk e harrojnë Dibrën, që ata e duan shumë, dhe bëjnë aq shumë për vendlindjen e tyre, me të cilën ata mburren në SHBA, thonë se edhe ky aktivitet si shumë aktivitete të tjera që organizojnë ata me bashkëqytetarët e tyre, nga Europa, Australia dhe SHBA - Kanada, kam i mirë se pritur dhe i vlerësuar nga dibranët, të cilët iu bashkëngjitën aktiviteteve verore, të kurbetqarëve dibran në kujdesin dhe organizmin e Shoqatës Atdhetare "Dibra", me organizatat dhe aktivist të Dibrës. Duke folur për ngjitjen në mal në kurorën e qytetit të Dibrës, malin e Stogovës, ata thonë: "Gjithçka, kaloi më mirë se e planifikuam, ngjitjen e bëmë me ecje, disa me motor e dikush me makina terreni gjithçka për të shijuar dhe kënaqur pjesëmarrësit dhe të dëshmojmë se edhe ne kemi mundësinë e sporteve të ndryshme. Para nisjes dhe pas ngjitjes në majën e Stogovës të gjithë pjesëmarrësve u shërbyem ushqim, ujë dhe fruta që ta bëjmë këtë ngjitje më atraktive."



Ndërkohë, shpërndajnë edhe mesazhe falënderimi, sidomos për fabrikën e ujit "Maya" që ofroi ujin falas, kompaninë "Dashi Komerc" që mundësoi 120 sanduiçët për pjesëmarrësit, ujë dhe fruta, shoqatën atdhetare "Dibra" që mundësoi nga një bluzë me logon e Klubit dhe SHAD nën moton " E duam Dibrën" dhe për lajmërimin që e ngjitëm në qytet.

Falënderimet nuk munguan për Butrint Selën që transportoi ushqimin, ujin dhe frutat në majën e Stogovës si dhe ndihmesën e tij financiare për mbulimin e transportit të pjesëmarrësve deri në fshatin Broshticë dhe kthimin. Klubi mbuloi shpenzimet e frutave dhe të tjera. Gjithashtu, Spitalin e Dibrës që gjatë aktivitetit të kemi ekipin e ndihmës së shpejtë dhe autoambulancën në afërsi gjatë gjithë aktivitetit"Dhe, natyrisht, që një falënderim shkon me këtë rast edhe për të gjithë pjesëmarrësit që ndihmuan që ky aktivitet të mbetet në kujtim të bashkëatdhetarëve tanë për një kohë të gjatë dhe dhanë mundësinë që të njohin bukuritë e vendlindjes së tyre nga afër. Një set me fotografi prej tyre, shprehen ata në njoftimin e SHAD, fletë më shumë se "1000 fjalë", për atë që s'mund të përshkruajnë fjalët, shkruhet në njoftimin e Shoqatës Atdhetare "Dibra".

NJOFTIME

Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastet kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një faturë të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE.

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**
ose në faqen tonë
www.rrugaearberit.com

Më 1 gusht të vitit të kaluar erdhën turistët e parë amerikanë, një grup prej nëntë vetash. Shumë e shumë të tjerë e pasuan ardhjen e tyre dhe deri më 1 tetor, numri i përgjithshëm kishte shkuar në 250 veta.

Bujtina "Shahini"

Nga **OSMAN XHILI**



Rabdishti është futur në listën e njëqind fshatrave turistikë të Shqipërisë. Rruga për të shkuar atje, nis nga xhamia e vjetër e qytetit, vazhdon drejt Llixhave të Peshkopisë, një mrekulli që Zoti ia ka falur njerëzimit. Më pas një hapësirë e gjerë, para se të ndahen rrugët për në katër fshatrat e Bellovës, që qëndrojnë si ballkon i qytetit.

Jo më kot Rabdishti është futur në listën e njëqind fshatrave turistikë të Shqipërisë. Rruga për të shkuar atje, nis nga xhamia e vjetër e qytetit, vazhdon drejt Llixhave të Peshkopisë, një mrekulli që Zoti ia ka falur njerëzimit. Më pas një hapësirë e gjerë, para se të ndahen rrugët për në katër fshatrat e Bellovës, që qëndrojnë si ballkon i qytetit. Dikur ky shesh kishte plepa dhe akacie e sërish sot mund të kthehet sërish në një atraksion për banorët e qytetit, me vetëm pak sistemime dhe mbjelljen e pemëve dekorative. Rruga vazhdon të jetë po ajo e para viteve nëntëdhjetë, e lodhur, e gërryer nga vërshimet, e ngushtë dhe e rrezikshme. Politikanët shkojnë andej në dy apo në katër vjet, sa për të vjelë votat, kurse banorët e kësaj zone udhëtojnë mbi gjysmë ore, kur mund ta bënin në më pak se pesë minuta, po të ishte e asfaltuar. Asnjë tabelë që të tregojë se Rabdishti është shpallur fshat turistik, asnjë tabelë se ka një bujtinë që pret turistë. Vetëm kur ke sosur në fshat, diku në mesin e rrugëve të kalldrëmta, punuar me shije, sheh një të tillë, ku lexohet "Bujtina Shahini".

BREZAT E FAMILJES SHAHINI

Çdo njeri dëshiron të përmendë dhe pse jo dhe të mburret pak me të parët e tij. Sabri Shahini ka arsye te forta që ta kthejë kujtesën pas në kohë e në histori, të paktën deri te stërgjyshi i tij Nezir Hoxha, Shahini. Ai pati studiuar në Stamboll për teologji, po dhe për mjekësi. Ishin dy dije që aq shumë duheshin atëherë e po kaq shumë duhen akoma dhe sot. Të kishe xhevahire të tilla në fshat, ishte një dhuratë nga Zoti dhe Nezir Shahini i bëri më së miri këto dy funksione. Ai shërbeu gjithë jetën si misionar i fesë islame dhe po kaq kohë mjekoi e shëroi me mijëra njerëz, atëherë kur mjekët ishin të rrallë e numëroheshin me gishtat e njërës dorë. Ata kishin njohuri të mjafta për kohën për anatominë dhe fiziologjinë e njeriut. Përgatisnin pomada dhe melheme të mrekullueshme me lulet e bjeshkës, përdornin dhe bisturinë, kur ajo ishte e nevojshme. Shëronin njerëz me ilaçe, por dhe me shpresën dhe fjalën e mirë, që ngjiste si balsam.

Sabriu, stërnipi i tij, i ruan me fanatizëm një komplet veglash kirurgjikale të përdorura prej të parëve të tij. Themi në shumës, prej të parëve, pasi Lazimi, djali i Nezirit dhe gjyshi i Sabriut ishte po aq i aftë sa babai në rolin e imamit dhe të doktorit. Sheh këtë koleksion veglash dhe habitesh, pasi janë aktuale dhe për sot. Gjen aty pinca anatomike për bllokimin e enëve të gjakut, bisturi për hapje absesesh dhe operime te lehta, pinca dentistësh për heqje dhëmbi, pompë për azmatikët, çantën që i mbante këto vegla, sot të gërryer e dalë boje dhe plot gjëra të tjera të kësaj natyre. Sabriu dëshiron të hapë një minimuze dhe përveç këtyre që përmendëm dëshiron të ekspozojë tezgjahun e përdorur nga gjyshja dhe nëna e tij, grirësen e vjetër të duhanit, mullirin që përgatiste grurin për bungur. Objekte më të vonshme se këto do të jenë radio Iliria, fenerë të vjetër, ibrikë kafeje apo dhe të tjerë elementë të vjetërsisë, që mund të jenë në shtëpitë e banorëve të tjerë të fshatit.

Pronari i bujtinës, Sabri Shahini, të del përpara dhe me një buzëqeshje në fytyrë dhe me fjalë mirëseardhje të prin përpara drejt shtëpisë. Nuk është e sotme kjo mënyrë sjellje dhe as e stisur e artificiale. Ajo është një traditë e hershme, aq sa dhe jeta e këtyre banorëve fisnikë e zemërbardhë.

Lazimi i ri është vëllai i madh i Sabriut. Ai është mjeshtër ndërtimi, por sidomos i punimit të gurit. Kjo lloj mjeshtërie ka qenë tipike për banorët e fshatit. Njazi Shahini, Ramë Seferi, Ali Shahini, Kamber Braha, Vahid dhe Rahman Nesimi, ndoshta dhe shumë të tjerë mund të kenë qenë po kaq të shquar, sa mjeshtërit e gurit të Gjirokastrës. Sot kjo traditë mbahet gjallë akoma, ku përveç Lazimit me dy djemtë e tij, janë dhe Rahman Braha, Demë dhe Flamur Nesimi, që kanë kryer punime vërtetë të mrekullueshme.

Sabriu tregon se deri në vitin 1972 kemi jetuar bashkë katër familje me 47 persona gjithsej. Kryetar i familjes së madhe ishte mixha Qerim, më i madhi i vëllezërve të babait. Pas ndarjes, Sabriu mbaroi shkollën tetëvjeçare dhe nuk vazhdoi më tej, edhe pse notat i kishte shumë të mira. Një "njollë" në biografi dhe vështirësitë ekonomike të kohës e ndaluan arsimimin e mëtejshëm, një brengë e madhe për të, që u lehtësua disi më vonë. Me përpjekje dhe vështirësi të panumërta, duke u endur si emigrant në Maqedoni, në Greqi dhe Itali, Sabriu arriti të shkollojë në mënyrë të shkëlqyer dy djemtë e tij, Erionin dhe Donaldin.

SI LINDI IDEJA E BUJTINËS?

Pronari i bujtinës, Sabri Shahini, të del përpara dhe me një buzëqeshje në fytyrë dhe me fjalë mirëseardhje të prin përpara drejt shtëpisë. Nuk është e sotme kjo mënyrë sjellje dhe as e stisur e artificiale. Ajo është një traditë e hershme, aq sa dhe jeta e këtyre banorëve fisnikë e zemërbardhë. Vërtet habitesh kur Sabriu tregon se aty kanë bujtur kategori të ndryshme udhëtarësh. Aty vinin romët në kohë vere për të shitur kuaj e mushka, por dhe shporta e kanistra, që i bënin vetë, me thupra nga shelgjet e fshatit. Aty vinin kallajxhinj nga Përmeti, që kallaisnin enët e bakrit të banorëve. Nga Mirdita vinin njerëz që shisnin katran, ashtu siç vinin dhe banorë të Tanushës, nga ana tjetër e malit, që sillnin në treg shega druri, sofra dhe punime të tjera artizanale prej druri. Të gjithë këta njerëz kishin pirë një kafe, një çaj, kishin ngrënë një drekë, apo kishin ndenjur dhe një natë, apo më gjatë akoma te shtëpia e Sabriut, por dhe te shtëpi të tjera të fshatit.

Ishte kjo traditë dhe kjo rrugë e shtruar që herët nga të parët e tij, e cila i dha një ide të re, për ta ngritur atë në një stad tjetër, të hapte bujtinën e parë në fshat për turistë vendës dhe të huaj. Kështu mori rrugë projekti, i ndihmuar fuqishëm dhe nga fondacioni gjermano - danez Gizi, që mbuloi mbi 60 për qind të shpenzimeve, për ta përshtatur e akomoduar bujtinën për vizitorët e ardhshëm. Sabriu shpreh konsideratë e mirënjohje për fondacionin në fjalë, por në veçanti për Dali Horeshkën, koordinatorin e tij për qarkun e Dibrës.

Më 1 gusht të vitit të kaluar erdhën turistët e parë amerikanë, një grup prej nëntë vetash. Shumë e shumë të tjerë e pasuan ardhjen e tyre dhe deri më 1 tetor, numri i përgjithshëm kishte shkuar në 250 veta. Ata janë nga vende të ndryshme, por dhe nga kontinente të ndryshme. Vijnë turistë nga Gjermania, Amerika, Franca, Holanda, Suedia, Anglia, pse jo dhe nga Australia e largët. Sabriu i qeras me çajra të ndryshëm, mali, bjeshke, boronice, trëndafili të egër, me komposto, reçelna e turshi të të gjithë llojeve, u gatuan fasule, sarmë dhe jufka të vendit. Qumështin, kosin, djathin e ndonjë gotë dhallë i ka prej lopës që e mban vetë. Mishin e qengjit e merr te komshiu i tij, Uzri Ismaili, që ka një tufë prej gati 200 krerësh. Por mbi të gjitha, i qeras me fjalët e ëmbla, me pritjen e ngrohtë dhe gatishmërinë për t'u shërbyer në çdo rrethanë. Sabriu e kupton se miqtë kanë mbetur të kënaqur, sepse, pasi ka mbaruar prenotimi, turistët pyesin nëse munden të shtojnë dhe një natë tjetër në axhendën e qëndrimit aty. Një familje suedeze prej katër vetash qëndroi katër net dhe fëmijët e çiftit donin të qëndronin akoma. Sabriu lidh miqësi e ka shkëmbim mesazhesh me shumë nga njerëzit që kanë ardhur. Ne folëm për turistë të huaj, por mos harrojmë se ka dhe shumë vendas, nga Peshkopia, nga Tirana apo nga ndonjë rreth tjetër dhe rrethi i vizitorëve vjen e zgjerohet përherë e më tepër.

HARTA E DONALDIT DHE PROJEKTET E REJA

Donaldi është djali i dytë i Sabriut. Ai është inxhinier informatike dhe programim kompjuteri. Sapo ka mbaruar studimet e larta në Norvegji dhe pritet të fillojë punë atje. Ai mendoi se një hartë e thjeshtë e fshatit do t'u shërbente mjaft turistëve të huaj, për të nxjerrë prioritetet e atraksioneve të fshatit. Ai e filloi me Izvorin me ujë të ftohtë, aty ku rruga e Rabdishtit ndahet me Bellovën. Harta vazhdon me dy pishat, lart, karshi fshatit, që askush nuk i mban mend sa të vjetra janë. As tregimet e të parëve, gojë më gojë, nuk hedhin dritë mbi vjetërsinë e pishave. Pak më sipër pishave ndodhen pesë-gjashtë tunele, ndërtuar në kohën e komunizmit, që janë aq të ngrohta në dimër dhe shumë të freskëta në verë. Jo shumë larg gjendet dhe një liqen i vogël, që shërben për vaditje. Në krahun tjetër janë stanet dhe posta kufitare e dikurshme, Kroi i Plakës dhe Livadhi i Peshkut, që dikur mendohet të ketë qenë një liqen akullnajor. Ia vlen të vizitohet Hurdha e Hamekut, që është një pjesë bjeshke disi e veçuar, Piramida me numrin tetë, si dhe tre katër ujëvara të bukura. Të gjitha këto vende mund të përshkohen me pak lodhje dhe brenda një dite. Kjo ishte arsyeja që Donaldi formatoi hartën e fshatit, që t'i orientonte të huajt, se ku mund të shkonin dhe për sa kohë mund ta realizonin vizitën e çdo objekti.

Sabriu ka shumë projekte të reja në mendjen e tij. Ai nuk synon vetëm për bujtinën e tij se atë e ka kompletuar më së miri. Do që të tjera bujtina e shtëpi pritëse të fillojnë aktivitetin. Dhe këtë po e bën edhe Fitim Goleci, një djalë shumë punëtor e vizionar. Ai ka mbjellë gati një hektar pemëtore dhe po i shërben me përkushtim. Pranë pemëtores së tij kalon një rrugë, që vendasit e quajnë rruga e Grabisë, gati 10 kilometër e gjatë. Një grup specialistësh zviceranë e kanë parë atë si mjaft të përshtatshme për ecje me biçikleta, me motora, pse jo dhe për hipizëm. Ndërhyrje të vogla duhen bërë te ujëvarat, ku ka pak rrëshqitje, te pishat për të krijuar një farë ballkoni. Duhet ndërtuar dhe një urë aty te përroi, ku fillon dhe rruga për në fshatin e Zagradit.

Sabriu ka rreth 200 rrënjë qershi, që kanë hyrë në prodhim. Ka dhe një kopësht ku kultivon patate, qepë dhe perime të tjera, të cilat ua shërben miqve të tij. Në planet e tij të afërta është dhe një minifermë me viça, me qengja, keca e pula, duke afruar mish sa më të freskët e cilësor për miqtë e tij të shumtë.

Po a do mundej vallë Sabriu, jo ta zhvillonte, por dhe ta mendonte idenë e turizmit, po të mos kishte në krah Festimen, bashkëshorten e tij, një amvisë të përkryer, një kuzhiniere fort të zonjën? Ajo është bijë e Mehmetajve të Trepçës, aq të përmendur në punë, bujari e mençuri. Të dy së bashku krijuan folenë e re, përballuan sfidat e jetës, lindën, rritën dhe shkolluan Erionin dhe Donaldin, dy fëmijë të mrekullueshëm, që nderojnë, jo vetëm familjen e fshatin, por Dibrën e më gjerë akoma. Pas studimeve të larta për jurist në Shkodër, Erjoni, djali i madh, fiton një bursë studimi në Rusi. Ai ka punuar me amerikanë, me kinezë, me turq, duke fituar eksperienca të reja. Të dy vëllezërit flasin nga katër pesë gjuhë të huaja e sërish janë aq të thjeshtë e modestë. Familja Shahini mbetet një shembull frymëzimi, një model i punës dhe inteligjencës, i bujarisë dhe i patriotizmit.







Rruga e Arbërit nr. 159
kujtime

Shkëputur nga libri "Një jetë maleve" - Kujtime 2" i prof.dr. Bashkim Lleshi

NJË JETË MALEVE
BASHKIM LLESHI
Kujtime 2

Botimet M&B
ISBN 978-9928-256-77-5
Çmimi: 1000 lekë

Fillimi i punës në Ekspeditën Gjeologjike Peshkopi

Para përfundimit të zborit ushtarak dolën emërimet për në punë të gjithë studentëve që mbaruam në vitin 1968. Mua më emëruan Inxhinier gjeolog në Ndërmarjen Gjeologjike të Bulqizës. Pasi bëra 10 ditë pushim pas zborit më 10 shkurt 1969 u paraqita për të filluar punën. Në atë periudhë, drejtor i Ndërmarjes ishte Ferit Alla nga Bulqiza dhe kryegjeolog Sefedin Qorlaze nga Kërçishti i Maqellarës.

Si gjeolog i ri që isha më caktuan në Ekspeditën Gjeologjike të Peshkopisë, në Ekipin e Lurës. Pasi bëra regjistrimet në degën e Kuadrit në Bulqizë tek shefi i kuadrit Ali Hida, mora paisjet e nevojshme të gjeologut në magazinë si, çantë gjeologu, busull e çekiç, çizme, këpucë me qafa, xhaketë e pantollona doku e xhup dhe u paraqita në Ekspeditën Gjeologjike Peshkopi tek kryetari i ekspeditës, gjeologu Ruzhdi Sulejmani nga Shkodra.

Në përbërje të kësaj Ekspedite ishin, Ekipi i kërkimit të Bakrit në Peshkopi me gjeolog Niko Kita nga Përmeti, Ekipi i kërkimit të Kromit në Kacni me gjeolog Ruzhdi Sulejmani që ishte edhe kryetar ekspedite, Ekipin e kromit në Lurë me gjeolog Bashkim Lleshi nga Dibra dhe Ekipi i kërkim rilevimit të Peshkopisë me gjeolog Irakli Premti nga Saranda. Zyrat e Ekspeditës ishin tek Pazari i vjetër, në krahun e poshtëm të rrugës, në të djathtë kur zbrisje poshtë. Personeli që nuk kishte shtëpi në Peshkopi banonte në ish Shtëpinë e pritjes së Peshkopisë prapa Degës së Punëve të Brendëshme. Kushtet e fjetjes e të ushqimit ishin shumë të mira. Tek banesa ku flinim kishim një guzhinjere shumë të mirë, një grua të urtë e punëtore, Lime Nelin nga Cerjani e cila gatuante dhe pastronte dhomat tona. Banesa kishte tre dhoma e një guzhine ku banonim: Unë, Irakli Premti, Niko Kita, Ali Bardhi, Ramazan Sulejmani, Qamil Ndreka, Isa Mandri, Baftjar Qoku e Mersim Alimani etj. Gjatë dimrit personeli inxhiniero-teknik banonte në Peshkopi ndërsa gjatë verës shkonim nëpër ekipe me çadra e baraka. Gjatë dimrit vazhdonin punimet e kërkimit me një galeri në objektin e kërkimit të kromit Kodra e Lëmueme në Kacni dhe galeritë e kërkimit të bakrit në Pilafe e Cerjan.

Gjatë periudhës së dimrit unë fillova të njihesha me punimet e rilevimit dhe të kërkim revizionimit të kryera më parë në Lurë dhe përpilova propjektin e punimeve të kërkim-revizionimit të kromit për vitin 1969. Në vitin 1968 ishte kryer rilevimi në shkallë 1:10 000 i pjesës jugore të masivit të Lurës nga inxhinier gjeologët Agim Dobi e Dhimo Ikonomi e teknik gjeolog Thanas Zaro, ndërsa punimet e kërkim revizionimit me kanale në objektin e Blaçit dhe të Kumbullës të drejtuara nga inxhinieri gjeolog Irakli Premti e teknik gjeolog Qamil Ndreka.

Gjatë dimrit të vitit 1969 disa herë kam shkuar edhe me Ruzhdi Sulejmanin në Ekipin e Kacnisë ku vazhdonte një galeri kërkimi dhe një pus nga galeria në Objektin e kromit Kodra e Lëmueme. Teknik gjeolog në zonën e Kacnisë ishte Hasan Lala. Gjatë dimrit vazhdonin edhe punimet e kërkimit të bakrit në objektin e Pilafes me inxhinier gjeolog Niko Kita dhe teknik gjeologë Arif Nesimi e Nazif Aga dhe tenik normist Muharrem Sturçe.

PËRGATITJA PËR PUNIMET FUSHORE TË VITIT 1969

Pasi përfunduam dhe miratuam në këshillin teknik të Ndërmarjes projektin e punimeve të kërkim revizionimit të kromit në zonën e Lurës, në muajin prill filluam sistemimin e materialeve që do të na nevoiteshin për punë gjatë verës dhe për bazën e ekipit ku do të flinim me çadra. Në fillim të muajit qershor të vitit 1969 ngarkuam të gjithë bazën materiale të ekipit të kërkimit në magazinën e Ekspeditës në Peshkopi dhe bazën materiale të ekipit të rilevimit në magazinën qëndrore në Bulqizë në një makinë gaz 51 që drejtohej nga shoferi Muharem Velia dhe të dy grupet u nisëm nga Bulqiza bashkë me një makinë tjetër gaz 69 me drejtues Rasim Viçishta për në zonën e Lurës. Rruga nga Peshkopia për në Lurë nuk ishte hapur nga Çidhna e Lan Lura, kështu që nga Bulqiza u nisëm në drejtim të Milotit, Rëshenit e Kurbneshit.

Mbaj mend që nga Bulqiza u nisëm të dy grupet së bashku, ai i Rilevimit gjeologjik të



masivit ultrabazik të Lurës në shkallë 1:10 000 me Inxhinierët gjeologë, Agim Dobi e Dhimo Ikonomi dhe teknik gjeolog Naim Muça dhe grupi i kërkimit me inxhinier gjeolog, Bashkim Lleshi e teknik gjeolog Adli Baholli. Topograf kishim inxhinierin topograf Selim Muça.

Në Kurbnesh arritëm afër darkës kështu që vendosëm të flinim aty sepse në Lurë do të arrinim natën dhe nuk mund ta ngrinim bazën e fjetjes. Në Kurbnesh nuk kishte hotel kështu që do të sistemoheshim në dhomat e personelit të minierës me shokët e njohur që mbanim mend që nga shkolla. Unë takova shokun e vjetër të shkollës së lartë, inxhinierin e Minierës së Kurbneshit, Ndoc Uci i cili më mori për të fjetur në dhomën e tij. Ndoci kishte mbaruar 4 vjet para meje shkollën e lartë dhe ishte një ndër studentët më të mirë të fakultetit tonë në degën e minierave. Ai kishte njohuri të thella edhe për anën mekanike. Qysh kur ishte në fakultet, tek Ndoci vinin studentët e inxhinierisë mekanike dhe kosultoheshin për projektet teknike të tyre. Dhoma e tij në Kurbnesh i ngjante një laboratori elektro-teknik ku gjeje pjesë të ndryshme elektroteknike të përgatitura nga vetë Ndoci. Ai përveç ngrohjes së dhomës dhe ujit me paisje elektrike, në mur kishte vendosur një orë elektrike të ndërtuar me paisje rrethanore elektrike.

Të nesërmen herët u nisëm nga Kurbneshi për në Lurë. Pasi kaluam Mërkurthin e Krej Lurën vazhduam rrugën për në Fushë Lurë.

NGRITJA E BAZËS SË EKIPIT GJEOLOGJIK NË LURË TË VJETËR

Menjëherë sa arritëm në Lurën e Vjetër filluam ngritjen e çadrave të fjetjes e të guzhinës në krye të lëndinës së bukur rrëzë pishave mbi burimin e freskët të Gjurrës së Duke dhe sistemuam të gjitha materialet e fjetjes të punës e të ushqimit. Nga Krej Lura muarëm guzhinierin Mark Doçi, që e kishin patur në vitin 1968 ekipet e kërkim rilevimit në Lurë, i cili sistemoi çadrën e guzhinës dhe filloi nga puna për përgatitjen e drekës. Po atë ditë muarëm kontakt me drejtuesit e pushtetit lokal dhe të kooperativës bujqësore të Lurës, për të siguruar fuqinë punëtore të nevojshme për punimet që do të kryenim gjatë verës në këtë zonë dhe për ndonjë furnizim nga kooperativa.

Për Ekipin e kërkimit në zonën e Fush Lurës muarëm dy punëtorë për punimet siperfaqësore, Skënder Gjon Doçin dhe Rustem Cukun, nipin e drejtorit të vjetër të gjeologjisë së Pukës Bajram Cuku, që filluan punën në kanalet e objektit të kromit të Blaçit. Njoftuam zjarmëtarin Ali Buci nga Vlashaj që kishte punuar edhe në vitin 1968 i cili erdhi dhe filloi punën për ndërtimin e depos së lëndës eksplozive në afërsi të bazës së ekipit dhe muarëm edhe dy punëtorë të tjerë nga Krej Lura për punimet sipërfaqësore që do të fillonim në këtë zonë, Gjergj Rajtën e Vlash Rajtën. Kafshar për furnizimin e ekipit me dru e ushqime dhe për transporte të ndryshme materialesh muarëm Pjetër Rajtën nga Krej Lura.

Kështu filluam punimet e kërkimit të mineralit të kromit me kanale në Blaç dhe në Krej Lurë. Në Blaç ngjiteshim nga rruga këmbësore që fillonte nga baza e ekipit në Lurë të Vjetër deri në lartësinë e liqeneve të Lurës, rreth 2 orë në këmbë, mes për mes pyllit të dendur të aheve e pishave deri sa dilnim në lartësitë e liqeneve, në krahun verior të Liqenit të Madh, poshtë majës Nezhda e Lurës. Shpesh në pyllin e dendur të aheve mbi bazën e ekipit na ka dalë edhe ndonjë ari që kishte në pyll. Në pyll rrallë herë udhëtonim vetëm. Unë nga baza e Lurës së vjetër në Blaç apo nga Blaçi e anasjelltas ose nga Blaçi në Krej Lurë nga Qaf Kumbulla, udhëtoja i shoqëruar nga teknik gjeologu ose nga zjarmëtari i ekipit, por kishte edhe raste kur shkoja vetëm në objektet e largët ku kishim punimet.

Qendra e Lurës ishte në mes të një lugine shumë të bukur malore që fillonte me bukuritë e Borije Lurës dhe vazhdonte në Fushë Lurë e Lurë të Vjetër e rrethuar në të gjitha anët me pyll ahu e pishe. Në jug lindje kishte zonën e bukur pyjore të Lan Lurës, ndërsa në veri perëndim kishte pyjet e Nezhdës së Lurës të zbukuruar nga liqejt e bukur malorë. Kudo e ndjeje freskinë dhe bukurinë e natyrës. Kur ktheheshim nga puna ndonjëherë pasdite zbrisnim në Fushë Lurë dhe pinim ndonjë kafe apo ndonjë gotë raki tek klubi ku punonte Hazis Buci me të shoqen, Bulen nga Dibra. Aty dëgjonim të flitej për Lurën e për kuadrot e saj. Afër klubit ishte edhe qendra e pushtetit lokal dhe e kooperativës bujqësore.

Kuadrot drejtuese të pushtetit lokal dhe të kooperativës ishin pothuajse të gjithë vendas. kryetar Lokaliteti ishte Ali Leka dhe sekretar Osman Musa, kryetar kooperative Nezir Buci e zv/kryetar Beshir Laçi. Kishte dhe një qendër shëndetësore me mjek Ndrec Vladin dhe një grup artistik që drejtohej nga mësuesi i talentuar e mbledhësi i folklorit Hilmi Kolgjegja.

Në bisedat e ndryshme me lurjanët u njoha më në detaje me patriotët e burrat e shquar të Lurës, më bëmat e trimëritë e tyre brez pas brezi. Nga Lura doli Llesh Nikoll Doçi i "300 duvakëve" që mposhti e sfidoi hordhinë turke në Kala të Grazhdanit me 300 djemtë e rinj të Lurës të hypur mbi kuaj, të armatosur e të mbuluar me duvakë si nuse, betejë të cilën populli e përjetësoi në këngë:

"Llesh Nikoll Doçi i tha Sulltanit, / Nusja u nis por çoi fjalë dhëndërrit.../ ... Vesh si nuse janë 300 burra./ Për tek Pasha i ka nis Lura.../ ... Prej duvakëve rruga skuqet, /Dil or pashë e priti nuset.../ ...Jam Llesh Doçi djal Bajraku, /Erë baruti ka duvaku, / 300 nuse e 300 krushq, / Kanë la në gjak mbi 1000 turq" (Munir Shehu 2016)

Nga Krej Lura ishte zv/kryetari i parë e Qeverisë së Vlorës Dom Nikoll Kaçorri. Në Fush Lurë ka lindur heroi i Popullit Gjok Doçi cili dha jetën për çlirimin e atdheut. Nga Tejmalla (Dodaj) ishte Rexhep Doda një nga kuadrot më të vjetra drejtuese të pushtetit në rrethin e Dibrës dhe Beshir Laçi një nga partizanët e vjetër të luftës dhe me vonë kuadër drejtues në Durrës e Lurë. Nga Lura e vjetër ishte Gjon Deda i cili ka punuar kuadër drejtues rrethi në Peshkopi e Rëshen dhe Bajram Cuku që ishte një nga drejtuesit me të vjetër të gjeologjisë në rrethin e Pukës dhe me vonë në Fush Arrës. Në lagjen Sumaj të Lurës ka lindur e është rritur mësuesi i urtë e patriot, figura fisnike e Lurës, Dibrës dhe Mirditës, Llesh Zef Doçi, i cili me zgjuarësi e burrëri ka sfiduar furtunat e sistemit të kaluar. Nga Pregj Lura ishte Ramazan Vladi i cili nga punëtor e mekanik në Kurbnesh, arriti të punojë drejtor i Drejtorisë Gjeologjike në Ministrinë e Industrisë dhe Minierave në Tiranë për disa vjet.

Shumë kuadro nga Lura kanë punuar në organet drejtuese të pushtetit në zonën e Dibrës e në Peshkopi etj. si: Ahmet Kaçorri, Ahmet Përleka e Lek Rajta nga Krej Lura, Nikoll Kola e Ndue Kola nga Lajthiza etj. Nga Fushë Lura ishte mësuesi i talentuar, mbledhësi i folklorit, kompozitori dhe prozatori Hilmi Kolgjegja, mësuesit e vjetër e të përkushtuar si Sali Ajazi e Ramadan Ajazi, Osman Vladi, Bib Doçi e Nin Rajta, Han Pogaj, etj. nga Arrën Molla, Kreja e Tej Molla, doktorët Ndrec Vladi e Preng Ndue Doçi nga Fushë Lura e Kreja, duke vazhduar me brezin e kuadrove më të rinj si, inxhinierët Bardhok Rajta, Skënder Përleka, Dod Vladi, gjeneralët Koçeku e Vladi, akademiku Shaban Sinani, biznesmenët Preng e Dod Doçi, etj.

Lura është shembulli ideal i bashkëjetesës së feve katolike e myslimane brenda një familje. Kushuriri i Gjok Doçit është Mustafa Doçi, me të cilin kam punuar vitet e fundit në punë në Gjeologjinë e Tiranës, Skënder Doçi që kam patur punëtor në Lurë në vitin 1969 ishte djali i Gjon Doçit nga Fushë Lura. Kushurinjtë e parë te Gjon Dedës në Lurë të Vjetër janë Liman e Lam Moriseni, të cilët kanë lindur e janë rritur bashkë në një shtëpi. etj.

NEZIR BUCI I FUSHË LURËS

Nezir Buci i Fushë Lurës ishte një burrë shumë i mirë dhe malsor i zgjuar e me humor të hollë dibran, të cilin e donin dhe e respektonin krahina e Lurës. Duke qenë për një kohë të gjatë kryetar kooperative drejtues i zoti vendor në Lurë, ai priste në familjen e tij të gjithë nëpunësit që shkonin në Lurë me shërbim nga Peshkopia apo nga Tirana. Kur na vinte për ndonjë vizitë tek çadrat mbi Gjurrën e Duke në Lurë të Vjetër ne e mbanim ndonjeherë për drekë ose për darkë dhe ai na tregonte me humor historitë e punës e të jetës së tij e të malësorëve të tjerë në Lurë.

Një herë tregon Neziri, kishin ardhur në Lurë dy nëpunës nga Tirana që punonin në Komitetin Qëndror të Rinisë të cilët bënin takime në zona të ndryshme të vendit për zhdukjen e zakoneve prapanike, për heqjen e veshjes së rëndë të grave malësore dhe për ndihmën që duhet tu jepet grave në punët e shtëpisë. Në takimin e organizuar u tha se në rradhë të parë duhet të japin shembull kuadrot e kooperativës duke filluar nga kryetar Neziri, i cili tha se ishte i pari që i kishte hequr gruas së tij veshjen malësore dhe se e ndihmonte edhe në punët e shtëpisë. Pasi mbaroi takimi Neziri nuk kishte ku ti dërgonte të deleguarit, se në Lurë, ashtu si në qendrat e tjera të kooperativave, nuk kishte as hotel dhe as restorant, kështu që i mori në shtëpinë e tij. Kur shkuan në shtëpi u doli në oborr për t'i pritur e për t'u uruar mirëseardhjen një grua që dukej e moshuar e veshur malësore e cila ishte grueja e Nezirit, por meqenëse në mbledhje ai kishte thënë se ia kam ndruar veshjen në radhë të parë gruas time, ua prezantoi mysafirëve si nënën e tij dhe u tha se grueja ka shkuar tek të afërmit e saj dhe nuk mund të kthehet sonte. Pasi u futën në dhomën e miqve ato i thanë Nezirit: "Ti Nezir tani na përgatit darkën, ndërsa ne do të bëjmë muhabet me nënën tënde," të cilën e ulën me zor pranë tyre. Gruaja e Nezirit e prezantuar si nëna e tij, mezi e kaloi atë natë me mysafirët e ardhur nga Tirana.

Gjatë kohës që ishte kryetar kooperative e dërgojnë një herë për vizitë e për të marrë eksperiencë në fermën e Sukthit në Durrës, ku vizituan edhe stallën e lindjes dhe rritjes së viçave. Atje kishte një pastërti shembullore, vizituan maternitetin ku lindnin viçat, sikur të ishe në ndonjë maternitet ku lindin fëmijët, panë se si i trajtonin dhe ushqenin viçat e vegjël me qumësht, panë gratë që u shërbenin viçave, të veshura me bluza të bardha akull të pastra, a thua se ishe në ndonjë pavion spitali etj. Kur e mbaruan këtë vizitë, Neziri i thotë përgjegjësit që drejtonte grupin: "Të lutem mua më lidhni e më futni të jetoj me këto viçat këtu, se ma mirë të jem viç në Sukth se sa kryetar kooperative në Lurë."

Kur punonte në sektorin e Rruga Urës në zonën e Lurës në një mbledhje në Drejtorinë e Ndërmarjes në Peshkopi, Neziri paraqiti dy kërkesa për plotësimin e kushteve të punëtorëve: "Kërkesa e parë ishte ti përgatisnin tek dentisti në Peshkopi një palë dhëmbë (proteza) që tua vinte në gojë me radhë punëtorëve kur të hanin bukë në mencë, se asnjeri nuk kishte dhëmbë dhe kërkesa e dytë në krye të bishtit të lopatave të vinin nga një copë meshini ose shajaku, si shalë biçiklete që kur të pushojnë punëtorët në këmbë të mos rrëzohen, se po të ulen për të pushuar nuk mund të ngrihen më të punojnë, sepse të gjithë janë në prag të pensionit".

Kur mernim ndonjë sheleg në kooperativë organizonim edhe ndonjë darkë apo drekë tek çadrat të gjithë së bashku. Një natë pasi pimë raki në darkë na teproi mish të cilin e lamë për të nesërmen. Natën kur po flinim në çadrën e guzhinës na ishte futur një qen i cili kishte ndjerë erën e mishit dhe e kishte ngrënë. Kur u ngritëm të nesërmen nuk e gjetëm mishin që kishim lënë, kështu që herët tjera kur hanim mish në darkë, Agim Dobi na thoshte: " Nuk duhet të lemë mish për të nesërmen se nuk ka siguri natën."

profil

Ramazan Melani punon, lodhet, por është shumë i kënaqur me jetën. Ka ndërmend ta shtojë frutikulturën dhe me shumë dynymë të tjerë. Ai zotëron dhe gati dy hektarë pyje, kurse pemë të shpërndara gjenden kudo në territorin e tij.

Ramazan Melani i Pejkës

Nga OSMAN XHILI

Të parët e tij zbritën nga fshati i Melanit në Pejkë, duke marrë me vete emrin e fshatit, për ta përdorur si mbiemër të fisit. Blenë toka në vendbanimin e ri, zhvilluan bujqësinë e blegtorinë, por ishin dhe të zgjuar e inteligjentë. Shumë prej tyre kanë mbaruar shkollimet e larta e punojnë në profesione e vende të ndryshme.

Ne po flasim për njërin nga gjashtë djemtë e Sulejmanit, Ramazan Melanin, përfaqësues i vetëm i tyre në fshat. Që fëmijë atij i pëlqente mekanika, hekurat dhe sajonte lodra fëmijësh të asaj kohe.

Në vitin e largët 1979 u fut në SMT-në e atëhershme dhe punoi si zetorist. Më pas u specializua me kurse të ndryshme si motorist dhe deri në vitin 1992 punoi në shtet. Nuk ka punë mekanike që ai të mos e njohë dhe ta ushtrojë. Ai është mekanik i përgjithshëm, saldator, motorist, xhenerik. Pak vite më parë kompania e Xhondirit e kërkoi si mekanik garancie, por Ramazani nuk pranoi për arsyet e tij personale.

LAMBURDINI I TIJ I VOGËL

Ai ka tamam 40 vjet që merret me hekura dhe me sa duket dëshiron të vazhdojë dhe shumë të tjerë akoma. Ka pasur dhe zetorë të fuqishëm e me shumë kuaj fuqi, por sot ka një zetor shumë më të vogël të firmës Lamburdini. Nuk dimë si ta quajmë zetorin e tij të vogël, mjet pune, kalë, taksi, pasi ai i kryen më së miri të gjitha këto funksione.

Dikur ky mjet ndodhej pothuaj i braktisur në garazhin e një miku të tij dhe mekaniku duarartë e bleu për një shumë të vogël. E pastroi dhe e grasatoi, duke i kthyer freskinë e dikurshme. I ndërhyri në kamje, duke i futur një kamje benzi dhe duke i reduktuar xhirot e motorit. Ka ndërhyrë tek sistemi i frenimit duke e bërë me frena hidraulike. I vuri pas dhe një karroceri dhe e bëri vetëshkarkuese. Në të ka montuar një pompë motorike që shërben për vaditje, por me zetorin e tij mund të kryejë spërkatje dhe në terrene të vështira, ku të tjerët nuk mund të hyjnë. Në mjetin e vogël instalon depozitën me një kapacitet prej 10 kuintalësh. Shpesh i ven pas një kosaçkë, që kosit jonxhat dhe kështu shkon më shpejt në destinacion, kurse herë tjetër ngarkon motocapin, një frezë e vogël, po e tipit Lamburdini. Me të mund të bluajë materiale për gjënë e gjallë, por dhe të bëjë silazh.

Nganjëherë monton një sharrë në të dhe pret drutë e tij, apo të dikujt në lagje e në fshat. Zetori i tij i vogël është aktiv, katër herë katër dhe nuk ka mundësi të ngelet diku dhe kur pesha në karroceri i kalon ndjeshëm mundësitë e tij. Në një rrugë, apo në një ngarkesë, ai mund të transportoje mesatarisht deri në 15 kuintalë.

Në një rast, tregon Ramazani, kisha për të dërguar grurin tim në fabrikën e blojes në Klos. Ngarkesa gati i afrohej 20 kuintalshit apo më saktë 19 kuintal e 62 kilogram. E vura të gjithë ngarkesën dhe u nisa drejt Klosit.

Pronari i mullirit e pyeti me se e solle deri këtu dhe Ramazani i tregon mjetin e vogël, por me zemër të madhe, që e kishin fare pranë tyre.



Ramazan Melani ka mbjellë tre dynimë me qershi vite më parë dhe tani ka filluar të vjelë frutet e punës së tij. Pemët e reja kanë filluar të bëjnë kokrrat e para dhe shumë shpejt po i japin një tjetër fytyrë vendit aty.

VGJERET E SULËS

Ky është një toponim i vjetër që identifikon një sipërfaqe toke prej më se tre hektarësh, në pronësi të familjes së Ramazanit. Vetëm ata që janë dibranë e nxjerrin kuptimin e fjalës "vgjere", një tokë e papunuar, zakonisht pa vaditje dhe e lënë në mëshirë të fatit. Ramazanit nuk i pëlqente në brendësi të shpirtit ky emërtim, pasi dhe babai i tij kishte qenë punëtor dhe i dalluar në bujqësi. Vendosi që ta ndryshonte këtë emër, por do ta bënte në një mënyrë krejt të veçantë. As ndonjë tabelë nuk do të vinte dhe as në kadastër nuk do të bënte ndonjë lëvizje emri. Ndryshimi do të ishte diku tjetër dhe donte pak kohë. I punoi këto toka thellë para tre katër vitesh dhe hodhi shumë zetora me pleh organik të kalbur mirë. Më pas hapi gropat dhe mbolli gati një hektar arra dhe lajthi. Tre dynimë me qershi i kishte mbjellur vite më parë dhe fermeri ka filluar të vjelë frutet e punës së tij. Pemët e reja kanë filluar të bëjnë kokrrat e para dhe shumë shpejt po i japin një tjetër fytyrë vendit aty. Këto ditë ai i vaditi pemët duke e sjellë ujin me pompën motorike nga njëqind metra poshtë.

Jemi ulur bashkë me Ramazanin nën hijen e një qershie të egër, në një ditë të nxehtë korriku. Përballë kemi kodrën e Topit, në krah të Selanes. Thuhet se turku pati vënë një top të fuqishëm aty dhe me të goditi kullën e Mures, duke e ndarë në dysh. Aty pranë ka shumë thana, që i kanë zverdhur e gati po i kuqin kokrrat e shumta që bartin. Disa pjergulla të rrushit karpushi, të pambjella nga dora e njeriut, por me një shije krejt të veçantë në pjekje, kanë hipur mbi qershi dhe e bëjnë më të dendur hijen dhe më të këndshëm pushimin. Lulja, bashkëshortja e Ramazanit kishte mbështjellë disa copa byreku dhe një tas të madh me kos të freskët. Besoj dhe mbreti do të na kishte zili për ato çaste pushimi në tendën tonë të hijezuar. Më poshtë shtrihen disa parcela me misër, ku çdo kashtë ka nga dy kallinj. Ramazani ka jo pak, por gjashtë dynymë me misër e fasule bashkë. Ai shpreson të marrë rreth 50 kuintalë misër dhe mbi gjashtë kuintalë fasule. Lista e llojeve të mbjella zgjatet e zgjatet me patatet, qepët, grurin e plot perime të tjera.

Parcelat e misrit vaditen me një hurdhë, që mbushet periodikisht me ujë, tre herë në 24 orë. Është e ndërtuar thjeshtë, vetëm me baltë e thupra. Ajo ka një kapacitet prej 40 metër kub dhe menaxhohet me radhë nga katër familje. Ramazani liron saraçineskën në hyrje dhe një vrundull uji i pastër dhe i ftohtë vërshon në dalje. Fermeri mbush pëllëmbët gjysmë të hapura me ujë, si një bekim nga Zoti dhe freskon fytyrën disa herë. Më kishte marrë malli të shoh një të tillë, kur aq shumë i përdornin në të kaluarën. Jo vetëm hurdhat, por dhe liqenet një pjesë u braktisën dhe janë jashtë funksioni. Ndoshta është një moment reflektimi për të shkuar në traditën e bukur të trajtimit të ujit me kujdes, duke shfrytëzuar çdo burim, sado i vogël qoftë ai.


Ramazani ka dy vajza të martuara dhe një djalë, Indritin, që ka mbaruar gjimnazin dhe është po aq i zoti në mekanikë, sa dhe babai i tij. Ai punon, lodhet, por është shumë i kënaqur me jetën. Ka ndërmend ta shtojë frutikulturën dhe me shumë dynymë të tjerë. Ai zotëron dhe gati dy hektarë pyje, kurse pemë të shpërndara gjenden kudo në territorin e tij. Molla dhe kumbulla të egra, thana, gështenja e plot të tjera si këto e zbukurojnë akoma më shumë pronën e tij dhe ne urojmë që njerëz të tillë të ketë sa më shumë.







Rruga e Arbërit nr. 159



Lura
parajsa jonë e humbur

Fotot ilustruese të këtij shkrimi janë të piktorit © Zaim Elezi (Zaya).

Nga NDUE DEDAJ

Nëse qeverisja e vendit do të ishte normale, këto ditë ajo nuk do të ishte duke zhvilluar, në qendër të Tiranës, betejën e palavdishme për shembjen e Teatrit Kombëtar, por do të ishte ngjitur në bjeshkë për të ndërtuar sa më parë Lurën, si një "kështjellë" të turizmit malor. Teatri dhe Lura, sado pa lidhje të duken mes tyre nuk janë dy gjëra të ndryshme, përkundrazi janë e njëjta gjë. Të dyja kërkojnë vullnet, projekte serioze dhe transparencë qeveritare me publikun për t'u bërë, detyrim ligjor që qeveria e ka për çdo centimetër truall, pyll, lumë dhe për çdo qindarkë që del nga xhepi i shqiptarëve.

Teksa hedhim këto radhë për Lurën, ndërmend na vjen vizita e Kryeministrit Rama atje, qershorin e kaluar, ku premtoi se do ta bënte rrugën, aq më tepër që Lura është përfshirë në projektin e 100 fshatrave. Nuk prisnim, natyrisht, që rruga të bëhej në 13 muaj, por të paktën projekti të ishte shpallur e mbase të ishin hedhur kazmat e para, pasi kreu i qeverisë nuk besojmë se ka folur për "pesëvjeçarin" tjetër. Lura këtë fat ka pasur, që e ka ndjekur pas si një mallkim, të mos e çojë rrugën atje asnjë Kryeministër, që nga Mehmet Shehu, i pari që e ka vizituar. Por kot që të bëjmë histori. Lurën nuk e kemi më. Lura është parajsa jonë e humbur. Nuk është "Parajsa e humbur" e Xhon Miltonit, a ndonjë tjetër, por një parajsë shqiptare e rrënuar nga njeriu, bash ai që duhej t'i falej asaj.

Për Lurën është shkruar aq shumë, këto vite, sa, sikur fletët e shkruara të mund të ktheheshin në kilometra rruge, nuk është çudi të ishte arritur te liqenet!... Lura është gjithmonë një grishje e brendshme për këdo, për të shkuar një ditë atje, pasi kush e ka vizituar një herë, pret rastin për të vajtur përsëri, herë pas here. Sado e paarritshme të duket kurora e liqeneve të saj, prej mungesës së rrugës, atje ia dalin të ngjitën të pasionuarit pas turizmit të aventurës, për një ditë a për një javë, me kampingje të thjeshta, si dhe punonjësit pyjorë, gazetarët dhe natyrisht barinjtë, që verojnë bagëtitë atyre kreshtave. Por këta janë aq pak, krahasuar me vërshimin e munguar të turistëve për në Lurë. Rruga për atje është ajo që ka qenë para tridhjetë vitesh, nga Mirdita, për "Skodat" e lëndës drusore dhe makinat e kooperativës. Nuk pritej në atë kohë që Lura të ishte ndryshe, por është e pafalshme që, nga '90 e mbrapa, Lurën nuk e kthyem në qendrën më të rëndësishme të turizmit malor, prej natyrës së saj të pazakontë. Jo vetëm nuk kapëm kohën e humbur, por na mbeti "ora" në vend, bile bëmë prapa. Ia dorëzuam Lurën kaosit dhe babëzisë së tranzicionit. Se kështu e kemi parë gjithmonë Lurën, për ta zhvatur, vetëm për t'i marrë e asnjëherë për t'i dhënë.

Tranzicioni e shkatërroi Lurën dhe ky nuk është ndonjë përbindësh që del nga shpellat e maleve, por jemi ne. Lurën e premë, e grabitëm, i nxorëm "sytë" (liqenet), e bëmë të pamundur për ta shijuar si mrekulli natyrore. Mali i Kunorës, Liqeni i Luleve me "zambakun shqiptar" dhe gjithë vargu liqenor, larmia e drurëve, kafshëve dhe shpendëve të egra, kullat epike plot tradita, jeta komunitare, herë – herë dhe familjare, dybesimshe, gjithë peizazhi mitik, ekzotik dhe urban, e bën Lurën kryeveprën e mundshme të turizmit dhe agroturizmit në Shqipëri e më gjerë. Ajo nuk është vetëm një kryemal i lartë me 7 liqene të mëdhenj e po kaq të vegjël, por një areal karakteristik me fusha, pllaja, qafa, leqe, gryka, burime, livadhe, legjenda, në zemër të rajonit verilindor, thuajse e baraslarguar nga Rrësheni, Peshkopia, Burreli dhe Kukësi. U bënë, më në fund, Vermoshi, Valbona, Shishtaveci, Iballja, treqind kilometra nga Tirana dhe ky është një lajm shumë i mirë, por jo dhe Lura, përgjysmë tyre për nga largësia. Një miku ynë dibran, specialist pyjesh dhe studiues, emigrant në Itali, u nis këto ditë nga Tirana për në Lurë, bashkë me dy miq të tij të profesionit, por i thanë se për t'u ngjitur te liqenet i duhej një superfuoristradë, ndaj grupi u kthye mbrapsht. Sa e sa turistë të tjerë, sidomos të huaj, nisen për në Lurë e nuk mbërrijnë!





Nuk ka njeri që nuk e di thënien e Gjergj Fishtës, para njëqind vitesh, 'nëse nuk ke parë Lurën, nuk ke parë Shqipërinë'. Por a po e shohim ne Lurën? Pak, shumë pak. Çfarë mund të thuash për të tjerat, kur nuk bëhet "yti" oazi më i lakmuar i Shqipërisë?

Puna është si ta bëjmë Lurën të vizitueshme, pak nga pak, pa pritur "qerren" fluturuese të qeverisë për të na shpënë atje. Lurianët i janë rikthyer Lurës vetë dhe po përpiqen të kthejnë vëmendjen e qeverisë dhe organizatave të zhvillimit rural andej. Festa e Shën Mërisë, në gusht, i mbledh ata nga janë e s'janë, pavarësisht besimit, në një kremtim të larmishëm në Fushë-Lurë. Organizator, vitet e fundit, është Unioni "Lura" dhe biznesmenët e përmendur lurianë, që mbështesin veprimtaritë kulturore, si dhe daljen e gazetës "Lura", ku intelektualët dhe banorët tregojnë vizionin se si ai duhet të jetë Lura e tyre. Mblidhen dhe në raste të tjera, por nuk është fjala vetëm për një ditë, a disa ditë në vit, synimi është që Lura të fitojë dimensionin e munguar, si një arenë e turizmit bashkëkohor gjatë gjithë vitit, e përshtatshme për hiking, hipizëm, sporte dimërore etj. Nuk duhet pritur që të na e rikthejë dhe njëherë natyra nga e para Lurën, që të bëjmë pastaj ne tonën me të. Informacioni për Lurën, nga ata që janë të interesuar, merret më së shumti në rrugë "klandestine", me të pyetur ose online, pasi nuk ka një qendër që të mund të informojë saktësisht për të, edhe pse në Rubik është ngritur "Info-kulla", me të cilën do t'ia vlente të bashkëpunohet për këtë qëllim nga organet vendore të Dibrës, operatorët dhe shoqatat e turizmit.

Shkruajmë për Lurën, pasi kjo është e vetmja gjë që mund të bëjmë. S'kemi pushtet dhe banka që t'i ndërtonim infrastrukturën e duhur, por fjalëmirë mund të bëhemi, se mos fjala ngjet, ani se besimi na është sosur jo pak. Lura është shpallur Park Kombëtar në vitin 1996 dhe vazhdojnë sot e kësaj dite të shpallen zona të mbrojtura, rreth e qark saj, ndërkohë që Amerika e ka vënë pyllin nën ligj në dekadat e fundit të shekullit XIX. Edhe atje ka qenë problemi i hidrocentraleve, aq më shumë kur mendon përmasat gjeografike të SHBA-ve, por lumenjtë e rrallë janë kursyer nga digat dhe veprat hidroteknike të vaditjes. Kurse përrenjtë e Dibrës, Matit, Mirditës, Kukësit, Tropojës, Tepelenës, përfshi dhe lumenj të njohur si Valbona, Cemi, Vjosa e të tjerë në gjithë Shqipërinë janë sot të kërcënuar, burim për burim e rrjedhë për rrjedhë nga HECet e panumërta. Është mbase rasti të themi se askush ndër banorët e maleve nuk e mendon të paprekshëm mjedisin e vet, pasi çdokush e di se që të zhvillohet një rajon, do të preket dhe natyra, ngaqë do të ndërtohen rrugë, diga, miniera, ujësjellës, hotele, por me masë, me strategji dhe kurrsesi në këto përmasa shkatërruese. Përndryshe, Shqipëria nuk do të ishte në këtë alarm "historik" e protestë të banorëve nga Valbona ne Vjosë, për ta ndaluar hidrocentralizimin e çdo përroi në male e lumi në fusha.

Duke u kthyer te fillimi i shkrimit, beteja e artistëve dhe e publikut për Teatrin Kombëtar vazhdon. Habitesh se godina e tij mbrohet me policë! Nga kush rrezikohet Teatri, nga publiku, nga polisi, nga vetja? A nuk është ky që e ka krijuar teatrin qysh në antikitet? Si mund të mbrohet një pronë publike nga i zoti, që është publiku? Do të kishte kuptim nëse qeveria do ta niste Policinë me shërbim, kudo ku shtrihen tubat e HEC-eve përrenjve malorë, për t'i penguar ato, kudo ku pyjet vazhdojnë të dëmtohen nga prerjet dhe zjarret, kudo ku keqbërësit e veshur me pushtet i gllabërojnë këtij vendi pasuritë natyrore. Lura do të ishte e para që duhej të përfitonte nga kjo lloj sigurie, do ta quanim, kombëtare. Tashmë kërkohet të mbrohen jo vetëm kufijtë e shenjtë të republikës, por dhe këto "piramidat" e brendshme (toka, pyje, laguna, kala, lumenj, minerale etj.), që rrezikohen nga vetë agresioni ynë kundër tyre, për të fituar padrejtësisht një dorë njerëzish me para dhe me pushtet.

(Marrë nga http://www.panorama.com.al)

reportazh



Një udhëtim nga Sllova
në Lugje në dy kohë

Sa qetësi në Lisivalle...

Nga **ILMI DERVISHI**

Të rrugëtosh nga Peshkopia për në Lugjej mundet të kalosh nga Fushë Alia, por rruga nga Fushë Alie në Lugjej është rrugë e vështirë, e parregulluar, ndaj shpesh rrugëtohet në rrugën e asfaltuar për Sllovë. Dhe ne zgjodhëm këtë itinerar lëvizje për të ruajtur makinën e për t'i shtuar vetes disa kilometra rrugë në këmbë. Zbritëm në Kodrën e Kaushit, një vend me histori e luftë, pikërisht aty ku ende qëndron lapidari. Një rrugë që duket si rrugë makine mes Palamanit e Shafellit kaluam mes ca lisave të dendur e të rinj deri në Kodër të Thekrit. Asnjeri nuk shikuam rreth e qark e asnjeri s'takuam sigurisht.

Nëpër një rrugë të ngushtë këmbësore plot kthesa zbritëm në Lisivalle, te lisi i moçëm në formë rrethi, ku burrat uleshin këmbëkryq në kuvend duke formuar gjysmërreth si valle, nga ku mori emrin Lisi valle. Qetësi. Dielli djeg këtë fund korriku si saç. Bari, ajo pjesë e mbetur pakositur ishte tharë e herë-herë dukej si fije teli i ashpër në të dy anët e livadheve të Dikës, ku këndohej kënga:

Kur vikati Suf Xhelili,
Bënte maumzerja si gojë bilbili...

...Qetësi në Lisivalle. Në të majtë një pyll i dendur, Gjordja, në të djathtë shtëpi të shembura, por ja që në njërën duket pak tym nga oxhaku. Aty banon Asllan Ndreu. Tek-tuk ndonjë pemë, por jo ato që ishin, ku binin në sy dardha goricë e kumbulla. Përballë shtrihet Dardha e për të dalë në Dardhë duhet kaluar nëpër Rrafshet e Xhoxhe, të biesh në Xhoxhe dhe të kalosh Drinin. Vështrimi na u ndal te grumbuj gurësh mbuluar me ferra. Po, këto gurë i mbaj mend.

Mbaj mend kullën e Gjatë të Ndreut me katër qoshet me gur të gdhendur, e mbaj mend kur ra çatia dhe ne si fëmijë loznim deri në katin e tretë të kullës. Mbaj mend në vitet 1971, kur u shembën muret dhe mbetën vetëm qoshet si katër lapidarë. Gurët e gdhendur u rralluan. Dikush i mori me dashamirësi për familjen Ndreu, dikush i mori si shenjë triumfi mbi klasat e përmbysura, por në vitet 1974 me këto gur dhe të tjerë u ndërtuan stalla për dele e dhi e që tani s'ka asnjë gjurmë. M'u kujtua libri "S'ka qetësi në Lisivalle" i Xhelal Ndreut, një enciklopedi ngjarjesh e faktesh, një jetë njerëzish realë në përpjekje për të jetuar me dinjitet, me dashuri e krenari për vendlindjen e vendin dhe thashë me vete: Sa qetësi në Lisivalle...

Sapo zbret nga Lisivalle të del parasysh Rrafshja e Xhoxhe. Një hapësirë e pamatë për nga sipërfaqja, me një prodhueshmëri të të gjitha bimëve bujqësore, me një rendiment të lartë prodhimi. 42 kv misër për ha, 38 kv/ha grurë por... Kanali vaditës që vjen nga Veleshica, që kalon nëpër tokat e Kallës e Vleshës, ndahet një brazdë ujë për tokat e Sllovës. Po kështu, në Zall Kalisë, në Rrafshe të Xhoxhe, në Lugjej e deri në Topuze ka vite që uji nuk vjen, por dhe kanali gati po mbushet për të humbur gjurmën e tij.

Gati në mes të Rrafsheve, Varret e Xhoxhe. Fillesat këto varre i kanë rreth vitit 1880, sepse më parë varret e Xhoxhe ishin poshtë në breg të Drinit. Aty është varri i Ali Dervishit, një luftëtar e patriot, pjesëmarrës në luftën e Shkodrës, 1798-1880, kur ushtria malazeze nën komandën e Mark Milanit pushtoi Plavë e Guci, Hot e Grudë e Ulqin, djali i Veselit, i vrarë në luftën e Gjoricës kundra Hajredin Pashës në nëntor 1844. Këtu është varri i Ramadan Demir Dervishit, luftëtar në të gjitha betejat kundër serbit nga viti 1912 deri 192. Bashkëluftëtarët e tij, Selman Beshir Cala apo Sulejman Ali Lushi, po këtu ka varrin Dali Dervishi për 25 vite kryeplak, që edhe sot kur e kujtojnë, thonë Baba Dali.

Bregu i Drinit nga të dy anët ku lag tokat e Dardhës ka bukuri dhe resurse turistike, me ujë të rrjedhshëm e të pastër, me vende me thellësi për not dhe të cekët për fëmijë, rërë të pastër e të imët në të dy anët me gjelbërim e hije shelgu...

Diku në veri të varrezave varri i Lan Tafës është nga fisi Ndreu, por dihet lidhja e gjakut dhe miqësisë me Ndreun, Qazim Marku, ardhur nga Arrni i Kukësit, gjeti mbështetje në Xhoxhe dhe krijoi dhe miqësi me Calën e me Lushin. Varri i Shkodranes, kështu e thonë e në fakt aty është varrosur gjyshja e Skënder Calës, nëna e bashkëshortes së Selman Calës, i cili u martua në Tiranë me një vajzë shkodrane nga fisi Rada, në një ditë me dasmën e Mbretit Zog. Të gjithë ata që u martuan atë ditë shpenzimet e dasmës i pagoi Mbretëria. S'mund të rrija pa bërë një vizitë te varrezat tanimë të rregulluara, të pastruara, të rrethuara me rrjeta teli. Ç'paradoks! Të gjallët po largohen nga vendlindja, për të vdekurit kujdesen ...

XHOXHET DHE UNË...

Dogjë Boça ishte i pari që erdhi në Xhoxhe rreth viteve 1530. Deri në vitin 1650 ishte myslimanizuar e gjithë popullsia dhe kur Dogjë Boçës i lindi djalë, i vuri emrin Dervish. Babai im në vitin 1964 ndërtoi i pari shtëpinë në Rrafshe të Xhoxhe. Mbolli shumë pemë, edhe pse aty pranë kishim bahçen e Lalës Suf me të gjitha llojet e pemëve të vendosura në rreshta si një bahçevan i vërtetë. Kur në vitin 1974 pemët u prenë dhe traktori i shkuli nga rrënjët të gjitha, Rrafshja e Xhoxhe u bë në parcela të mëdha, duke prishur ledhe dhe u sistemua të punonte traktori e të hynte autokombajna.

Sa herë shkoj në vendlindje më thonë: Çdo atje? E unë them, ja dhe këtë radhë po shkoj... Tanimë ajo krenaria sikur ka rënë. Ajo mburrja për rritje rendimenti nuk është... Kulla dykatëshe që ndërtoi baba është shembur. Pemët në bahçe janë tharë ... Por, unë përsëri vij.

Unë vij se kujtoj fëmijërinë time, rininë... Kujtoj opingat e llastikut gjatë gjithë verës. Kujtoj çizmet e grisura në dimër, të qepura me penj, ku uji në këmbë ngrinte akull mes gishtave...

Të kalosh nga Rrafshet e Xhoxhe për në Lugjej ka dhe rrugë makine, dhe rrugë që kalohet me kafshë me ngarkesë, por ka dhe rrugë këmbësore. Në verë apo në dimër vinin dhe nxënësit për në shkollë në Lugjej, nga Imeret e Zall Kalisi. Tani rrugë ka, por nuk kalohet. Mbuluar me ferra. Në qendrën e fshatit Lugjej, furra e bukës së dikurshme nuk ka lënë as gjurmë. Kopshti, zyrat e sektorit, magazinat, duket sikur kurrë s'kanë ekzistuar. Të vetmet ndërtime që ende qëndrojnë në këmbë janë dy shkollat, ajo fillore dhe 9- vjeçarja, ndërtuar më vonë të parës, që tani është jashtë çdo funksioni. Shkolla 9-vjeçare, mban emrin e mësuesit "Vesel Pira", djalë i fshatit, ish mësues në Zall Dardhë. Në vitin 1962, duke shkuar te shkolla, i ndërprenë rrugën dhe jetën valët e lumit Drini i Zi, pak metra më poshtë, ku sot është ura e telit që lidh Zall Dardhën me Lugjejt. Ishte së bashku me dy mësues të tjerë, Halil Lushi e Beshir Cala dhe punonjësi i lokalitetit Shaban Dervishi, që donin të sfidonin lumin e fryrë nga shiu dhe prurjet e përrenjve për të shkuar te nxënësit, te puna. Fasada e shkollës u duk e lyer dhe e zbardhur nga gëlqerja. Thanë e kanë lyer familjarët e mësues Veselit, se këto ditë kanë xhiruar një videoklip, një këngë kushtuar mësuesit dëshmor i Atdheut Vesel Pira. Heronjtë dhe dëshmorët jetojnë në këngë, ndaj u mendova të gjej këngën. Një këngë e kënduar nga Genti, me një tekst të poetit Munir Hoxha, një penë e njohur në shkrimin e teksteve të këngës:

... Po e pyesin valën e Drinit, /Të gjithë nxënësit po i thonë, / Pse na e le në mes mësimin / E na e more mësuesin tonë?/ Po përgjigjet Drini i Zi,/ E vajton me dhimbje shumë, / Sot mësues Veseli nuk do vijë / Se ia preva rrugën unë...

... Hapim derën e shkollës. Hyj në një klasë. Aq e thjeshtë, me një mobilim të viteve 1971, thjeshtë në minimum. Aty mësova se gjithsej janë vetëm 4 nxënës dhe një mësues, Imer Murati, që vjen nga Zall Kalisi dhe jep mësim këtu.

Zbresim në breg të lumit, kalojmë nëpër Shatorre, një emërim historik që nga pushtimi turk. Toka të sheshta që vetëm lumi e ndanë me Mejen e Xhitetit, dikur aty ka qenë qytet dhe sipas librit "Dardha në nëntë malet e Dibrës" të H. Ndreut, shkruhet: "... vera e kuqe kalonte nëpër tuba nga mërskani gjer poshtë breg lumit, ku butat e mëdha mbusheshin me këtë lang të shenjtëruar dhe atëherë qyteti ziente nga kënga e hareja..."

Bregu i Drinit nga të dy anët ku lag tokat e Dardhës ka bukuri dhe resurse turistike, me ujë të rrjedhshëm e të pastër, me vende me thellësi për not dhe të cekët për fëmijë, rërë të pastër e të imët në të dy anët me gjelbërim e hije shelgu. Kalojmë Shatorret, ja dhe Lagjja Topuze, si kufiri ndarës i Dardhës me Çidhnën.

Disa hapa para dhe kthej kokën pas. Jam duke ikur me mall të zbrazët, por e di që përsëri do të vij!





Visit Dibër

Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën, nuk e ke parë ende Shqipërinë!

Rruga e Arbërit nr. 159

turizëm

Turi historik -në gjurmët e Skënderbeut

Gjergj Kastrioti Skënderbeu është Heroi Kombëtar i Shqiptarisë.

Dibra është vendlindja e Gjergj Kastriotit dhe zotërimet e familjes së Kastriotëve i kanë dhënë emrin zonës së Kastriotit. Toponimet e shumta, gojëdhënat, legjendat për Familjen e Kastriotëve dhe Skënderbeut janë pjesë e muzeut të Skënderbeut në fshatin Sinë të Çidhnës.


Ai lindi më 1405 në Dibër, ndaj dhe në këtë zonë dita e Shën Gjergjit festohet me madhështi, duke bashkuar me festën pagane edhe ditëlindjen e Skënderbeut.

Skënderbeu u kthye në Dibër në 1443 me 300 kalorës dibranë, me të cilët iu drejtua Krujës, ku më 28 nëntor 1443 ngriti flamurin.

Skënderbeu zhvilloi 24 beteja kundër turqve, ndër këto 19 u zhvilluan në vendlindjen e tij në Dibër, duke triumfuar për 25 vite rresht.

Turi në gjurmët e Skënderbeut për 3 ditë ofron mundësinë e njohjes me këto ngjarje dhe vende historike.

KOHËZGJATJA:	**3 ditore**
LËVIZJA	**Me autobus dhe ecje në këmbë**
TIPOLOGJIA:	**Histori, kulturë, ecje në natyrë**
VËSHTIRËSIA:	**Niveli i lehtë dhe mesatar**









Dita 1

Kastrioti dhe familja e Kastriotëve"

8:30 Nisja nga Peshkopia

Eksperiencë në qytetin dhe Muzeun e Peshkopisë

Në këtë udhëtim të shkurtër në qytet mund të njihesh me historinë e lashtë të qytetit si një qendër "peshkopësh ortodoksë", por që është kthyer në qendër të fesë islame në vitet 1600, lagjja e vjetër me ndërtimet e saj karakteristike, rrugicat me kalldrëme dhe "pazari" të tregojnë një qytet të stilit ballkanik otoman.

Vizitë në muzeun e Peshkopisë në 3 pavionet e tij, ku flitet për të gjitha periudhat historike. Është pavioni i zbulimeve arkeologjike, pavioni i Mesjetës dhe me interes është pavioni i etnografisë së Dibrës.

10:30 Kafe në bulevardin e Peshkopisë

10:50 Nisja me autobus për në fshatin Kastriot

11:05 Vizitë në fshatin Kastriot

Ndalesa e parë në monumentin e Familjes së Kastriotëve, në fshatin Kastriot. Vizitorët njihen me toponimet që përdoren akoma si: Pusi i Gjonit, Ogradja e Gjonit, Kulla e Gjonit, lagjia e hershme Çelias, në të cilën kanë qenë katër kisha, përfshi edhe tre tuma ilire.

12:30 Vizitë në monumentin e Betejës së Torviollit

Ndalesa te Monumenti i Betejës së Torviollit, përshkrimi i betejës, përroit të Shkamajnit (Skampino), Kalaja e Volezës, e cila ishte nën administrimin e Familjes së Kastriotëve. Më pas kalohet te Kepi i Xhitetit, vendi ku nisi masakra e Çidhnës më 1466. Turi vazhdon me vizitën në Çidhnën e Poshtme, në Fushën e Mosdonës. Këtu vizitorët njihen edhe me pozicionin e Kalasë së Skënderbeut në Qafë Kala.13:00

13:30 Dreka te ferma e peshkut "Krashi"

14:15 Shëtitje dhe ecje në Kanionin e Setës, Kalaja e Skënderbeut dhe Kepi i xhitetit/qytetit

Me autobus do të shkojnë te Kepi i xhitetit / qytetit, ku vizitorët mund të ngjiten mbi kep që të shikojnë panoramën e grykës së Setës. Nga pika vrojtuese në kanalin e Setës dhe me pak ecje mund të tregohet Kalaja e Skënderbeut, e cila është natyrale dhe ka vendzbulime rrënojash të vjetra. Nga pika e vrojtimit të Sopanikës shijohet ujëvara dhe shpella e Sopanikës. Tregohet edhe shpella e Rusit apo shpellat e tjera.

16:30 Akomodimi te shtëpitë pritëse

Rekomandohet: **Vladimir Marku**

0686506061 markuvladimir@yahoo.com

19:00 Darka në shtëpinë pritëse

Dita 2

8:00 Mëngjesi i bollshëm te shtëpia pritëse

9:00 Vizitë në Muzeun e Kastriotëve në Sinë

Vizitorët njihen me Muzeun e Familjes së Kastriotëve, historitë dhe luftrat e Skënderbeut. Për të interesuarit vizitë në Sinë të Epërme për të parë Varrin e Ballabanit; Thanën e Skënderbeut; Ulësa (vendi i hedhjes së djalit të Skënderbeut). Udhëtimi është me autobus.

10:30 Nisja për Peshkopi

11:15 Vizitë në Agro-turizmin "Zerja"

Vizitorët njihen me qendrën e përpunimit të prodhimeve artizanale të jufkave, komposto frutash, veshje dhe prodhime artizanale nga grupi i grave, me teknologjinë e prodhimit të rakisë së shtëpisë, si dhe të fermës së vogël afër qendrës agro-turistike.

12:00 Dreka tek Agro-turizëm "Zerja" me gatime tradicionale

13:00 Nisja për në Kalanë ilire të Uskanës në Grezhdan

13:15 Vizitë në Kalanë e Uskanës në Grezhdan. Turi arkeologjik

Kalaja në Grezhdan ka qenë e banuar nga fisi ilir i Uskanës dhe mendohet se është kalaja më e madhe në Ballkan për nga sipërfaqja.

14:30 Nisja nga Kalaja e Uskanës në Grezhdan për në Kërçisht

14:45 Opsioni 1: Vizitë në kishat ortodokse bizantine të Kërçishtit

Vizitorët njihen me historikun e fshatit Kërçisht, fshat me 5 kisha bizantine, që tregojnë për një ndikim të madh në periudhën e Bizantit. Kisha e Shën Dhimitrit dhe Shën Ilias janë të rrënuara nga afresket, por akoma të vizituara nga besimtarët ortodoksë. Kthimi për Peshkopi pas 2.5 orë shëtitje në Kërçisht.

14:45 Opsioni 2: Vizitë në qendrën balneare në Banisht

Vizita do të jetë opsionale. Do të kalohet kufiri me Maqedoninë. Vizitë në qendrën balneare muzeale të Banishtit. Sipas dëshirës, mund të bëjnë një banjë me ujë të nxehtë ose një cikël terapie masazhi me baltë. Mundësi shëtitje në shtegun malor rreth kompleksit ose të shijojnë kafe në lulishten e qendrës. Koha e qëndrimit 3 orë.

17:30 Nisja për në Peshkopi

18:00 Akomodimi te njësi speciale akomodimi turistik

Sugjerohen:

GUEST HOUSE "KONAKU"

0692053492 hsalkurti@gmail.com

AGRO-TURIZËM "DASHE ZERJA"

0699377337 fabianzerja@gmail.com

GUEST HOUSE "UKA"

0673625835 udhetomegresin@gmail.com

KAMPINGU "KAPXHIU"

0692258182 campingpeshkopi@gmail.com

HOTELET E QYTETIT:

Adresat i gjeni tek: www.visitdiber.com

19:00 Darka. Rekomandohen larmi darkash tradicionale

Dita 3

Vizitë në vendin e betejave të Skënderbeut

7:30 Mëngjesi bollshëm te shtëpia pritëse

8:30 Nisja nga Peshkopia

Vizitë në fushëbetejat e Skënderbeut në Bulqizë

Fushë Bulqiza dhe Gryka e madhe janë vendi i shumë betejave dhe legjendave të Skënderbeut. Një ndalesë në fshatin Peladhi, ku janë bërë më shumë se 3 beteja dhe që lidhet me legjendën e veshjes së dhive me qiri sikur të ishin kalorës, dhe nga ku ka marrë edhe emrin fshati sot Peladhi.

Legjenda e fshatit Vajkal, i cili mendohet se vjen ngaqë edhe kali filloi të qante për vdekjen e Skënderbeut, si dhe shumë toponime apo rrënoja që lidhen me Skënderbeun.

Një vizitë te kulla Hupi, do të ishte prekja e të vërtetës.

12:30 Dreka te Kulla Hupi. Dreka tradicionale

14:00 Nisja për Tiranë

16:10 Kafe dhe ndalesë në Shkopet, buzë liqenit që është dhe mali i Skënderbeut

17: 40 Mbërritja në Tiranë

Ky projet u mbështet nga D2T "Dibra: Turizëm dhe traditë"

cyan magenta yelloë black





www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

BOTIMET M&B

Mund ti porosisni edhe onlinë përmes platformës
www.bukinist.al



skicë

Çfarë ka ndodhur vallë me këto peizazhe fshati? Përse vallë edhe udhët kryesore drejt qytetit mbartin hijen e vdekjes së ngadalshme? Po çfarë është kjo vetëzhdukje e mjegullt, pa shpërthime, pa zhurmë...

Fshati që s'bzan

Nga **SELMAN MËZIU**





Ka fëmijë që lindin rriten, martohen dhe bëhen me fëmijë, por nuk dëgjojnë a nuk shikojnë. Fatkeqësi njerëzore, e dhimbshme, fatëlume, gurrë vuajtjesh trishtuese. Kemi mundësinë tjetër që në tallazet e jetës ndodh që njëra shqisë ose tjetra dëmtohet pa rikthim. Të gjitha këto janë shtjellime të jetës që vuajtësi e bashkëvuajtësi i përcjellin me durim e marrëdhënie të barazpeshuara. Nuk habitemi aspak kur në çaste të caktuara, dëgjohen zëra çirrëse, të bërtitura, të shara etj. Sepse populli thotë: "Edhe zorrët në bark ndonjëherë ngatërrohen".

Lëviz, vrapoj udhëve të fshatit e krahinës time. Kërkoi të sjell ndërmend ndryshimet shumë të vogla por edhe të mëdhatë. Kuptohet, kjo për të gjykuar mbi ato të ndodhura përgjatë një viti. Qoftë këto udhës së zhvillimeve apo të kundërtën. Pa çka, se kur, vështron, prek, shikon me sy, blloqe pemësh të thara, ara djerr, shtëpi të shkatërrueme, përbrenda shpërthejnë duhmat e zemërimit. Dhe më tej, dëgjon gjatë bisedave mbi ikjen e rinisë, fëmijëve adoleshent, grave më një, dy ose tre fëmijë drejt udhëve të pa krye të kurbetit ose në kampe. Tkurresh. Përpiqesh t'i kapërdish, por të dridhurat të tradhëtojnë dhe atëherë... E pyes veten: Ku ndodhem këtu?

Në vendin ku me përllogaritje të thjeshta, del përfundimi: Ikje masive të të rinjve të shkolluar ose jo. Duke sjellë në jetën e dy palëve, strese mendore, lot rrëke nënash, fëmijësh të mitur, për ndarje familjare, syrgjynosje detyruese. Plagët e idhta janë ngulur thellë në jetën e gjithësecilit shqiptar brenda e jashtë mëmëdheut. Udhët e gjëra e të ngushta janë mbyllur nga ferrmanat gjëmbashpuse, kulumbriat, trandafilat e egër etj.

Natyra gjithëpushtuese ka mbjellë gjallesat e saja në çatitë apo ulluqet e kasolleve e shtëpive. Ne mesin e gërmadhave, kanë gjetur strehë hardhucat, minjtë, pse jo dhelpra e fole grenzash e buburreca. Kuptohet farat e drurëve e shkurreve kanë dhanun rezultate. Ndërmjet gurëve e baltës apo gëlqeres, në mes tullës e qitave diellpjekur, barërat lloji shumta, shkurre e drurë tanimë jeshilojnë paturpësisht mbi gërmadhat e shtëpive të shpërfytyruara e të braktisura nga i zoti. Peizazhi bëhet rrënqethës i mërzitshëm, dërmues shpirtëror e moral kur shtëpitë prej guri gëlqereje, me dyer me harqe guri të gdhendura me daltë mjeshtërish, trekatëshe i shikojmë ngado gjysmë të shembura. Pjesa tjetër i ngjan një kafshe gjigante të kafshuar egërsish nga grabiqarët, banorë të mjedisit të fshatit përreth.

Përqark këtyre gërmadhave, të pushton trishtimi, frika, nga pamja zgavra - zgavra e ngërdheshje muresh në çdo lagje, fshat krahinë etj. Nata është e mbushur me dallgë frike drithëruese, jo nga zani i bretkocave pranë ujërave të përrenjve e hurdhave, por nga arushat, ujqërit, dhelprat që tanimë janë bërë zotër të vërtetë. E natyrshëm më lind pyetja: Përse vallë nuk dëgjoi blegërima qengjash, delesh? Po keca që kërcejnë përse nuk i shikoj? Pranoj edhe pllitje gomarësh apo hingëllima mushkash e kuajsh. Gëzohem si fëmijë të shoh një klloçkë me zogj përqark. Por, jo. Fatkeqësisht, ato nuk i shikoj, nuk i dëgjoj. Pres të më përshëndesin "tunjatjeta", "mirëmëngjes" ose "mirëdreka", por...

Kaloj rrugicave të fshatrave, Fushë-Muhur, Shqath, Hurdh-Muhur, Vajmdhej, Sheher, Shorokan e Bulaç heshtje varri, peisazhe ngërdheshëse, pezmatuese, keqardhëse. Nuk e di pse dikur gumëzhinte shkolla nga vogëlushët, e të përshëndesnin "mirëmëngjes", burrat e gratë udhëve që zienin për të kryer shërbimet e ditës apo shkuar në punë. Ndërsa në zabelet, luginat, shpatet dëgjohesh muzika e këmborëve, blegërimat dhe thirrjen në emër, me një zë gazmor të bariut të deleve, dhive apo lopëve. Ato veçse notojnë në kozmoset e mendjeve të bashkëfshatarëve të mi shpërndarë gjithëkund në botën e ftoht grabitqare, të shpirtrave të trazuar. E pleqve, që me duar në gji, kokëulur e të skeletuar nga dhimbjet e vuajtjet, kujtojnë jetën e perënduar.

Çfarë ka ndodhur vallë me këto peizazhe fshati? Përse vallë edhe udhët kryesore drejt qytetit, mbartin hijen e vdekjes së ngadalshme? Po çfarë është kjo vetëzhdukje e mjegullt, pa shpërthime, pa zhurmë. Sigurisht, pa ulurima, vetëtima, plasje topash e zhurmë pushkësh. Si shpjegohet kjo vdekje, shuarje, zhdukje e ngadaltë pa aromë baruti, pluhura bombash, klithma të vrarësh e të plagosurish?

Askush nuk bzan. Askush nuk bërtet me të madhe: Çfarë po bëni kështu o njerëz të mirë? Përse juve rini vullkanike e fshatit, shpresa jonë, mbani sytë e vërshoni drejt perëndimin? Përgjigja u ngecet në fyt. Dikush iu ka vrarë shpresën. Dikush ju ka thyer moralin. Dikush nuk ka menduar e punuar për juve. E atëherë! I braktisën. I gënjyen e mashtruan për tre dhjetëvjeçar. E tani nuk bzan askush. Mjerisht. Fatkeqësisht. Veçse ikje, ikje. Oborret e shtëpive i ka mbuluar bari e ferrmanat. Ndërsa drynat e ndryshkur kanë mbyllur dyert e tyre.

Muhurr, korrik 2019

Ariu i fshatit tim



Ishte mëngjes pranvere, ndihesh aroma e luleve e cicërima e amël e zogjve. Ndërsa përroi gurgullonte i shkumëzuar në shtratin zallor, mbuluar prej degëve të shelgjishteve të sapo gjethëzuara. Majmalet ende zbardhëronin nga bora, me dhëmbëzime sipas relieveve.

Shtëpitë të shpërndara në rrafshina, kodra e kodrina dukeshin si njollëza të bardha në mes gjelbërimeve. Të cilat çuditërisht pakësoheshin dita-ditës. Udhët e holla filluan të ngushtoheshin nga degët e bimësisë të harlisur. Bari po zëvendësonte pluhurin e gurishtet e shumta. Jo rrallë shikoje jashtëqitjet e kafshëve të egra livadhëzave, shpateve e buzë vijave të ujit.

Një buzë mbrëmje Gëzimi në zabelin e veshur me pyll shkoi të marrë dhinë e vetme me kecin laraman. Iu afrua atyne me një thupër që mbante në dorë. Ato përpara e Gëzimi mbrapa po ktheheshin udhës së zakonshme. Papritur, u dëgjua një zhurmë fare pranë. Një fështërimë e lehtë. Ai nxitoi hapat se pylli i sapo krijuar të fshehta ruante gjithnjë. Zhurma po shtohej. Fëmijës po i rrihte zemra fort në gjoksin njomzak.

Në të dal të pyllit ai ktheu kokën. Një ari trupmadh, qetësisht po ecte drejt tyre. Nxitoi duke fshikulluar dhinë me kecin. Iu afrua shtëpisë shumë afër. Fatmirësisht nuk dëgjonte zhurmën e putrave të ariut. Ktheu kokën prapa me përtesë e frikë. Ariu ishte ulur në një copëz livadhi. Kundronte luginën piktoresk dhe shtratin e prroit. Gëzimi hyri në avllinë e shtëpisë.

-Pse jeni zverdhur kështu biri im,- e pyeti nana e shqetësuar.

Ai i tregoi me një za të shqimur e drithërues ngjarjen me ariun. Ajo përpiu bisedat në fshatin e mplakur. Të zbrazur nga njerëzit. Të cfilitur nga vuajtjet. Peizazhet natyrore mrekulluese ndjenin zbrazëtinë njerëzore. Cicërimat e zogjve nuk përziheshin me blegërimën e shqerrave e zërat e vogëlushve. Ato pak toka ishin kthyer në djerrina.

Blerimi një plak zevzek, sapo dëgjoi ngjarjen në një bisedë në klubin e fshatit tha:

-Eh, çfarë thua, këtu kanë mbetur lopët, pleqtë me plakat.

Debati u ndez i ashpër. Secili sillte shembujt nga jeta e këtushme. Ato flisnin plotë lot malli e dhimbje për fëmijët që skllavëroheshin në dhè të huaj. Kockat tona u mbollën kudo jashtë truelleve tona.

- Rinia i ka sytë jashtë, vetëm t'u lidhësh thesin, se ato s'mbahen ma - ndërhyri Blerimi.


Shkurt. Këtu çdo gjë ka marrë fund. Natyra do të vetëpushtojë gjithçka. Njerëzit e ikur do të kujtojnë se ka qenë një herë fshati Bukmirë.

Selman Mëziu

traditë

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve
Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri,
Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

- ***Kaç e puth*** - *Káç e púth: Kjo shprehje shërben për të treguar dy persona që në raportet e tyre prishen dhe rregullohen shpejt, e kjo ndodh shumë shpesh.*
- ***Duel (e çitëm) kren'sh*** / *Dūel ... e çítëm .. .e bám'... krén'sh: Doli, e nxorëm, e bëmë ... krenësh). Përdoret për ndonjë rast kur nuk jemi të sigurt se do t'ia arrijmë të ndajmë diçka, duke i dhënë secilit pjesën e vet.*
- ***Menja n'rrafshe e toka n'brinjë****: Mendja në rrafshe dhe toka në brinjë.*

  Thuhet për dikë që nuk do t'ia dijë, me mendje të rrafshuar dhe i qetë pavarësisht se nuk ka shtroje dhe fle në brinjë. E nëjtë me Mendja n'thatë e toka nër ujë.
- ***Muer n'thue: Mori në thua.*** *Thuhet për dikë që preket lehtë, preket me një fjalë, që nuk duron fare; për dikë që zemërohet punë e pa punë.*
- ***Han n'kasht' t'samarit:*** *Përdoret me kuptimin: që s'ka asgjë për të ngrënë, që përpiqet të mbijetojë me rezervat e veta. Thuhet për dikë që është shumë i varfër.*
- ***Ia çiti kashtën samarit*** / *Ia çíti káshtën sámarit: Ia nxori kashtën samarit. Përdoret me kuptimin e prishi punën fare, e dërmoi muhabetin. Jo rrallë herë përdoret edhe varianti identik me të mësipërmin: E la për dërrasash, ia hoqi kashtën samarit.*
- ***Kërkon klluf k... e merr pall' bith's*** / *Kërkon kllúf k.... e merr páll' bíth's: Kërkoi klluf k... e mori pallë bythës. E njëvlershme me Shkoi shyta për brinja e la vesht.*

FJALË TË RRALLA

- ***dari*** / ***darí-a:*** *Darovi, dari*. Nga sll. *dar, darov, dhuratë*; *daroviti, dhuroj*. Dhuratat që përgatit nusja për njerëzit e burrit. Tek Çabej, *darovi*. Nusja kishte sjellë *dari* të madhe. Me fjalën *dari* lidhet dhe folja *daris,* e cila përdoret me kuptimin *jap, dhuroj*.
- ***drugj'*** / ***drúgj'-a:*** Një copë dru rreth 30 cm në të cilin mbështillet peri për të endur pëlhurën e leshit: *Ti or pashë s'i din k'to rrugja / se n'Çidhën nrajshe tajret drugja* (pop.).
- ***dredh':*** Një fashë lëkure e gjerë deri 1 cm, që nxjirret nga lëkura e lopës dhe që shërben për të thurur a qepur opingat e bëra me lëkurë lope. Quhej *dredhë* pasi ajo gjatë përdorimit përdridhej e bëhej si gjalmë.
- ***dërtnall*** / ***dërtnáll:*** Tek Çabej, *dërtnall,* me kuptimin *vrapon me të katërta*. Në të folmen e vendit përdoret me kuptimin: *i trashë; që s'di çfarë bën*. Njëri *dertnall*.
- ***drage:*** I vogli i maces, *koteleja*. *I mbante në krah si macja draget*. Te Çabej, *drage*, peshk i ujërave të ëmbla.
- ***(o) drêêê!!!*** - Pasthirmë; shpreh habi e pakënaqësi. E sjell edhe Çabej, por në formën *drë*. *Ç'na gjeti*! Fjala *dreq*, e shkurtuar, për bestytëni.
- ***dispjek:*** Grabis gjithçka. *Nuk i lanë asgjë, s'i ka mbetur asgjë. E bënë dispiak. Kanë hyrë në shtëpi dhe më kanë bërë dispiak*. Çabej e lidh me *inat*.
- ***dëgram:*** *Dogram, e plotësuar, e kompletuar, në mënyrë perfekte*. Kishte një shtëpi *dogram*. Tek Çabej, me kuptimin *punime zdrukthtarie*.
- ***dëknajs:*** *Dokëndis*, tek Çabej me kuptimin *bie rëndë në stomak; i bëj dëm shëndetit; prek në sedër*. Në Dibër më së shumti përdoret me kuptimin *këmbëngul*: *I doknajsi nji dhajmcë* në stomak.
- ***dullak:*** Çabej përmend formën *duvak* dhe jep shënimin: *një rrobë në formë thesi që u vihej nuseve gjatë transportit nga shtëpia e tyre deri te shtëpia e dhëndrrit*. Fjalë me burim nga turq. *duvak, vello*. Figur.: *kur i fola, u bë dullak i kuq*.
- ***disi*** / ***disi*** / ***dísi:*** Me këtë fjalë nis tregimi i një ëndrre. Përdoret shpesh deri në përfundim të ligjërimit. Përmendja e fjalës *disi* na bind se kemi të bëjmë me ëndërr.
- ***denajk/ dënajk:*** *Danik, ndaras të tjerëve*. Që rrin ndarë nga të tjerët, nga grupi. *Dukej se ishte i mërzitur se rrinte danajk*. Përdoret edhe si folje në formën *danajk-u*, me kuptimin *veçoi, ndau*: *danajku disa lekë dhe të tjerat m'i ktheu mua* (bised).

ANEKDOTA E MUAJIT

Burrat në shtëpi e nusja në mulli

Në një fshat të Gollobordës ishin tre vëllezër, por që të tre dembela. Për punë nuk ia thoshin fare. Kur u martua vëllai i madh, sikur ranë rehat. Të gjitha punët ua bënte nusja. Një ditë, kur nusja futet në magje të zinte bukën, shikon se mielli ishte mbaruar. Futet në dhomën ku rrinin vëllezërit bashkë e loznin domino dhe u thotë:

- Në magje nuk ka miell, duhet të shkoni në mulli, ndryshe nuk kemi bukë për darkë. Njani prej vëllezërve i kthehet nuses:


- Po shko, moj nuse, në mulli, ç'pret? Nusja, kur u bë gati të shkonte në mulli, ndaloi dhe njëherë dhe pa ato meshkujt e shtëpisë që loznin domino pa e prishur terezinë:

- Besa, vetëm kjo punë nuk është e mirë. Tre burra në shtëpi e të shkojë nusja në mulli, sikur nuk bën. Po, nejse, unë po shkoi, por haram i qoftë mullixhiut po nuk ma bluajti mua drithin pa ren.

Marrë nga vëllimi "Gurrat e Korabit",
Botimet "Email", Tiranë 2012

TREGIM ALEGORIK

Shërbëtori dhe zotëria



Buka e magjes së popullit
Tregime alegorike
Xhafer Martini
Botimet M&B, 2019
ISBN 978-9928-256-59-1
Faqe 160
Çmimi: 700 lekë

Librin mund ta gjeni te Botime M&B, Rr. "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9. Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441 (WhatsApp). E-mail: mbbotime@gmail.com Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion, #Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së librit në Tiranë.

Një djalë u pajtua shërbëtor. Paga ishte e vogël, por nuk kishte ku të gjente punë tjetër. Shërbëtori u pajtua të punonte në derë e jashtë. Por zonja, shpeshherë, meqë kishte lindur dy binjakë, e fuste midis dy djepave që t'i tundte derisa t'i zinte gjumi. Po kjo ishte punë e vështirë se, sa zinte gjumin njërin, zgjohej tjetri me të lebetitura.

Shërbëtori një ditë iu ankua zotërisë për tundjen e djepave dhe tha se duhej t'ia shkruante në kartë të gjitha punët që kishte për të bërë. Zotëria vetëm nuk i tha se "je i pushuar", por inat e mori. Shkroi në një letër një vandak punësh që kishte shërbëtori, deri në hollësi, si fjala vjen, të mbante kalin për t'i hipur zotëria.

Djali e mori letrën dhe e futi në xhep. Pothuaj i dinte përmendësh punët që kishte për të kryer, megjithatë letrën e mbante me vete. Kur zotëria shkonte në bjeshkë për të parë bagëtinë në stane, shërbëtori i hiqte para kalit. Në një nga këto ditë, kali u tremb dhe e zuri zotërinë nën vete. Kishin rënë në vend të keq, si punë grope, dhe kali nuk mund të ngrihej.

Zotëria ia bënte me shenja shërbëtorit që të vinte dhe ta shpëtonte, se kali po e mbyste.

Shërbëtori nxori letrën ku ishte shkruar vandaku i punëve që duhej të bënte dhe pa se nuk kishte punë të tillë: ngritje të kalit kur ai zë poshtë zotërinë. Shkoi afër dhe i tha:

Unë kam për detyrë të ndihmoj zotërinë tuaj të hipë në kalë, por nuk kam detyrë të ngre kalin kur ai u hipën juve.

Rruga e Arbërit nr. 159

“Një copë nga jeta ime...”.

tregim i jetuar

Udha e mundimshme drejt lirisë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Ai tërhoqi karrigen e, pasi bëri të kërkëllejnë nga pesha e trupit të katër purtekat mbështetëse të saj, hodhi në tavolinë, si të hidhte kartën e fatit të tij, një zarf të fryrë.

- Lexoje në shtëpi, - tha me zë të vendosur. Bëj me të në daç roman, në daç komedi, në daç film me metrazh të gjatë. Është një copë nga jeta ime në emigracion.

Ngriti dorën lart dhe i dha urdhër në shqip kamerierit që të sillte tre raki Përmeti...

E lexova dhe e rilexova. Ai tha: “Është një copë nga jeta ime”. Edhe ju, kur ta lexoni, jam i sigurt se kështu do të thoni:

“Një copë nga jeta ime...”.

Dhe do të merrni lapsin e do të shkruani, do të shkruani derisa copat të mblidhen bashkë, duke formuar të tërën: romanin, komedinë, tragjedinë, elegjinë emigratore...

* * *

...Tre herë kam hyrë në Greqi. Herën e parë ndoqa malet. Të ashpra malet tona, më të ashpra malet e grekut. Them më të ashpra se veç borës dhe akullit ata na ndillnin edhe frikën e ushtarëve, që siç kishim dëgjuar të rrihnin pa i numëruar shkopinjtë e gomës. Nuk arrita të zbres në tokë të zezë. Një djalë i ri, tek të tetëmbëdhjetat, pasi qe lagur deri në palcë duke kaluar lumin, ngriu natën në kasollen e barinjve ku u ulëm për të dremitur. U ktheva me trupin e tij pa jetë...

...Herën e dytë bleva një vizë. Dhashë njëqind e pesëdhjetë mijë dhrahmi nën dorë. Viza ishte një mujore...Punova gjashtë muaj tek një inxhinier grek që ndërtonte shtëpi në një ishull afër Athinës me paratë që i jepte gruaja e tij mjeke. Manolis, kështu e quanin, kishte një parullë të vetën: “Gurë - xhaba, shqiptarë-xhaba, pse të mos bësh vila e pallate xhaba?”. Gurët ai i merrte qyl nga një gurore, betonin e çimenton nga punimet që bënte për llogari të bashkisë. Shqiptarëve u jepte aq para sa të hanin bukën thatë. - Të tjerat, - u thoshte, - do t’i merrni kur të mbarojnë punimet. Disa ditë përpara mbarimit të punimeve ai lajmëronte policinë dhe...

Kështu më ndodhi edhe mua. Më kapën befas tek platia në bregun e detit në Selina, tek po i jepja dorën e fundit një muri me gurë. Më kopanisën mirë e mirë dhe pas disa ditësh, xhepgrisur, më shkarkuan në Kakavi, siç shkarkojnë makinat rabël zhavorrin e lumit...

...Herën e tretë ia futa nga Maqedonia. Në Bllatën matanë kufirit na priste një taksi që, pasi kaloi Dibrën e Madhe, luginën e Radikës, pak përpara Gostivarit mori djathtas e na shkarkoi në Gjevgjeli. Kufirin e kaluam natën. Rrugën e dinim me të thënë. Duhej të ecnim gjithë natën pa pushim, derisa të takonim një lum dhe shinat e trenit. Një natë e errët, me shi, me bubullima e vetëtima, një udhëtim që as në Ferrin e Dantes nuk gjen krahasim...

Këtë radhë u vendosa në Marus, një lagje krah e lagjeve të pasura. Në fillim u strehova në një apothiq, një si lloj depoje nën katin përdhes. Këtë radhë u tregova më i kujdesshëm. Greku që më mori në punë kishte qenë vetë emigrant. U soll me njerzillëk. Paratë, pak ishin, por m’i jepte rregullisht. Që t’i shpëtoja goditjes së parë të policisë, një ditë shkova në rrugën Zinonos dhe me pesëmbëdhjetë mijë dhrahmi u bëra “vorio-epirot”, “vorio-epirot prej Lume” kur thonë. Atëherë Athina qe mbushur me zyra që, pasi të rrjepnin mirë e mirë, të jepnin një kartë në ngjyrë jeshile, me fotografi, firma e vula. Karta ime mban numrin protokollar 306 dhe është lëshuar më 19 shtator 1996. E ruaj akoma atë kartë, e ruaj si kujtim për ditët e vështira...

Më vonë, kur u sistemova pak a shumë mirë dhe mblodha një dorë para, pagova dhe solla familjen, gruan dhe tre fëmijët...

Kështu i mblodha ditët dhe netët derisa dolën dy Dekretet Presidenciale për Regjistrimin dhe Legalizimin e Emigrantëve të huaj në Greqi, dekreti për “Dhënien e Kartës së Qëndrimit të të Huajve për një Periudhë kohe të Kufizuar” dhe dekreti “Kërkesa dhe procedura për qëndrimin dhe punësimin e ligjshëm të të huajve në Greqi, të cilët nuk janë shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian”. Daljen e dekreteve e mësova më 28 nëntor 1997. Ai u dha si sihariq në një takim që ambasadori i atëhershëm në Greqi Kastriot Robo organizoi me emigrantët në Karavel me rastin e Ditës së Pavarësisë Kombëtare...

...Ishte hapur drita jeshile për të gjithë. Veçse, për të arritur deri tek “jeshilja”, maratona greke nuk matej tashmë me kilometra, por me vite pa mbarim. Qindra-mijërat e emigrantëve të përfshirë në këtë “maratonë”, sapo mateshin të thonë fjalën magjike “Fitore”, u këputej zëri dhe binin përdhe pa ndjenja, për t’u ngritur të lodhur e të sfilitur për të vrapuar në të tjera e të tjera maratona...

Dhjetori i ‘97-s ishte një muaj “njohjeje”. Na duhesh të njiheshim me ligjin e ri, me rregullat, me hapat e vegjël dhe të mëdhenj që duhet të hidhnim, me zyrat e zyrtarët. E bënim paksa të gëzuar. Tashmë nuk kishim frikë të dilnim në rrugë. Fshesa e tmerrshme që na pat rënduar si “Shpata e Demokleut” mbi qafën e holluar nga ankthi e vuajtja kishte ngrirë. Janari ishte muaji i radhëve të gjata, i ngritjes para mesnatës për të zënë radhë para zyrave të OAEDH-it si një herë e një kohë në radhë të qumështit. Nuk e di se kush na kish nëmur ne shqiptarëve. Prometeun e dënuan Perënditë e Olimpit se u shpërndau njerëzve zjarrin. Kjo dihet si nga gojëdhënat dhe mitet, ashtu edhe nga tre veprat e Eskilit të lashtësisë. Sizifin dhe Gurin e tij e dimë po ashtu nga legjenda. Po ne kush na mbërtheu në shkëmb që “zogu i zi” të na hajë mushkëritë e kush na e hodhi nën këmbë Gurin e rëndë të Sizifit për të qenë tërë jetën, brez pas brezi në radhë?

Nejse, ta lëmë historinë dhe mitet, të zbresim në radhë, të vetmen pronë tonën. Mua e familjes sime më ra shorti të jem nën hijen e OAEDH-it të Patisionit, të zonës më të populluar nga emigrantët. Kështu që edhe radhët ishin pa mbarim. Një mëngjes edhe për ne lindi dielli. Arritëm të regjistroheshim në zyrat e OAEDH-it. Dokumenti im i parë legal në Greqi mban datën 23 shkurt 1998 dhe ka numrin 5584...

Këtu fillon maratona e vërtetë. Që të bëheshim të ligjshëm duhej të fillonim vrapime të tjera, duheshin zënë radhë të tjera “qumështi”. Radhë e rantevu për radiografinë e gjoksit, radhë tek mjeku për të marrë vërtetimin “klinikisht i shëndoshë”. Këtë të fundit, pasi ishte tepër e vështirë ta merrja në Athinë, me radiografinë në dorë shkova dhe e mora në Kuluri të ishullit të Salaminës. Më i forti dhe më i lodhshmi ishte takimi në polici, ku duhej t’i nënshtroheshim një hetimi dhe duhej të ngjyenim me bojë të zezë duar e gishtërinj për t’i vendosur mbi një formular ku ishte ngjitur fotografia. Nuk e harroj dot arrogancën dhe ofendimet e policit që shante si rrugaç tek më lyente duart me bojë. Ksenofobia dhe racizmi asokohe ishin shpërndarë si farat e hithrit dhe të digjnin jo trupin, por shpirtin, ta digjnin aq shumë sa zemërimi vinte në rezonancë dhe vetëm kur kujtoje se çfarë do të bëhej me fëmijët, ta mbante pështymën në gojë për të mos ua hedhë në fytyrë racistëve e ksenofobëve.

E lodhshme, por shprehëse e zbatimit butaforik të ligjit, ishte pamja para Ministrisë së Drejtësisë. Sikur dikush të kishte filmuar asokohe, nga lart, ballazi, anash dhe nga mbrapa kuadratet në radhë në hapësirën e gjerë që i paraprinte Ministrisë së Drejtësisë, me siguri do të kujtonte legjionet e skllevërve të udhëhequr nga Spartaku kundër kështjellave të Romës së lashtë. Madje, ndonjë kineast, me ndonjë ndërhyrje të vogël kompjuterike mund t’i montonte në filma të lashtësisë pa pas rrezik se ndonjë do ta hetonte ngjarjen. Edhe atje arrita të depërtoj, siç arritën të gjithë. Këtu paguam 500 dhrahmi për shpenzimet postare mbasi thuhej se dokumentet tona do të kalonin kufirin dhe do të ktheheshin përsëri në Greqi. Kjo maratonë, më e gjata, zgjaste të paktën një vit dhe ishte vënë në radhë si e fundit dhe më kryesorja për të marrë kartën e gjelbër.

Kishte edhe maratona të tjera me radhë të gjata “qumështi” si ajo për përkthimin dhe legalizimin e certifikatave familjare dhe të fëmijëve, certifikata që asokohe nuk kalonin paraprakisht nëpër verifikime e vula ambasadash, sigurimi i numrit të amzës dhe marrja e kartonëve në zyrat e IKA-ve, regjistrimi dhe marrja e AFM-së në Eforia. Një dimër, një verë dhe një vjeshtë vazhdimisht në radha të gjata, me humbje të tëra ditësh pune, me shpenzime nën dorë e mbi dorë, “dhoro” të detyruara për zyrtarë e avokatë. Erdhi një moment që duheshin patjetër pesëdhjetë ditë siguracione. Po ku t’i merrnim ato kur ende nuk kishim marrë kartonët e IKA-ve, kartonë të cilët thuhej se do të dilnin për tre muaj e nuk dilnin as për pesë? Ku t’i merrnim kur padronët na shihnin si skllevër të lirë pune dhe as morali e as shteti nuk i detyronte të jepnin ditë sigurimi? Në fund u gjet një rrugë. Një letër nga OADH-i më sugjeronte që të paguaja 15.000 dhrahmi në një bankë bujqësore si shenjë se jam siguruar në OGA. Kjo pagesë më dha mundësinë që më 21 tetor 1998 të marr “Kartën e bardhë”, kartë e cila kishte vlerë deri më 31 dhjetor 1998. Karta kishte numër 101209-5584. Që të merrja “kartën jeshile” duhej “karta e pastërtisë” e Ministrisë së Drejtësisë, kartë e cila do të arrinte në dorën time në maj të vitit 2000... Më 4 maj të vitit 2000 do të merrja për herë të parë në dorë “KARTA PARAMONIS-PERIORISMENIS HRONIKIS DIARKIAS në të cilën ishte shkruar numri serial i saj, numri i regjistrit dhe i amzës, adresa e banimit, emri i gruas dhe i fëmijëve si dhe koha e mbarimit të saj, 3 maj 2001. Karta e parë e lirisë kishte vlerë si leje qëndrimi për mua, gruan dhe fëmijët. Ajo ishte edhe leje pune. Në të njejtin dokument ishin ligjëruar edhe leja e qëndrimit edhe leja e punës.

Një vit më vonë, duke respektuar ligjin, pesë ditë përpara se të mbaronte leja e qëndrimit u paraqita përsëri në OAEDH. Tashti e tutje, për rinovimin e lejes së qëndrimit procedurat ishin tepër të thjeshta. Duhej paraqitur një kopje e lejes së qëndrimit, një deklaratë përgjegjësie ku të thoje se gjithçka ishte e vërtetë, një fotokopje e ditëve të siguracionit që nuk duhet të ishin më pak se 150 dhe tre copë fotografi. Në moment merrje një vërtetim dhe pas dy muajsh merrje leje qëndrimi për dy vjet. Pas gjithë asaj maratone të lodhshme erdhi një moment kur menduam se “radha e qumështit” ishte vetëm një legjendë, një mit si legjendat dhe mitet e lashta greke.

Nuk ndodhi kështu. Grekët janë të lidhur shumë ngushtë me legjendat dhe mitet e tyre të lashtësisë. Edhe ne shqiptarët siç duket qenkemi të lidhur këmbë e kokë me radhët e produkteve të blegtorisë...

Nuk ishte tharë akoma boja e vërtetimit dhe nuk ishte shuar shpresa se pas dy muajsh do të merrja leje qëndrimi dyvjeçare kur një ligj i ri bëri krye në parlamentin grek. Ligji u trumbetua si bashkëkohor dhe që ishte sinkron me ligjet e Bashkimit Evropian. OAEDH-i me rikthimet e kartës së gjelbër (të skaduar) të prerë deri në gjysmë me gërshërë u çlirua nga detyrimet tashmë simbolike që kishte. Struktura të tjera morën lokale me qira në lagje të ndryshme të Athinës e në të gjithë Greqinë.

Veprimi i parë i detyrueshëm ishte marrja e një vule në periferia, diku afër një kishe në afërsi të rrugës Ermu në Sintagma. Vula e shtynte lejen e qëndrimit deri më 30 qershor të vitit 2002. Ajo vulë ishte krisma e pistoletës për maratonën e re.

Në rrugën Qefalonias u hap një njësi e re regjistrimi e dorëzimi dokumentesh . E reja e ligjit dhe vlera e vërtetë e tij, ishte se personat që nuk kishin arritur të regjistroheshin në vitin 1998, ose që nuk kishin marrë dot gjatë kësaj periudhe kartën e gjelbër për mungesë ensimash, si dhe personat e tjerë që kishin ardhë më vonë por që vërtetonin se para daljes së ligjit ishin në Greqi, mund të regjistroheshin. E keqja e madhe e ligjit ishte se leja e qëndrimit me lejen e punës ndaheshin dhe se bashkimi familjar kalonte nëpër vrimë të gjilpërës. Aplikantët, pasi kishin dorëzuar më se një duzinë dokumente të ndryshme merrnin një leje provizore gjashtëmujore qëndrimi...

Kësaj kohe i takon edhe lindja e detyrimeve financiare që lidheshin jo vetëm me pagimin e siguracioneve, por me taksa që nën sebepin e përballimit të shpenzimeve si rezultat i shumëfishimit të personelit tashmë të ndarë në tre parti, partinë e lejes së punës, partinë e vërtetimit nga bashkia se ke dorëzuar dokumentet dhe partinë e prefekturës që do t’i shqyrtonte dokumentet dhe do të jepte nëpërmjet bashkisë pullën e lirisë. Taksa ishte 147.5 euro për person. Kësaj periudhe i takon edhe hyrja në valle e ambasadave. Për të vërtetuar se një certifikatë familjare apo individuale është e saktë duhej të ngriheshe që me natë e të zije radhë para ambasadës, të prisje në diell apo shi me orë të tëra dhe (në qoftë se ishe fatlum) pasi të paguaje 30 euro të merrje firmën dhe vulën. Prej këtu duhej të paraqiteshe në Ministrinë e Jashtme ku pasi paguaje 15 euro merrje vulën e dytë mbi dokument. Më tej, pasi paguaje përsëri para në shërbim të zakonshëm apo urgjent, pas disa ditësh merrje dokumentin e përkthyer në greqisht, dokument që tashmë ishte i pranueshëm në bashki. Këtu maratona ndërpritej përkohësisht për të ndjekur një degëzim tjetër të saj, degëzimin e “lejes së punës”. Edhe këtu shumë dokumente midis të cilëve kryesori ishte kontrata e punës dhe ditët e sigurimeve shoqërore e libri i shëndetit. Këtu takoheshe me absurdin më të madh të ligjit. Që të merrje leje pune duhej të kishe një punë, një kontratë pune, 150 ditë siguracione. Fëmijë që kishin mbaruar gjimnazin apo liceun dhe donin të futeshin në punë nuk mund të merrnin leje pune sepse “nuk kishin qenë në punë”. Gratë që gjenin një punë me siguracione nuk mund të hynin në punë sepse nuk kishin “leje pune”...


Absurd në fuqi infinit.

Pasi kishe marrë lejen e punës, me dokumentet të gjitha në dy kopje, paraqiteshe në rrugën Sofokleus (tani në Psaron) dhe pasi arrije më në fund të gjeje një vend në radhën e pambarim merrje një vërtetim. Me atë vërtetim në xhep nuk dëbohesh, por as nuk mund të ikësh në vendin tënd për të mirë apo për të keq. Ai vërtetim hyri në fjalorin e emigrantëve si vërtetim i “të burgosurit pa faj”. Ai të jepte dhe të jep të drejtën që për festa të caktuara fetare greke mund të udhëtosh në kohë rigorozisht të kufizuar drejt vendit tënd.

→

cyan magenta yelloë black

Abdurahim Ashiku



NJERËZ QË I DUA - 5

Tregime të jetuara

Vërtetimin e parë e mora më 10 qershor të vitit 2002, plot 20 ditë para se të më mbaronte leja e shtyrë e qëndrimit. Prita një vit të tërë të marr lejen e qëndrimit dhe nuk e mora. Shkoja dhe vija në vendin tim kur na jepnin leje.

Kur mbaroi afati i bëra përsëri dokumentet nga e para, duke përfshirë lejen e punës dhe mora vërtetimin. I imi mban datën 8 shtator 2003 kurse i gruas për bashkim familjar 11 shtator 2003. Edhe këtë herë si radhën e parë na u tha që për 2-3 muaj do të marrim kartën jeshile.

Kur nuk kishim ndonjë problem të ngutshëm familjar nuk e çanim kokën të shkojmë në radhë për të pyetur në se ka dalë apo jo leja e qëndrimit. Mua, një nevojë e ngutshme familjare më detyroi të trokasë disa herë në veshë të mbushur me pambuk. Shkova disa herë në bashki, atje ku kisha dorëzuar dokumentet dhe në të gjitha herët kompjuteri i tyre jepte shenjë heshtjeje. Shkova në periferi. Arrita me mundime të ngjitem në katin e 7-të dhe të takohem me përgjegjësen. Më dëgjoi, më mori fotokopjet e vërtetimeve dhe më tha se do të më telefonojnë. Shkova në tetor 2003. Shkova në nëntor 2003. Shkova në dhjetor 2003...Në shkurt 2004 e ngrita zërin fort. E ngriti edhe zonja. Më tha se dokumentet tuaja nuk kanë ardhë në prefekturë. Shkova i inatosur në Sofokleus ku kisha dorëzuar dokumentet dhe mësova se dokumentet e mija, që i kisha dorëzuar më 8 shtator kishin ikur nga bashkia më 12 dhjetor 2003 kurse të gruas e të djalit që ishin dorëzuar më 11 shtator 2003 kishin ikur më 21 nëntor 2003. Me dokumentin në dorë shkova e zura radhë përsëri para zyrës në katin e 7-të. Një punonjës, që priste të takohej me përgjegjësen e tij, para derës, mbasi sheh numrat e dokumenteve të mija më thotë "Këto dokumente akoma nuk i kemi futur në kompjuter". Ishte fundi i shkurtit 2004. Unë dhe gruaja nuk i morëm edhe lejet e dyta të qëndrimit. Djali e mori pasi kishte skaduar...

Maratona e tretë filloi më 9 korrik 2004. I dorëzova, pas maratonës së njohur një për një të gjitha dokumentet e mija dhe të gruas për bashkim familjar, shoqëruar edhe me 600 euro për dy vjet leje qëndrimi. Në gusht shkova në Shqipëri nga "lirimi me kusht" që na u bë. Po ashtu edhe për Vitin e Ri. Më 15 janar 2005 u mbyllën përsëri kufijtë për hyrje e dalje. Para një muaji, një nevojë e ngutshme familjare kërkonte që unë dhe gruaja të shkonim në Shqipëri. Kishin kaluar 10 muaj. Trokita në dyert e bashkisë dhe mësova se dokumentet e mija kishin ikur prej zyrave të saj pas 166 ditësh (!). Në pamundësi që të futesha në zyrat e prefekturës për arsye të radhës së gjatë që kishte zanafillë dymujore, zura një avokat i cili u fut tak e fak dhe më solli lajmin se dokumentet akoma nuk ishin futur në kompjuter. Dokumentet pasi kishin ndejë më se pesë muaj në bashki pa u nisur ishin në vijim të pesëmuajshit të dytë tashmë pa u regjistruar. Pagova përsëri avokatin dhe pas tre javë kërkimesh ishin gjetur të dy dosjet, ishin regjistruar në kompjuter dhe ishte shtypur pulla e lejes së qëndrimit afati i së cilës mbaronte pas 4 muajsh. Shkova në bashki në ditën që më thanë dhe në pasaportën time dhe të gruas vendosën "pullën e lirisë"...

Atë ditë, qeveria greke miratonte projektligjin e ri për emigracionin.

Atë ditë, një njoftim ministerial njoftonte se të huajt mund të udhëtojnë në vendin e tyre nga 15 prilli deri më 15 maj me vërtetimin që kanë dorëzuar dokumentet dhe lejen e punës...

Atë ditë, një qeveritar i lartë grek, jepte "sihariqin" se brenda muajit maj të gjithë ata që kanë aplikuar për leje qëndrimi dyvjeçare do të marrin "pullën e lirisë".

Unë e dëgjova dhe tunda kokën mendueshëm. Nervat e mija janë në rezonancë. I ruajt Zoti nga këputja.

Po Ju si unë mendoni? Nuk kam dyshim. Kjo nuk është një histori imja, është histori e të gjithëve.

(Marrë nga libri "Rrëfimet e komshiut", Botimet M&B, Tiranë 2011)

NOSTALGJI PËR KOHË E NJERËZ

Një letër që më solli mall dhe se mbaj dot

Më vijnë shumë letra valëve të internetit, letra që më sjellin shëndet e gëzim, letra që ma ndezin mallin e dua të vrapoj ta shuaj burimesh e lëndinash të vendit tim, Dibrës që e dua.

Kësaj radhe më erdhi një letër nga shoku im, nga miku im, nga Luan Kaba me të cilin na ka lidhur, midis të tjerash e mbi të tjerat, profesioni; ai telekronist i Radio-Televizionit Shqiptar dhe unë gazetar i Agjencisë Telegrafike Shqiptare. Vite të shkuara, viteve shtatëdhjetë. Mundohem të kujtoj rrugëtimet në këmbë me Luanin në kërkim të njerëzve të punës, "njerëz mbi male" siç i kam pas vënë titullin një reportazhi.

Një fotografi (që po e përcjell, foto ku është edhe Fredi, redaktor i RTSH) më ngacmon kujtime në ngjitjen maleve të jashtëzakonshme për nga bukuria dhe begatia, maleve të Kalasë së Dodës, udhëtimit nëpër Radomirë, luginës që merr kryevend tek "Shpellasi" ku thonë se uji ka marrë ngjyrë kur në bjeshkën e Ponairit hodhën bojë për të parë ku humbet e ku del uji për ta prerë "berrin e varur në çengel" për kurrizi, Shqipërinë, njëqind vjet të shkuara. Më kujton liqenin e Preshit e pak më sipër burimin ku kam mbushur grushtet njëri pas tjetrit për të shuar etjen e ngjitjes në këmbë. Më kujton Sorokolin e pamjen që zbret në njërin krah nga Përroi i Lushe e nga krahu tjetër në Fushën e Korabit. E tej e tej në veri, bjeshkë pas bjeshke, "Kthesën e Koke" ku misionaret e Evropës u detyruar para pushkëve të rrotullohen rreth vetes në detyrimin "Të lënë kokën apo tu lënë tokën shekullore fisit trim të Kokeve".

Eh more Luan Kaba, djali i mikut tim të viteve të rinisë, mjeshtrit të bujqësisë dibrane, Sabri Kabës, kujtimet e të cilit më vijnë e më zënë supin e pesë viteve kur ishim bashkëmësues në shkollën e mesme bujqësore "Nazmi Rushiti".

Nuk mund të lë anash një rrjedhë gjaku gjenetik. Fëmijët e Luanit kanë gjak nga kushëriri i parë i babait tim, Azem Poçi, njeriu që nuk ia gjeje shokun në vend për punëtor e zemër flori.

Faleminderit Luan Kaba. Letrën tënde plot ndjenjë e dashuri nuk mund ta mbyll "zarfeve kompjuterikë. Po e përcjell me mall për të shuan paksa mallin e një ikanaku larg e larg vendlindjes, Dibrës tonë.

Shënim: Po të përcjell edhe një fotografi, të tre, midis teje e Sami Bulkut, diku në një lokal të vogël në pritje të kafes...



I RILINDUR BASHKË ME "RILINDËSIT E KOHËS SONË"

Nga Luan Kaba

Përshëndetje Abdurahim Ashiku!

Lexova librin tënd të fundit "Rrëfimet e komshiut".

Edhe pse me këmbët e mia nuk kam shkelur rrugëve të karvanëve të mërgimtarëve, ikanakët, siç i quan, me kokën pas Fushës së Korabit (O e mjera unë...), a Lëndinës së Lotëve, nga përshkrimet me aq ndjenjë, bëre që të më dukej vetja se po përplasem dallgëve të Adriatikut bashkë me Eduardin e të përlotem për djalin e tij dyvjeçar që e përpiu deti i trazuar i 28 marsit 1997.

Bëre të ndjehem se po dridhem nga acari në kapërcim të maleve të Gramozit, Konicës e Pindit bashkë me komshiun tënd e me të burgosurin në "Ahuret e Avgjisë", të më dukej se po sfilitem sporteleve të burokratëve komunar, zyrave të O.A.E.DH-it për një "Kartë kazerme" bashkë me atë "Vorioepirotin nga Luma".

Me rrëfimet më çove e më gëzove atje ku "Gjaku nuk bëhet ujë", mes arvanitasve të Thivas, në Kaskavelin e autorit të "Gjuhës së Perëndive" Aristidh Kolën e madh, më prezantove me Kiço Bllanin shokun e vjetër të klasës në shkollën e mesme...

Vërtet më bëre të trishtohem për rininë e humbur të Valbonës, të ligështohem për fatin e "Gjeneralit akull" por edhe për atë zogun shtegtar tek tavolina 15.

Më bëre të përbuz edhe afendikonjtë nursëzë, avokatët e ftohtë gjakpirës, ikonat mashtruese por më bëre edhe më shumë të ngazëllehem me mjekun Panajotis, gazetaren Magda, pronarin Spiro që Shpëtimin nuk e thërrisnin Jorgo por me emrin e nënës-Shpëtim.

Siç me ndjenjë, rrokshëm e përshkruan, edhe unë do të desha të isha dëshmitar në "Gjyqin e Shqipes" e të përshëndesja me gjithë zemër mësueset Stela e Denada.

Por do të desha të shihja edhe kur i përmalluar takohesh me Gurjonin, mjaltin e mjaltit. Pse jo edhe të filmoja me kamerën time, si gati 30 vjet më parë në Sorokol, liqenet e Lurës a Kacnisë. Është një galeri e vërtetë personazhesh realë, që frymojnë, mbijetojnë, gjallojnë por edhe lulëzojnë në atë klimë. Me një gjuhë të thjeshtë, origjinale, të pastër, me emrat e vet, ata i ke përjetësuar në histori, në një nga faqetë e trishtueshme të saj, në ata të tranzicionit alla shqiptar, që na bën të ndjehemi ngushtësisht keq.

I nderuar Abdurahim Ashiku!

Me a pa dëshirë, me a pa sakrifica, me apo pa peng të lënë pas, kapërceve mes "Gurëve që lëvizin"...dhe vërtet të shoh të rilindur, bashkë me "Rilindësit e kohës sonë".

Edhe njëherë dua shumë të të uroj shëndet e jetë, për të vazhduar "qilizmën", se me siguri ke edhe të tjera, e të tjera për të na thënë.

Urime nga Luan Kaba

** ish telekronist, drejtor i Arkivit të Shtetit-Peshkopi*

Rruga e Arbërit nr. 159

Në lexim libri të duket si një punë e thjeshtë, e sistemuar dhe kaq, por, për ata që merren me gjenezën është një punë e vështirë dhe kërkon përkushtim dhe vëmendje ndaj çdo vlere dhe të çdo pjesëtari të tij.

monografi

Fis shekullor me kontribut për çështjen kombëtare

Nga Prof. Asoc. Dr. **BERNARD ZOTAJ**

Libri i Sakip Camit "Fis i martirizuar", me figura historike njerëzore të një fisi, me episode të shkëputura, me një vijë lidhëse të epokave fisnore të ndodhura në disa breza me radhë, më shtynë që të shkruaj disa mendime dhe të bëj vlerësime për këtë dukuri të re, të shtuar në kohën e demokracisë në çdo cep të Shqipërisë.

Historia luftarake atdhetare e Dibrës shtrihet thellë ndër shekuj. Për të, sidomos në shek. XX, është folur e shkruar shumë. Të dhënat e para të dokumentuara vijnë që me fillimet e pushtimit osman. Në luginat, grykat e honet e Dibrës e posaçërisht të fshatrave të saj, sikurse venë në dukje disa studiues, nën udhëheqjen e Skënderbeut, në vitet 1444-1468 ushtritë turke pësuan humbjet e para në trojet shqiptare e kundër shqiptarëve. Më pas të njohura janë kryengritjet antiosmane në 1492, 1700-1705, 1715 e 1729, të viteve 1825-1830, si dhe të kontributit dhe të ndihmesë luftarake të dhënë në kuadrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si dhe në Shpalljen e Pavarësisë. Roli i Dibrës ishte i dukshëm në përballimin e sulmeve të serbëve në vitet 1912-1914. Çdo fshat krijoi çetën e vet për luftime kundër serbëve. Luftimet kundër serbëve në Topojan të çetës së Fetah Camit. Pasqyrim gjejnë masakrat serbe në Dibër, 1913 deri tek ndarja e vitit 1913 – 1948 me farefisin në Dibër të Madhe.

Përparësi zënë beteja kundër Hajredin Pashës në Fushën e Gjoricës, kuvendi i Dibrës, kulla e Camit, kulla e Dibrës, si dhe përhapjen e arsimit shqip në Dibër dhe kundërshtimi për të mos paguar taksat turkut, plagosja e Shaban Camit. Luftëtarët e Camëve bllokuan forcat serbe dhe nuk i lanë të kalonin luginën e Drinit të Zi. Ky ishte një sukses i rëndësishëm për vullnetarët shqiptarë, të komanduar nga antiesatisti i vendosur Fetah Cami.


Atdhetarizmi i dibranëve shënoi majat më të larta gjatë Luftës së Dytë Botërore. Krahina u kthye në një nga bazat më të fuqishme dhe më të hershme të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare në shkallë vendi. Trimnia e pashoqe e gjithë partizanëve ...por mbi të gjitha vihet në dukje heroizmi i Ahmet Camit, i cili i paska sulmue tradhtarët dhe qenka kacafytë me tërbim e urrejtje. Ukë Dan Cami dhe Sinan Cami internohen në Berat nga fashistët italianë, mjaft pjesëtarë të fisit Cami të vdekur për shkak të torturave në burg. Me tej pasqyrohen kryetarë të Këshillave Nacionalçlirimtare, rrëzimi i aeroplanit italian mbi Gjoricë, Prill 1941, vrasja e mësuesit Fasli Cami, si dhe roli i grave, fëmijëve dhe të moshuarit në arrati, etj.

Gjerësisht trajtohet brezi i katërt kundër fashistëve dhe nazistëve, duke filluar me internimet, burgosjet, atentatet dhe vrasjet nga fisi Cami. Lidhje e fistit Cami me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, bëri që shumë nga fisi të rreshtohen partizanë në Br. XVIII S. Përshkruhet Fasli Fetah Cami, mësuesi i parë dhe dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Në faqet e librit zë vend të dukshëm edhe Hidër Rrahman Cami, kryetari i Këshillit Nacionalçlirimtar që vdiq në burgun komunist.

Fisi që shtrihet në Gjoricë, Viçisht, Golevisht, Sepetovë dhe në Dibër të Madhe, pjesë e Dibrës, ka përcjellë në breza trimëri dhe dashuri për jetën dhe njerëzit. Këto vende gjithmonë janë dalluar dhe shquar për urtësi dhe dashuri vëllazërore e fisnore. Zakonet dhe traditat e pasura të trashëguara në breza kanë ardhur deri në ditët tona, të cilat tregojnë për jetesë dhe kulturë të vijueshme në breza. Shfletimi i faqeve të këtij libri për mua ishte një ndjenjë e labit për të njohur dhe lidhur kontakte me figura të panjohura të një fisi, por, në anën verilindore të vendit, të Dibrës, të njohur dhe të dalluar në shekuj për luftëra e përpjekje për jetesë dhe mbijetesë, duke pasur në prag të derës hasmin shekullor, që kërkonte ta gllabëronte.

Libri na përshkruan thjeshtë dhe me ndjenjë vuajtjet dhe sakrificat e kohëve që fisi përballoi, duke i dhuruar mbijetese fisnore sakrifica lufte bashkë me jetën, me pasurinë e tyre, veçanërisht me dibranët dhe familja Cami në Viçisht, nuk ka se si rrjedha historike familjare të bëhet një ndjenjë mallëngjimi dhe krenarie e ligjshme, që e meriton të nderohet e respektohet me ndershmëri njerëzore. Në këtë panoramë familjare vjen rrëfimi për njerëz të thjeshtë, për luftëtar, për dëshmor, për mësues, por punëtor dhe të ndershëm për të jetuar dhe krijuar familje me moral dhe të përkushtuara për fisin. Për më shumë se shumë vite Sakipi ka gërmuar dhe është marrët me gjenezën Cami, ku në të ka përfshirë burrat dhe gratë, fëmijë, nipër dhe mbesa të çdo familje, është një punë guximtare, e lodhshme, por ja vlen që të njihet dhe të vlerësohet. Marrja përsipër e një nisme të tillë kërkon guxim, pjekuri dhe përkushtim, për të nxjerrë në dritë njerëz dhe figura që pluhuri i historisë shekullore të fshihej dhe ti sillte përsëri në jetë.

Në shoqërinë shqiptare të së kaluarës, veçanërisht në atë të fshatarësisë, të cilës i përkiste edhe familja e fisi Cami, familja ka qenë e mbetet bërthama më e qenësishme dhe më e fuqishme e shoqërisë ndër shekuj. Madje mbartëse dhe trasmetuese, nga



FISI CAMI I DIBRËS
SAKIP CAMI
Monografi
Botimet M&B
ISBN 978-9928-256-90-4
Çmimi: 1000 lekë

Librin mund ta gjeni te Botime M&B, Rr. "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9. Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441 (WhatsApp). E-mail: mbbotime@gmail.com Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion, #Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së librit në Tiranë.

brezi në brez, e vlerave e virtyteve më të mira të të parëve. Një vend të veçantë zënë dhe figurat e shquara patriotike të fisit Cami si Zenel Ahmet Cami, Eqerem Zenel Cami, Mane Ibrahim Cami, Haxhi Shem Cami, Dan Shem Cami, Shahin Demir Cami, Hamit Ibrahim Cami, Hazis Hamit Cami etj. Trajtohen në libër edhe figura të tjera të fisit Cami si Moisi Ahmet Cami, Mësues i Merituar, Tefta Ahmet Cami (Cani), ministre e Arsimit dhe Kulturës, Dr. Shpëtim Cami, profesori i praktikës dhe teorisë politike, Edvin Lulëzim Cami, poligloti që njeh dhe përkthen në 13 gjuhë të botës,Aurel Cami, PhD, dhe Ferdinad Cami, shqiptari i parë zëvendëspresident i superkompanisë, L-Discovery, Chicago-Illinoi.

Në kuptimin e ngushtë të fjalës familja, është një grup i vogël social, që përfshin marrëdhëniet midis burrit dhe gruas të lindura nga martesa; marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve të lindur ose të birësuar dhe midis të afërmve të tjerë me origjinë të përbashkët gjaku e jetese. Si dukuri shoqërore, familja përfshin: marrëdhënie të ndërlikuara e komplekse shpirtërore, psikologjike (ndjenja dashurie, të simpatisë, të pëlqimit etj.); marrëdhënie morale (të nderit e të dinjitetit, të besnikërisë e të ndjenjës së detyrës ndaj njëri-tjetrit e ndaj shoqërisë) si dhe procese materiale që lidhen me sigurimin material të familjes, me riprodhimin e brezave të ardhshëm etj.

Në kuptimin e gjerë të familjes, pjesë e saj janë edhe anëtarët e fisit. Fillimisht me fis, në shoqërinë e hershme shqiptare, kuptohej një grup njerëzish të shoqërisë primitive me lidhje të afërta gjaku, me gjuhë e zakone të njëjta. Më vonë, me zhvillimin e zgjerimin e shoqërisë njerëzore, në kuptimin popullor dhe etnografik, me fis kuptohej një grup njerëzish të afërt që rridhnin nga një baba i përbashkët e i hershëm në linjë gjaku dhe qumështi.

Vend të dukshëm zë dhe gruaja në familje, por dhe në shoqëri. Gra të shquara të fisit Cami përfaqësohen nga Nënë Pema (Peme Rexha) (Cami), Bejaze Duka (Cami), Bejaze Kamberi (Cami) Shyrete Cami (Sharku), Burrëresha Ramije Cami (Skuka), veterane e LANÇ-it, Tefta Ahmet Cami (Cani) dhe shumë të tjera.

Këto vlerësime e këndvështrime janë mbajtur në vëmendje në gjithë rrjedhën e shtjellimit të librit "Fisi i martirizuar". Këto i kanë shërbyer autorit si udhërrëfyes për mbledhjen e përpunimin e të dhënave që shkojnë disa breza larg, si në linjën mashkullore dhe atë femërore. Largësia e këtyre brezave, në të Drejtën Zakon-

Familja dhe fisi CAMI, në pjesën më të madhe të brezave të mëparshëm që njihen, kanë qenë të lidhur pazgjidhshmërisht me fshatin dhe krahinën e Dibrës. Shkalla e njohjes, të paktën nga brezi i parë, i para mbi tre shekuj që është mundur të gjejë studiuesi Sakip Cami, tregon se janë autoktonë..

ore të Dibrës, është pranuar të jetë 7 në linjën mashkullore dhe 5 në atë femërore apo sikurse quhet ndryshe, në linjën e barkut apo të qumështit, tërësia e fëmijëve që vijnë nga një nënë në lidhjen gjinore femërore, bark pas barku. Kjo bashkësi brezash në fshatrat e Dibrës është quajtur bark apo edhe fis.

Nëpërmjet përshkrimit të figurave historike të një fisi si Cami, pena e Sakip Camit ka sjellë përsëri në memorien e fisit stërgjyshërit Hani i Ibrahimit me djem Hidri, Hasani dhe Islami, Cami dhe Koleci, Ahmet Cami, Zenel Cami, Mahmud, Shemë e Mustafë Cami, Feta e Shaban Cami, Rrem e Shahin Cami dhe shumë të tjerë familjarë në vite e dekada.

Vlerat që ka mundur Sakip Cami të qëmtoj, të përgjithësoj dhe të pasuroj në libër të çdo pjesëtari të fisit të Cami do t'i zbukurojnë e pasurojnë shpirtin, për sot e për nesër, çdo pjesëtari të këtij fisi me emër në çështjen kombëtare. Unë shpreh siguri se me leximin e këtij libri fisi Cami do ndjehet krenar për të parët, por edhe do të rritur besimin e përkushtimin për të nesërmen e çdo njërit prej tyre. Pa diskutim dhe dashurinë e respektin për njeri tjetrin brenda familjes e fisit. Kushtet e integrimit, të globalizmit e të lirisë së lëvizjes që po përjetojnë brezat e sotëm me ndryshimet marramendëse të botës që na rrethon, nxjerrin më në pah nevojën e vlerave dhe kthimin e vështrimit prapa. Kjo si parakusht për të kujtuar e ruajtur lidhjet e gjakut, të qumështit dhe të barkut e këtej edhe për të jetuar me nder e dinjitet të tashmen e për të ecur më të sigurt përpara në të ardhmen në përballimin e sfidave të padiskutueshme të kohës. Sfidat nuk janë gjë e re. Me to, sikurse tregon edhe përvoja jetësore e brezave të hershëm të familjes e fisit Cami, janë përballur, përballen e do të përballen në çdo brez. Me ndërgjegje në këtë libër theksoj se është një Homazh për gjyshërit, prindërit, të gjithë të përkushtuarit për çështjen kombëtare të këtij fisi të madh.

Njerëzimi, duke përballuar sfidat e kohës, ka krijuar një traditë të tërë, për rreth 80.000 vitesh. Kjo traditë përfaqëson shumatoren e rrugëtimit e të mënçurisë njerëzore, pa të cilën bota nuk do të kishte këtë zhvillim që ka sot. Asgjë, as në shkencë e dije, sado mendje të ndritura, nuk ka filluar e nuk fillon nga hiçi. Në këtë shumatore e si pjesë modeste, por me vlerë të saj në këtë cep shkëmbor të Ballkanit Perëndimor, gjykoj se hyn edhe kontributi i mbarë popullit shqiptar sikurse edhe i familjes e Fisit Cami. Gjithsesi sërish theksoj se ky botim do të mbetet faqe e hapur për tu plotësuar.

Në lexim libri të duket si një punë e thjeshtë, e sistemuar dhe kaq, por, për ata që merren me gjenezën është një punë e vështirë dhe kërkon përkushtim dhe vëmendje ndaj çdo vlere dhe të çdo pjesëtari të tij. Libra të tillë kanë vështirësi dhe sjellin gjithmonë edhe mendime dhe kundërshti, për mënyrën e ndërtimit dhe të kompozimit të tyre.

Libri është i një llojit të veçantë, i ndërtuar ndryshe dhe i strukturuar thjeshtë, ku vjen gjeneza e fisit, ku përfshihen njerëzit që nga vitet e lindjes të stërgjyshërve, deri te filizat e rinj. Veç sidomos angazhimi i secilit, qoftë edhe të shkruaj shkurtimisht për familjen e tij të ngushtë dhe për vete, është e mbetet detyrim i respektuar dhe zgjidhje gjithnjë e më tepër shteruese. Ne, paraardhësit apo brezi më i vjetër, kemi detyrim moral ndaj pasardhësve tu lëmë të shkruar të kaluarën e familjes e fisit apo edhe atë vetiake.

Familja dhe fisi CAMI, në pjesën më të madhe të brezave të mëparshëm që njihen, kanë qenë të lidhur pazgjidhshmërisht me fshatin dhe krahinën e Dibrës. Shkalla e njohjes, të paktën nga brezi i Parë, i para mbi tre shekuj që është mundur të gjejë studiuesi Sakip Cami, tregon se janë autoktonë, jo të ardhur nga ndonjë vend apo krahinë tjetër. Në të kundërt, degëzime të veçanta të brezave të mëpasëm, për shkaqe të ndryshme e të panjohura plotësisht prej tij, por që faktohen apo mund të hamendësohen, janë larguar nga vendlindja e të parëve për në krahina të tjera të Shqipërisë. Kjo dukuri u bë sunduese, ndërkaq edhe tepër e njohur, në 60-70 vitet e fundit të shek. XX. Këto krijuan ngulmime të reja masive nëpër Shqipëri. Madje edhe jashtë shtetit, thuajse në të gjitha kontinentet.

Në leximin e kësaj biografie familjare, kuptojmë dhe vështirësinë që ka pasur dhe hasur Sakip Cami në shkrimin dhe pasqyrimin e saj, në këtë panoramë, që shërben si një rast i llojit të veçantë. Me guxim ai ja ka dalë. Këtë e gjykon dhe e vlerëson edhe lexuesi më i thjeshtë...

Tiranë, 2019

profil

Në 20-vjetorin e vdekjes

Për një nga të rrallët, por edhe të veçantët njerëz me botë të madhe shpirtërore, shprehur kjo edhe në ditarët e tij

Publicistika dhe prirjet letrare e artistike të Isuf Rashës

Nga Halil RAMA & Sakip CAMI

Në publicistikë, letërsi, art dhe kulturë, pasioni sjell talentin. Këtë e provon më së miri edhe trashëgimia publicistike, letrare dhe artistike e Isuf Rashës. Ndonëse nuk është ndonjë autor i njohur, në labirintet e laboratorit të tij krijues, (të shprehur në formë ditari) gjen dhjetëra artikuj problemorë, poezi, skica etj., (disa të botuar në gazetën lokale "Ushtima e maleve", por shumica të pabotuara) ku reflektohen fakte historike, por edhe shqetësimi për mbarëvajtjen e punëve në ish kooperativën bujqësore të Zall Dardhës së tij të largët.

Ndonëse e donte dhe dashuronte jetën, ai iku për në botën e përtejme para 20 vitesh, duke lënë pas një trashëgimi të pasur dokumentare. Mjaftojnë qoftë dhe dhjetëra ditarët e lënë në dorëshkrim (nëpër blloqe a fletore të asaj kohe), për të kuptuar punën e tij të thelluar studimore, duke përshkruar gjer në detaje fakte e ngjarje historike të zonës së Zall Dardhës me histori të lavdishme, për toponiminë, për Simpoziumin e organizuar në Zall Dardhë nga zona e Reçit dhe Dardhës me rastin e 75 vjetorit të pavarësisë etj.

Nëse dëshiron të njohësh një njeri lexo ditarin e tij që ka lënë. Nëse dëshiron të njohësh një periudhë kohore historike lexo ditarët dhe shtypin e kohës. Nëse ke mbajtur ditar tregon se je njeri i rregullt, i vëmendshëm, parashikues, optimist, krahasues, dhe vizionar.

Një nga të rrallët, por edhe të veçantët njerëz me botë të madhe shpirtërore është Isuf Rasha. Këtë e thonë ditarët e tij, që fatmirësisht bashkëshortja Hyrie dhe gjashtë djemtë e tij i kanë ruajtur si sytë e ballit. Janë ditarë shumë të thjeshtë, të vegjël, blloqe të vegjël, me një shkrim të imët, por me kaligrafi, që flasin shumë.

Për vlerat e rralla dhe profilin krijues të I.Rashës flasin bashkohës të tij, personalitete të mirënjohura si Prof.dr.Petrit Bara, Dine Kaca, Ismet Avdia, Xhelil Cibaku, Isuf Xhediku, Muharrem Gjoka, Shuaip Methasani, Shaqir Çerpja, Nazmi Shira, av.Hasan Bara, etj.




STUDIUES BASHKËKOHOR

Intelektuali erudit I.Rasha, pa iu larguar profesionit të llogaritarit (si një nga kontabilistët më të njohur të kohës që jetoi, sa që kur viheshin në vështirësi autoritete të rrethit e angazhonin në nxjerrje bilancesh të ekonomive kryesore), angazhohet në studime serioze, në funksion të rritjes së vlerës së ditës së punës. Të tilla janë studimet për rritjen e efektivitetit nëpërmjet projekteve të sistemit të tokave, drenazhimeve, tarracave etj., - procese këto për të cilat sipas një vendimi të qeverisë së asaj kohe, financoheshin nga shteti.

Studime të tilla si dhe ai për rritjen e rrezes dëshmojnë publicistikën e tij) reflektohet bota shpirtërore e një intelektuali të mirëfilltë që në çdo aspekt të imponon qasje të reja, metoda efektive në funksion të zgjidhjeve të problemeve, të ndërtimit dhe përkufizimit të koncepteve për strategji zhvillimore, planifikim strategjik, menaxhim efektiv të projekteve, gjithnjë në koherencë me realitetin objektiv.

Pikërisht kryellogaritari i një ekonomie bujqësore provinciale, që jo vetëm i kishte të koleksionuara, por edhe të mirëstudiuara revistat "Shkenca dhe jeta" dhe "Bujqësia", do të ishte udhërrëfyes në aplikimin e metodologjisë së punës shkencore, duke mundësuar një ambientim të ri në studime, një cytje drejt përvetësimit të njohurive bashkëkohore dhe aplikimit të tyre në praktikën e përditshme, në sektorë të tillë, si pemëtaria, blegtoria, bletëritja (gjuetia, parashikimi i motit e infermieria) apo deri dhe te projektimi e ndërtimi i rrugëve të ndërmjetme mes fshatrave të Dardhës.

Me fjalë të tjera, I.Rasha ishte intelektuali bashkëkohor, i cili edhe në kushtet e rrethanat e izolimit total, në një ekonomi provinciale, hartonte dhe zbatonte projekte që konsistonin në doza optimale të materialeve teorike, për t'i dhënë rëndësi punës praktike, nga e cila krijonte bazamente të qëndrueshme për vepra po të qëndrueshme, disa prej të cilave i hasim edhe sot pas më shumë se tri dekadash, si blloku i pemëve (sipër shtëpisë së tij), apo dhe ndonjë rrugë ndërlidhëse fshatrash….



së bukës, të botuara në shtypin e kohës kanë patur jehonën e duhur, jo vetëm në qarqet intelektuale të Dardhës, Reçit, Çidhnës e Lurës, por pothuajse në gjithë rrethin e Dibrës.

Në këto studime (të botuara dhe të pabotuara) si edhe në kronikat, skicat apo esetë (që

POEZIA…..

Jo më në Zall Dardhën e largët, por ndoshta edhe këtu në Tiranë, metropolin shqiptar, rrallë mund të gjesh një bibliotekë aq të pasur si ajo që i la trashëgim familjes së tij Isuf Rasha.

Isuf Rasha ishte intelektuali bashkëkohor, i cili edhe në kushtet e rrethanat e izolimit total, në një ekonomi provinciale, hartonte dhe zbatonte projekte që konsistonin në doza optimale të materialeve teorike, për t'i dhënë rëndësi punës praktike, nga e cila krijonte bazamente të qëndrueshme për vepra po të qëndrueshme, disa prej të cilave i hasim edhe sot pas më shumë se tri dekadash, si blloku i pemëve (sipër shtëpisë së tij), apo dhe ndonjë rrugë ndërlidhëse fshatrash….

Pikërisht, intelektuali bashkëkohor që kishte lexuar (e madje konspektuar), Tolstoin, Shekspirin, Dostojevskin, Uilliam Folkner, Çarls Dikens etj., dalëngadalë, nëpërmjet leximeve, përjetimeve e asosacioneve, do të formonte profilin e tij letrar.

Dhe jo vetëm kaq. Nuk është rastësi që në arkivën e tij personale gjejmë koleksionin e të gjitha numrave të revistës "NËNTORI", si dhe shumicën e nr. të gazetës "DRITA", nga ku ai, jo vetëm lexonte letërsinë e kritikën letrare bashkëkohore, por edhe mësonte rreth stilistikës të të shkruarit letërsi.

Ndonëse krijimtarinë e tij nuk e publikoi, nuk është rastësi që atë e ruajti me fanatizëm në "sepetet" e familjes, me bindjen se një ditë ajo do të "zbulohej", e madje do të gjente dritën e botimit.

Brenda "arsenalit" të tij krijues, mjafton qoftë edhe poezia (e lënë në dorëshkrim "RREBESHET E SHKUARA MË NUK KTHEHEN", për të konkluduar në peshën e fjalës, gjuhën e pasur e mjetet shprehëse brilante të një poeti të talentuar. Ligjërimin e tij poetik e gjejmë të sintetizuar qoftë edhe në vargjet: "Dikur në këto brigje qe zënë dielli/Errësira kishte bllokuar edhe qiellin/ Errësira, skamja, padituria/ U duk sikur në këto male kanë zënë rrënjë…"

Qoftë edhe vetëm në këto vargje tingëllon e bukur fjala poetike e Isuf Rashës. Më tej në vargjet: "Ngado që ngjitem në maja të larta/ Ngado që shkel buzë kufirit/ Zemra më gufon me afshin e pastër/ Rrofsh në jetë të jetëve O Shqipëri!…", duket sikur shkelim në sinorët poetikë të Isuf Rashës që janë më të bukura se rudinat e Korabit. Na sjell kështu ai një shpirt të madh poetik, gati parajsor që të magjeps….

VEPRA E QENËSISHME E PIKTORIT AUTODIDAKT

Një shpirt poetik i derdhur edhe në telajo…. Një pikturë mbresëlënëse e një piktori autodidakt, që ndonëse e diktuar nga ideologjia sunduese e regjimit në të cilin ai punoi, i ka rezistuar kohës.

Dhe për vetë faktin se shumica e punimeve të Isuf Rashës janë të skalitura në xham, gjithkush do të mendonte se ai ishte piktor i një stili të veçantë. Kështu, duke pikturuar në xham portrete e peizazhe të natyrës ai krijoi individualitetin e tij krijues edhe në gjininë e pikturës.

Dhe ndonëse për të pikturuar peizazhe apo portrete të çfarëdolloj, ndjehej disi i pavarur, kishte dhe raste kur survejohej, e në këto rrethana venitej disi shpirti i tij krijues. Madje, kur donte të hidhte në një pikturë në xham portretin e ish dikatorit komunist E.Hoxha, (jo se e donte shpirtërisht, por për të shpëtuar nga intrigat që i thurnin ziliqarët e kohës skëterrë) këtë nuk mund ta bënte kurrsesi pa lejen e Komitetit të PPSH të rrethit(!)

Ndoshta edhe rrethanat ia "diktuan" Isuf Rashës ushtrimin e talentit të tij në pikturë. Se pikërisht në një periudhë kohore, kur qe ndëshkuar padrejtësisht nga kupola me masën e përjashtimit nga administrata e ish kooperativës bujqësore, për të mbajtur familjen do të "prodhonte" dhjetëra piktura në xham, të cilat do t'ua shiste bashkëfshatarëve, që aq shumë i kërkonin për të zbukuruar me to shtëpitë e tyre.

Ndodhte kështu, pasi në peizazhet e portretet e pikturuara nga I.Rasha dominonte filozofia humaniste që nënkuptonte marrëdhënien e tij shpirtërore me njeriun, me njerëzimin, me natyrën, me botën që na rrethon. Pikërisht në ato rrethana spikat një perceptim i ri i këtij piktori autodidakt, kur ky talent i veçantë arrin të vetëpërcaktohet dhe të kultivojë dhuntitë e tij, me të cilat mund të mbizotëronte fatin e paracaktuar dhe të dominonte natyrën duke e modifikuar.

Dhe vërtetë, kur shikon punimet e tij artistike, (të ruajtura me fanatizëm nga bashkëshortja, djemtë e vëllai i tij) qoftë në pikturë, qoftë në grafikë, sheh mjaftë peizazhe nga mjedise të origjinës së tij, pra nga Zall Dardha, kjo perlë e natyrës shqiptare. Në këto punime ku dominojnë lulet dhe natyra e qetë, duhet thënë se lidhja e tij me vendlindjen është një lidhje emocionale…është edhe një krenari për historinë e lavdishme të Dardhës dhe bukuritë mahnitëse të natyrës së saj.

"SHKENCA DHE JETA", REVISTA MË E DASHUR E ISUFIT

Isufi lexonte shumë. Ai ishte i abonuar me shtypin e kohës (jo në atë partiak, por në shtypin letrar e shkencor). Lexonte gazetat "Drita", "Zëri i Rinisë", etj. Por revista më e dashur për Isufin ishte revista "Shkenca dhe jeta".

E lexonte me vëmendje këtë revistë sepse tek ajo gjente nga vetja e tij, gjente përvojë, kërkime shkencore. Një herë postieri nuk ja solli revistën në fshat. Isufi u mërzit shumë. Ai e ripagoi postierin që ta blinte revistën në Peshkopi dhe t'ia sillte.

Revistat i mbante koleksion, i shfletonte herë pas here, nxirrte shënime, dhe këto shënime i vinte në praktikë. Shikonte emisione shkencore në televizor, emisione sportive e kulturore. Dëshira e tij e madhe për të zgjeruar horizontin kulturor ishte e jashtëzakonshme.

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh…

Tani nuk është nevoja të prisni…

JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!

Njëlloj si në shtypshkronjë… Çmime të favorshme dhe shpejtësi!

Telefono: **068 65 08 441**

ose shkruaj email:

mbbotime@gmail.com

Rruga e Arbërit nr. 159

Sprovë për të analizuar disa nga esetë e Ismail Kadaresë

sprovë

LEGJENDA E LEGJENDAVE

Nga **XHAFER MARTINI**


"Legjenda e legjendave " u shkrua në vitin 1994, për t'u botuar po atë vit në frëngjisht nga shtëpia botuese e Parisit "Flammarion", si libri përmbyllës I një serie për legjendat e ndryshme të botës. Pas botimit shqip si serial në gazetën "Albania" të Tiranës, për herë të parë u botua si libër nga shtëpia botuese "Dukagjini" e Kosovës. Ky është botimi I parë si libër në Shqipëri". (Botuesi)

Kadareja, ashtu si në të gjitha gjinitë e llojet letrare, shkëlqen edhe në esetë. Esetë lexohen si poezi, në ditë të veçanta dhe me gjendje shpirtërore të veçantë. Lexohen jo thjesht për të mësuar përmbajtjen e asaj që është shkruar, por edhe asaj që nuk është shkruar, por që qëndron mes radhëve ose fshihet prapa tyre. Eseja lexohet për kuptimin dhe nënkuptimim të vështirësuar, por edhe për mënyrën se si është shkruar, për rendin e fjalëve në nivelin më të epër dhe për bashkëlidhjen e tyre në mënyrën më të përsosur. Mbi të gjitha lexohet për zgjedhjen e fjalëve që ato, në tërësi, të komunikojnë flladitshëm e shëndetshëm, me rrjedha ajeri të freskët midis tyre. Eseja nuk shkruhet për t'u marrë vesh, ose nuk shkruhet thjesht për këtë qëllim, për të komunikuar në rrafshin gjuhësor; eseja shkruhet për të menduar, për të abstraguar, madje për një formë të re mendimi, ku raportet e sendeve dhe të gjerave përmbysen dhe ndryshohen, sa të duket se je në një ndërkohë midis ëndërrës dhe zgjimit, të asaj kohe të ndërmjetme që të duhet "për të ardhur në vete", por e domosdoshme për të ndarë dy botë- botën e ëndërrës me realitetin konkret. Është një kohë e veçantë që zgjat aq pak, por është tepër e ngjeshur në krahasim me kohën e zakonshme. Në një sekondë të kësaj kohe, mund të "futim" një shekull të kohës së zakonshme.

Kjo që them unë mund të mos jetë e vërtetë, mund të jetë vetëm një ndiesi, por një ndiesi pa të cilën ne nuk bëjmë, pa të jemi fare të paaftë për të kuptuar esetë.

Eseja e Kadaresë për legjendat fillon me mjegull dhe mbaron me mjegull…Mjegulla është pjesë e legjendës apo legjenda është pjesë e mjegullës? A ka lidhje midis tyre? Këtyre pyetjeve është vështirë t'u përgjigjesh se nuk janë shtruar për përgjigjie. Ne themi që legjendat janë jashtëzakonisht të hershme, ato I përkasin foshnjërisë së njerëzimit. Mos vallë mjegulla nuk është e hershme?! Po janë të sferave të ndryshme: njera e sferës abstrakte, tjera e sferës konkrete. Fenomenet e natyrës kanë lindur para se të lindte mendimi për to. Megjithatë, nuk është ky problemi që na shqetëson. Hershmëria nuk është kusht për ta shpjeguar lidhjen midis tyre. Kadareja të gjithë librat me ese I fillon më mënyrë befasishme. Befasia është një cilësi e këtij shkrimtari. Po befasia e tij është artistike. Ai di masën, kohën e vendin e përdorimit të saj. Një cilësi tjetër e Kadaresë është se ai nuk të thotë kurrë se ku do të dalë. Edhe në qofsh shumë I hollë nga mendja, ai sikur t'I ngatërron gjërat, sikur ikën nga normaliteti dhe del në një zonë ku ndodhet teatri I ngjarjeve, të cilat shkrimtari I shtyn dhe I përplasën me një vrull marramendës; ke ndijimin që çdo episod apo ndodhi, çdo send apo njeri, ndihet ngushtë, dhe pret që të dalë prej andej. Kjo shkakton një angushti dhe një lëvizje të vazhdueshme , diçka si ankth, diçka si mëdyshje, shkurt, një pasiguri. Të mundon ajo pyetja themelore: ku do të dalë autori me gjithë këto? Po pyetja tjetër edhe më e rëndësishme:po pse duhet të dalë diku?Autori tregon. Ti kupto sa të mundesh. Kjo është marrëveshja, kjo është kontrata, tjetër nuk ka dhe nuk duhet të ketë. Kur kupton këtë, ndihesh më I qetë, lexon më normalisht dhe vetëdijësohesh se ke gjetur kohën e përshtatshme.

Aty flitet edhe për probleme të tjera. Po kryesorja është legjenda. Ngjarje nuk ka dhe bën pak ftohtë. Mbase kjo ndodh prej mjegullës që është përherë e ftohtë. Rretherrotull teje ka qetësi, por jo fort larg ndien një rropamë, diçka përplaset dhe valën goditëse e ndjen si thëllimin e ftohtë. Gjithmonë gjërat që nuk ua dimë shkakun dhe nuk I shohim, na bëjnë më shumë përshtypje, na shkaktojnë ankth. Ndihesh disi I alarmuar sikur po vjen cunami dhe, meqë nuk ia di drejtimin, nuk di nga të ikësh për të shpëtuar. Kur e shikon se kush po e shkakton gjëmën, ardhja e saj është e rrufeshme si orteku dhe nuk mund të shmangesh. Çfarëdo që të bësh, je I humbur. Kjo është ndiesi, atmosfera që krijon autori. E arrin vetëm mjeshtëria e të treguarit, me ngatërrime të qëllimshme, me spostime, me ndërrime vendesh që shkakton një lëvizje të



vazhdueshme. Kadraje e kap lexuesin gjithnjë të papërgatitur… Në esetë e Kadaresë befasia nuk është e thjeshtë, ajo ka kurthe mendimi. Duket sikur po tregohet diçka pa mend dhe pa vend, sidomos diçka pa lidhje. Se ç'lidhjeje do të kishte me këtë temë një bisedë fare e shkurtër në fillim të viteve 70, midis dy ambasadorëve, në Paris, në një vend ku ambasadorët, ndryshe nga ç'ndodh tek ne- që I bëjmë zot shtëpie-, konsiderohen thjesht nëpunës, edhe pse mund të përfaqësojnë një shtet të fuqishëm. Me gjithëatë, ambasadori për të cilin do të bëjmë fjalë, ishte I autoritetshëm. Peshën e kishte jo prej vendit që përfaqësonte- Guatemalën- por pse ishte shkrimtar I madh, Asturiasi, I njohur në gjithë botën, I njohur edhe tek ne me librat e bukur "Zoti President", dhe "Uik-end në Guatemalë". Po le të shkojmë tek biseda:

"Asturias:- Shqipëria….kam dëgjuar për vendin tuaj. Desha të di një gjë. A ka shumë mjegull?

Ambasadori: Hë, si të thuash…Mund të them se po. Natyrisht që ka edhe mjegull…

Asturias: Nuk jua bëra kot pyetjen. Në qoftë se ka mjegull, do të thotë se duhet të ketë legjenda". (Kadare: Vepra:Onufri: 2009: 12)

Guatemala është në Amerikën e Jugut, ku nuk ka shtete me zhvillim shumë të madh ekonomik, por kanë një kulturë të lashtë, kanë edhe shumë legjenda.

Dhe Kadareja vazhdon: "Një tjetër pyetje e acartë…është ajo nëse legjendat nuk janë gjë tjetër veçse një histori e degraduar. Është e hidhur kjo hamendje, sepse lidhet me mendimin e mjaft dijetarëve se legjendat janë kryesisht pjellë e popujve që nuk janë të aftë të shkruajnë historinë, shkurt, e popujve të paqytetëruar" (21)

Nga lidhja e legjendave me mjegullën, që ende nuk e kemi shpjeguar, kalohet tek lidhja e tyre me historinë. Këtë e shpjegon vetë Kadare. "Legjendat janë histori të popujve që nuk kanë shkrim, -thotë ai,- një histori e degraduar". Legjendat tek ne nuk janë studiuar. Janë mbledhur dhe janë shoqëruar me ndonjë parathënie për tematikën, problematikën dhe asgjë më shumë. Kanë tërhequr vëmendjen Legjenda e Murimit që lidhet me ndërtimin e Kalasë së Shkodrës dhe Kostandini e Doruntina që bën fjalë për vëllain që ngrihet nga varri, Legjenda e Rinjohjes e ndonjë tjetër. Këto dhjetëvjeçarët e fundit, kur mund të bëheshin studime të mirëfillta, pa korniza dhe ideologjizma, ka lindur një prirje e rrezikshme për t'I luftuar "vjetërsirat". Kjo nuk është një luftë e shpallur, ajo zhvillohet në kuadrin e luftës kundër tabuve- në kulturë e histori,- që, sipas disa studiuesve, bëhen pengesë për të pasqyruar realitetin si për ngjarjet ashtu edhe për heronjtë. Shkohet edhe më tej me çmitizimin dhe me çlegjendarizimin e heronjve e ngjarjve, siç ka ndodhur , fjala vjen, me Skënderbeun. Shumëkujt nuk i pëlqen kur Skënderbeut I thonë hero legjendar, ose hero mitik, dhe duan ta zhveshin atë si nga legjendariteti ashtu edhe nga miticizmi. Miti nuk është larg legjendës në kuptimin e përceptimit historik dhe funksional e filozofik. Prandaj kur flasim për legjendat në një farë mënyre flasim edhe për mitet. Tek ne janë luftuar edhe mitet. Kur lexon një studim për letërsinë nën diktaturë, çuditesh kur mëson që shkaku nga e cila paska vuajtur kjo letërsi paska qenë mitologjia, një mitologji e re. Unë them se çdo kohë ka mitete veta, edhe kohët moderne. Për shembull, sot tek ne ekziston miti I bashkimit kombëtar, I krijimt të Shqipërisë Etnike, miti I të bërit të shqiptarit qytetar I Evropës me të gjitha të drejtat dhe detyrat, miti I ndërtimit të shtetit të së drejtës, miti I ngritjes së nivelit ekonomik, miti I barazisë në ekonomi, por edhe në shakllën e dinjitetit kombëtar, të paktën, me vendet fqinje e të tjera. Unë jam dakord që mitet janë karakteristikë për shoqëritë e prapambetura, por ato janë karakterisitikë edhe për diktaturat, sepse një diktaturë është e prapambetur. Por le të shkojmë tek legjendat. Legjendat janë histori, siç thotë Kadare, por jo një histori e rrëgjuar. Legjendat janë një histori ndryshe, një histori që nuk ka të bëjë me shtete, madje as me kontinete, është një histori planetare që nuk merret me ngjarje të veçanta, por me domethënie epokash, me kthesa dhe dimensione të mëdha që janë në shërbim të të gjitha epokave të njerëzimit, si forma më e përkryer e ndërgjegjes së tyre që ka ardhur "duke u zhvilluar" – sipas nesh dhe sipas historisë- , dhe "duke u degjeneruar", sipas legjendave. Për mua legjendat janë si pelenat për fëmijën, që e ruajnë nga të ftohti, edhe nga të nxehti, që e ndihmojnë atë për t'u mjedisuar dhe aklimatizuar. Legjendat, më duket mua, janë pelenat e popujve, meqë ato kanë qenë mbështjellja e parë e tyre. Duke qenë të tilla, ato nuk kanë si të mos jenë pjesë e historisë së popujve. Por ne e dime se historia ka të bëjë me ngjarje të mëdha, me luftëra dhe përpjekje të mëdha, me humbje dhe fitore e kështu me radhë. Këto jepen përmes datave, fakteve episodeve, dokumenteve, pra, jepen në atë mënyrë që të bëjnë të mendosh për gjithçka tjetër, vetëm për mjegullën jo. Kjo edhe për faktin se mjegulla dhe historia janë krejt të kundërta me njera - tjetrën. Legjenda, meqë operon me mjegullën, si veti të saj ka fshehjen e sendeve, dukurive, ngjarjeve. Historia bën të kundërtën: ndriçon ngjarje, dukuri dhe heronj permes dokumenteve, datave, fakteve etj. Po lidhja midis tyre ekziston: atë që fsheh legjenda, përpiqet ta zbulojë historia. Bashkohen, pra, në objektin. Në të dyja rastet objekt është jeta, por ashtu si e kuptojnë dhe si e japin ato. Kadare I jep përparësi legjendës në pasqyrimin më të mirë të jetës në krahasim me historinë. Këtu nuk ka rëndësi me kë je: me legjendën apo me historinë. Ka rëndësi argumentimi. Po në rastin konkret ka rëndësi se si e shtron pyetjen Kadare. Nuk thonë kot se, nëse do përgjigje të mençura, bëj pyetje të mençura."Me fjalë të tjera, thelbi I një ngjarjeje historike jepet më mirë dhe më thellë prej historianëve me anë të fakteve, datave, emrave, shifrave, arsyetimeve logjike, apo prej legjendës kryeneçe, e cila, duke I bërë lëmsh të gjitha ato, jep një motërzim tjetër, të ndryshuar, të mjegulluar, gati-gati një ëndërr të asaj që ka ndodhur, për të mos thënë një fantazmë të saj." (Kadare: Vepra, 2005: 21) Nga shkrimtari mësojmë se legjendat kanë një pelerinë të vetën, kanë veshjen, "kostumin" e vet. Kjo është mjegulla që, siç e thotë Asturias, është shoqëruese e legjendave. Po mjegulla fsheh. Atëherë si mundet që legjenda që ka një element shumë të rëndësishëm - fshehjen,- të pretendojë për të dhënë ngjarje historike, madje jo vetëm të pretendojë, por ta bëjë këtë shumë mirë? Sekreti qëndron në faktin se elementi fshehjës tek legjendat- mjegulla- ka dyanshmërinë e saj- fshehjen dhe zbulimin. Unë jam nga një vend ku në rininë time të hershme kishte shumë mjegull- lugina e Drinit të Zi. Në qoftë se të gjithë gjërat e tjera fshehin, bllokojnë rrugën e shikimit me errësirë, mjegulla bën të kundërtën- ajo përdor të bardhën, dritën, për të bllokuar dritën. Mjegulla është një dritë që nuk të lë të shikosh.Atje ku e kapte mjegulla, shikmi nuk mund të depërtonte: shihnim vetëm një det të pafund të bardhë. Por kur hiqej mjegulla, pikërisht në ato vende që ajo kishte mbuluar, ndriçimi bëhej dhjetra here më I fuqishëm, gjithçka dukej transparente dhe tepër e ndritshme. Ajri dridhej nga hollimi. Dallohej me shikim të zakonshëm tërë vendi ku kishte qëndruar gjysmë ore më pare mjegulla. Mjegulla e ka ndriçimin , pra, edhe nga ana fizike, por e ka edhe nga ana artistike, nga ana mendore; ajo vihet në shërbim të legjendës pikërisht me fshehjen por edhe për ndriçimin e saj. Mjegulla është një verbërim I përkohshëm, nuk zgjat shumë. Po ai që është I verbër dhe papritur I vjen shikimi, shikon shumë më qartë se të tjerët. Ai e vlerëson më shumëse të tjerët ç'do të thotë të shikosh. Po të lexoni "Verbëria" e Saramangos do ta kuptoni këtë. Pra, "verbëria e mjegullës", nuk është thjesht gjendje fizike, por edhe shpirtërore, një ndiesi që ne nuk dime ta shpjegojmë se nuk kemi përvojën e jetës për të.

Kadare është në favor të legjendës. Meriton vëmendje mënyra se si e shpreh: "Në një vështrim të parë na duket se të gjithë ne do të parapëlqenim motërzimin e parë, atë historik, sepse atje do të gjenim diçka që do të na duhet. Megjithatë, pasi e kënaqim kureshtjen me shifra dhe emra dhe data, ne I kthehemi legjendës së mjegullt. Çfarë ka atje që nuk e gjejmë dot tek historia? Ç'është ajo e fshehtë që rri e ndrydhur veç në dy-tri fraza e ndonjëherë veç më ndonjë mallkim në një fjalë dykuptimshme, ose thjesht një aht! Përse pikërisht ajo, dhe vetëm ajo, mbush një zbrazëti që nuk e mbush dot asgjë dhe shqyen një hapësirë dhe vendos një përkitje ne sfera të parrokshme, që teksti historik nuk I bën dot? (22)

Është pikërisht ajo që thamë: largimi I papritur I mjegullës që lë pas një ndriçim marramendës që nuk mund ta lërë asnjë gjë tjetër. Përpara errësirës së bardhë të mjegullës- pra edhe të legjendës- dhe pastaj përpara ndriçimit të saj të jashtëzakonshëm, sa shtatë diej, çdo fakt, çdo datë, çdo mjet tjetër që përdor historia,do të dukej si hiçgjë. Madje historianët nuk janë të sigurtë se tregojnë të vërtetën.Ka shumë thënie të vrazhdëta për ta. Por ajo më sarkastikja është kjo: " Është thënë se pavarësisht që edhe vetë Zoti nuk mund ta ndryshojë të kaluarën, këtë gjë mund ta bëjnë historianët; ndoshta në këtë drejtim ata mund të jenë të dobishëm për Të dhe Ai e toleron ekzistencën e tyre" (Baleta: "Dilema historike": 2011: 15)

Legjenda është edhe alegori, edhe figurë, ose, thënë më saktë, një konceptim figurativ. Historia është e thatë, e drejtëpërdrejtë, me arsyetime, shpesh edhe bajate, ose me një logjikë të cungur. Shkurt, është e mërzitshme. Kurse mbi legjenedat je si mbi krah mjegullash që nuk dihet nga të çojnë. Imagjinoje veten të fluturosh mbi një pulëbardhë gjigande, e cila, për më tepër, nuk nu di ç'është lodhja. Je I lirë, ke hapësirë të pamasë, nuk ke asnjë kufizim. Pra, liria, hapësira, pangjashmëria me asgjë tjetër, çudia, e thëna dhe e pathëna, të gjitha të mpleksura dhe të gërshetuara bashkë, krijojnë tjetër atmosferë dhe veprojnë mbi ndjenjat tona ndryshe nga ç'vepron historia. Prandaj legjenda na I bën ngjarjet dhjetra herë më të kapshme dhe të besueshme se sa historia. Ditët që ka mjegull janë patjetër ditë me diell. Në ditë të vranëta nuk ka mjegull. Po të ngjitesh në male, në ditët me mjegull, do të shikosh se në lartësi dielli ndriçon si asnjëherë tjetër, ndërsa poshtë, në rrafshinë ose në luginë, kemi oqeanin e bardhë të mjegullës që ka edhe ai ndriçimin e vet verbues, por edhe bllokues.

"Tragjedia antike I trashëgoi të gjitha mitet, legjendat e fantazmat e poemës epike. Hijet e tyre vijnë fuqishëm gjer tek Shekspiri. Asnjë autor tjetër në botë nuk është I afërt me Eskilin, sa anglezi I madh. Ledi Makbeth, Hamleti, fantazma e mbretit, njollat e gjakut në duart e vrasësve, ndërgjegjja e shqetësuar, këto e të tjera si këto janë shembëlltime të Klitemnestrës, Orestit, fantazmës së mbretëreshës dhe vrasjes së famshme të ndërgjegjes, që Eskili e përshkoi I pari në këtë botë që e përfytyronte si një lëng që rrjedh pikepikë në trurin e njeriut.

Romani, në kuptimin e tij të madh, nis pikërisht në kohën e Shekspirit, në një vepër që është poemë epike e roman njëkohësisht- "Don Kishoti". Në trurin e personazhit kryesor bota e tërë është e përmbysur dhe e rindërtuar sipas çmendurisë, do të thoshin disa, e sipas një sitemi tjetër të menduarit, do të thoshin të tjerët. Ëndërra dhe realiteti rrugëtojnë bashkë, njëlloj si në kohën kur truri duhej të ishte dydhomash(-dykameral). Dhe nga të dyja pjesët, në qoftë se për një çast do të pranonim këtë përftim, pjesa legjendare është më zotëruesja dhe, pa dyshim, më tërheqsja" (47) Kadare ndalet tek veprat më të larta të njerëzimit për të na thënë se legjendat japin shumë, tregojnë shumë, flasin shumë. Po këtë ato e bëjnë se gjuha e tyre nuk është ajo e zakonshmja, por gjuha e figurshme.

vijon në numrin e ardhshëm

histori

Çështja e këtij kufini u rregullue vetëm pas çlirimit, në vitin 1944, kur nji komision i posaçëm doli për rregullimin e kufijve ndërmjet Muhurrit, Çidhnës e Matit.

Grindja për kufijtë ndërmjet Zogollit dhe Çidhnës

Se sa fort e kishin marrë fuqinë në dorë tani katundarët përkundra oxhaqeve dhe parive na e tregon bukur anekdota e Has Bulkut, të cilën e quajmë anekdotë, por nji anekdotë që tregon nji ngjarje të vërtetë.

Hasan Bulku ishte i fisit Koltrake, që në atë kohë banonin në Sinjë. Edhe këta shkonin keq e qenë vra me Kaloshët, kështu që u detyruan të shpërngulen. Koltrakët sot banojnë në Kukej e Kastriot, kurse pasardhësit e Has Bulkut, Sulhasanët (Sula, i biri i Has Bulkut), banojnë në nji lagje të Fushë Aliajt, poshtë katundit Blliçe.

Has Bulku ishte shumë i varfër. Në rininë e vet kishte qenë hizmeqar ke sheh Ibrahimi në Borovjan, mendoj bujk ke bejlerët e Vakufit (Hysenagollët). Ai ishte kaq i varfër, sa kur sheh Ibrahimi martoi të birin dhe e grishi, nuk kishte me i dërgue nji dash bakshish simbas zakonit. Tue ecë rrugës, i del nji lepur. Ky nuk iku, por qëndroi në vend me kryet e kthyem nga Hasani, sikur me dashtë me i thanë: "Merrëm mue e çomë në dasëm në vend të dashit!" Hasani e vrau dhe e mori me vete.

- Or i bekue, i tha shehut duke ia vu lepurin përpara. - Ta kam sjellë në vend të dashit! Isha mirë me duer bosh, por për mos me u marrue, ma qiti Zoti përpara këtë lepur. Për hajr të qoftë dasma!

Të gjithë qeshën me këtë shaka të Has Bulkut. Lepurin e futën në kazan. I përzimë me dhjamë dashi, ai ishte ba aq i shijshëm, sa të gjithë kërkonin nji copë prej tij, por ai ishte aq i paktë në atë kallaballëk mishnash, sa quhej me fat të madh ai që gjente nji copë.

Has Bulku kishte nji mik në Macukull të Matit, i cili e grishi në dasëm. Kur hyni mbrenda në konak dhe deshte me varë pushkën, vuri re se të gjithë kunjat ishin mbushë plot e përplot me armë. Vetëm në nji kunj ishte varë tek nji pushkë. Kjo ishte pushka e Zenel Vatës. Ky ishte pari në Macukull, nji burrë me influencë të madhe në të gjithë Matin. Kur Zogolli deshte me ia mbledhë armët Matit, ai i hyni në saraj dhe e vrau. Për këtë arsye i këndohet kanga edhe sot:

...Xheç rahmet or Zenel Vata,
Çi na i lae pushkët e gjata!...

Has Bulku nuk e njihte Zenel Vatën, as nuk e dinte se pushka e varun ishte pushka e tij. E gjeti vendin ma të lirë në atë kunj dhe vari pushkën e vet, por Vata çohet i zemëruem nga vendi dhe i briti:

- A nuk e njeh pushkën e Zenel Vatës?!

Zeneli e mori pushkën e Hasanit dhe tue e përplasë kondakun e saj për muri e ban dy copash. Hasani mbeti në kambë i habitun. I lëshoi nji sy mexhlisit për të kërkue ndihmë, por vuri re se të gjithë e shikonin me urrejtje.

- Nuk e patët me udhë me ia ba nji jabanxhiu (sepse ishte dibran, jo matjan) kështu, - tha dhe duel jashtë me krahë të mbledhun prej frike, prej zemërimi e prej turpi. Shkoi dhe u ul në oborr te shërbyesit e dasmës (kafexhinjtë e gjellbamsit) tue mendue se ç'do të bante për të pague veten. Mat e pre, por nuk i dilte hesapi kurkund. Kur erdhi koha me shtrue darkën, akshitë po mbushnin lengjerët me mish. Njenin nga lengjerët po e rregullonin ma mirë, sepse ishte për sofrën e Zenel Vatës. Në këtë lengjer, Has Bulku rrëmbeu kokën, bishtin dhe shpatullën, ua hodhi qenve dhe iku. Koka, bishti dhe shpatulla quhen shenja burrnie. Në sofër këto do t'i viheshin përpara Zenel Vatës, si i parë i atij vendi. Kur pa legjenin kështu të shëmtuam, ai briti:

- Ku janë raçet e burrnisë?
- I muer Has Bulku, - i thanë.
- Po ju ç'botë?
- Na iku.

Ai u ngrit prej sofre pa hangër bukë. I duhej me marrë hak, por me e ndy çiçin e pushkës së tij të famshme që kishte vra pashën e Matit, në trupin e nji njeriu pa vlerë, bujk e hismeqar, do t'ishte për të nji vepër shumë e ulët. Nji ditë, ai i ra stanit të Sinës, ku banonte Has Bulku dhe rrëmbeu gjithë bagëtinë e këtij katundi. Këtë deshën edhe sinjanët. Këtyne u kishte ardhë në majë të hundës, sepse Zogolli ua kishte vu kufinin pak ma larg se oborret e shtëpive të tyne. Ata e prenë brezin e lisave në Val, por kjo nuk solli ndonji dobi, sepse Zogolli vazhdonte me ngrefë mendër nalt mbi Val, në pjesën e pllajut që i takonte, në Val të Sinës. Duhej me veprue ma me guxim.

Nji ditë u mblodhën rreth katërqind çidhnakë, të cilët vunë të parë Has Bulkun dhe natën, u ranë staneve të Macukullit e të Zogollit bashkë. Ata rrëmbyen 12000 krerë berra dhe jo vetëm këtë, por ngarkuen në kuaj edhe shegat e djathit dhe kusijat, sepse të nesërmen, ku do ta futshin gjithë atë qumësht kur t'i mjelshin dhent? Duke kalue nëpër shkallën e Macukullit u desh që disa deshë t'i hedhin prej shkambit e poshtë në humnerë për t'u lirue rrugën deleve, sepse deshët i kishin brinjët kaq të gjata, sa nuk mund të kalojshin pa i ngatërrue brinjët në atë vend të ngushtë e me zanë rrugën. Qysh prej asaj nate, ky vend u quejt "Shkalla e deshëve" e kështu quhet edhe sot. Kur mbërrin mbi majën e naltë të Valit, Has Bulku lëshoi teposhtë dy kusia të mëdhaja, të cilat tue u rrokullisë me ropamë të madhe atij shpati të naltë lajmëruen sinjanët se u prishën stanet e Zogollit e të Zenel Vatës. Gjithë populli, të mëdhenj e të vegjël vrapoi me pa kusiat në vendin ku ishin ndalë. Qysh prej asaj dite edhe ky vend, quhet "Arat e kusijave". Kumonët e këtyre deshëve deri tani në këto vitet e fundit kanë pasë qenë ruejtë në Sinë.

Pra, ata që shkojnë në Macukull nëpërmjet Shkallës së Deshëve, duhet të kujtojnë Has Bulkun, sepse e ka pasë lanë vetë me gojë:

"Të boni si të boni, ju qi shkoni nëpër "Shkallën e deshëve" të m'kujtoni"!

Edhe ata që u bie rruga nga "Arat e kusijave", duhet ta kujtojnë Has Bulkun, sepse e ka pasë lanë vetë me gojë:

"Ju, qi shkoni kah "Arat e kusijave", n'ato ferra, ta dini se për nji fjalë goje ia kam marrë Zenel Vatës, bishtin, shpatullën, kokën ene 12 000 berra"!

As Xhemal Pasha, as Zenel Vata nuk mundën me e marrë këtë hak. Xhemal pasha u kërkoi çidhnakëve që t'ia kthejnë bagëtinë, por këta i kërkuen të vijë në kanun për të caktue kufijtë. E, mbasi ai nuk i shtrohej kanunit, këta nuk ia ndanë damet. Për të mbrojtë stanet, Zogolli ngriti nji postë me kllukë mbi Val të Sinjës. Çidhnakët, të udhëhequn prej Nure Gjoçit e Ali Hanit prej Çidhnës së Poshtme, e sulmuen këtë postë dhe i përzunë kllukët pas nji beteje të ashpër, duke e çlirue vendin deri në Zhaurr, tek Guri i Vashës e tek Pika e Ujit (kroi i Cikrimit), ku duhet të ishte kufini. Mbas kësaj lufte, për disa vjetë, bjeshkët mbetën pa u shfrytëzue. Në vitin 1902, Xhemal pasha e ndërtoi prapë postën e kllukëve mbi Val dhe ngriti nji stan, por kllukbash aty vu Tafë Tolën prej Çidhne. Ky ishte njilloj si të vesh ujkun të ruajë vathën, sepse Tafë Tola, vërtet ishte sejmen tek Zogolli për të marrë nji rrogë, por për çështjen e kufinit e urrente pashën njisoj si çidhnakët e tjerë. Mbas nji viti, pranë postës, në vendin që quhet Lugjet e Pashës, ai ngrefi nji stan gjoja të vogël, sa për berrat e vet, por vitin tjetër mblodhi aty gjithë dhentë e Sinës e të Arrasit. Zogolli i dërgoi fjalë se duhej me e prishë atë stan, por ai i çoi fjalë se përkundrazi, duhej me u prishë stani i Zogollit. Atëherë, Xhemal pasha dërgoi nji fuqi të madhe dhe e prishi stanin e Tafë Tolës tue rrëmby gjithë bagëtitë që ndodheshin aty. Mbas nji viti, Tafë Tola zgjodhi 40 djem çidhnakë dhe i ra stanit të Zogollit që kishte ngrefë në Pllajë, rrëmbeu 700 berra e i solli në Çidhën.

Qysh prej këtij viti malin e shfrytëzonin ma tepër çidhnakët dhe Zogolli ngrefte stan vetëm po t'i jepej leje. Aliajt dhe Kaloshët, që ishin parí në Çidhën, nuk muerën pjesë në këtë luftë kundër Zogollit. N'at kohë që çidhnakët të bashkuem luftonin kundër Zogollit, ata ishin vra dhe vriteshin me njeni-tjetrin, mbrenda fisit.

Nën mbretërimin e Zogut, Gjeçi, Hani e Tola në Çidhën e pësuen njilloj si Lleshi në Muhurr. Ata nuk pranoheshin as për qeveri, as për xhandarë e jo ma me i futë djemtë nëpër shkolla.

Çështja e këtij kufini u rregullue vetëm pas çlirimit, në vitin 1944, kur nji komision i posaçëm doli për rregullimin e kufijve ndërmjet Muhurrit, Çidhnës e Matit. Ai mbeti po n'at' vend: tek Guri i Vashës, në Zhaur e tek Kroi i Cikrimit. Kështu, fshatarët çidhnakë e muhurrakë e fituen luftën e tyne të gjatë.

KANGA E BATALLIT

Ti Batall[1], o i pahile[2]
Çi po lufton me Mat e Dibër,
Me iltinat karafile.
- Karafilet, kush t'i mori?
- Në saraj aty dibranë!
- Ti Batall, o mjekër gjanë,
Çi bane sejmenët nizamë?
- Ca i kan' vra, ca i kan'zanë.
Në Pazar thirri tellalli:[3]
- Kush mos ardhtë, vaj prej halli,
I shkon gjaja, i shkon malli,
Gjan' e tij e merr Batalli!
- Ti Batall, o mjekër zi,
Çi bone sejmenët hashi?
-Ca i kan' vra e ca i kan' gri!
Veç mos m'prekni n'gra e n'fmi,
Ku t'thoni ju, aty do t'rri!

1. *Riza pashë Zogolli, çalonte shumë dhe ecte si shkatarraq (batall).*
2. *E ironizon. Ai shumë i zgjuar, dinak e hileqar. Kërkonte t'i shtrijë pronat e tij deri në Val të Sinës e në Bulaç mbi Muhurr. Në luftë kundër tij u ngritën Katër Grykët, Çidhna, Muhurri e Luznia. Lufta për çështjen e kufijve do të vazhdojë edhe me Xhemal pashën.*
3. *Në Pazar të Lisit, nxori tellallin për të mbledhur popullin në luftë kundër kryengritësve, por populli nuk e përkrahu dhe ai mbeti keq me një pakicë.*



RRËFIME DHE KËNGË POPULLORE
MUNIR SHEHU
Folklor, këngë epiko-historike, gojëdhëna, histori

Botimet M&B
ISBN 978-9928-256-58-4
Çmimi: 1000 lekë

Librin mund ta gjeni te Botime M&B, Rr. "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9.
Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441 (WhatsApp). E-mail: mbbotime@gmail.com
Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion, #Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së librit në Tiranë.

Rruga e Arbërit nr. 159

kujtesë

Me rastin e 75 vjetorit të rënies

Dëshmorët e Sofraçanit

Nga **ZABIT LLESHI**

Sofraçani si shumë fshatra të Dibrës gjatë një shekulli 1844-1944 është djegur katër herë. Populllsia është masakruar, vrarë e plaçkitur bashkë me atë pak pasuri që kishte grumbulluar në breza.

1- Më 1844 në luftën kundër Hajredin Pashës u vranë disa luftëtarë nga Sofraçani. Fshati u rrënua, u dogj e u kthye në gërmadhë.

2-Në vitin 1899 Turqia pasi sulmoi e shkatërroi gjithçka mori 18 robër për t'i dërguar në Jemen siç thotë edhe kënga:

"Kre për kre me t'vramit e vet,
ka marrë burra tetëmbëdhjet,
e n'Jemen i paska tret..." [1)]

Kënga bën fjalë për luftën e Sofraçanit nën udhëheqjen e Jakup Canit kundër rekrutimit të ushtarëve për t'i çuar në luftën e Jemenit.Në këtë përpjekje u vranë 18 ushtarë turq prandaj mori 18 luftëtarë nga Sofraçani e Gryka e Madhe e i çoi në Jemen. Nga këto u kthye vetëm Hasan Curri, kunati i Jakup Canit nga fshati Dushaj i Bulqizës.

3- Në 1913-1920 u shkretuan të gjitha fshatrat, u vranë 44 veta nga Gryka e Madhe. Populli për këtë u shpreh nëpërmjet vargjeve:

"Sofraçan deri në xhitet,
asnjë shtëpi s'paska met,
nuk pranojmë as pashë, as mbret..." [2)]

4- Gjatë luftës Nacional-çlirimtare, Sofraçani u kthye në një fushë betejë me fashistët italianë dhe gjermanë. Është një fshat strategjik , mund të quhet Porta e Grykës së Madhe sepse vetëm nga Gryka e Sofraçanit mund të futesh në luginën e Zerqanit për të dalë në Bulqizë, drejt Matit e Adriatikut.

Nga ana tjetër fshati është i zbuluar sepse mund ta bombardosh nga kodrat e Çerenecit, Strikçanit e Sopotit. Është e njohur beteja e Sofraçanit më 23 gusht 1943 kundër ushtrisë italiane, disfata më e madhe që pësuan trupat ushtarake fashiste në prag të falimentimit në pritën e organizuar tek Shkami i Hoxhe nga batalioni partizan i Dibrës. Kënga vazhdon me vargjet:

"Del ushtria në Qafë të Hanit,
ç'po qëllon prita e Shkamit,
kërcet shkoza dhe xhiteti,
italianët i xhet gazepi..." [3)]

Brigada e IV Sulmuese, pas operacioneve me sukses në Mat, nëpërmjet Qafë-Murrës e Selishtës, me 12 korrik 1944 zbresin në Gjuras, Zogje, Topojan, Homesh, Sofraçan, Sopot, Strikçan. Më 14 korrik komanda gjermane hedh kundër forcave të brigadës IV Sulmuese grupin "Burgmeiter" dhe batalionin rezervë të Divizionit fushor në drejtimin Dibër e Madhe – Bulqizë, duke sulmuar pozicionet e asaj brigade në Homesh e Sofraçan.

Këshilli Nacional Çlirimtar (Ramiz Roçi e Bajram Cani) nisën veprimtarët Merdan Roçi e Rustan Cani për në Kaptinë të Martaneshit. Ata shoqëruan disa anglezë të kapur robër deri në Varre Vrame, atashur pranë Abas Kupit, ndërsa Skënder Cani do të shoqëronte në Teqen e Bllacës një partizan të plagosur, bashkë me një letër për shtabin partizan, që ndodhej aty ku shpjegohej rreziku i ndonjë sulmi eventual në drejtim të fshatit Sofraçanit.[4)]

Mbas dite një kolonë e madhe gjermane, bashkë me forca të tjera të xhandarmërisë shqiptare e armatosur me artileri të rëndë, vendoset në Kodrat e Çerenecit. Prej këtu niset në 3 drejtime:

1-Një pjesë e forcave nisen nga Bregu i Zallit Bulqizë në Shupenzë - Homesh, për t'u pykëzuar në Bllacë, me objektiv t'i presin rrugën forcave të brigadës IV Sulmuese, për t'u futur në thellësi të Dibrës.

2- Kolona e dytë, e përbërë kryesisht nga xhandarë (forca të reaksionit) kundër luftës Nacional-çlirimtare, morën rrugën nga Sopoti për të sulmuar në befasi Zerqanin.

3 - Kolona e tretë mori detyrën të mësynte Sofraçanin, prandaj ajo u ul nga Kodrat e Çerenecit erdhi në Bregun e Zallit Bulqizë, duke pritur muzgun, për t'a futur në patkua fshatin. [5)]

Mehmet Deda, një veprimtar i Luftës Nacional-çlirimtare ishte nisur për të marrë kalin në livadhin pranë Vanishtës buzë Zallit. Aty ndeshi me ushtarët gjermanë, të cilët e lidhën. Nën kërcënimin e bajonetave, me Metin përparа, gjermanët rrethuan fshatin, ndërkohë fatin e Metit e pësoi Shaqir Lila. Ngadalë dhe pa zhurmë, erdhën përpara shtëpisë Ramadan Canit.



Plaku i Canajve para shtëpisë dëgjoi nga rruga lëvizje hapash. Ktheu kokën dhe pa se bishat po shtynin Metën, të cilit i vunë tytat e armëve në gjoks dhe i vendosën në krahë të njëri-tjetrit.[6)] Në grackë ra edhe Qerim Hoxha. Kështu u rrit në katër numri i të arrestuarve. Artileria filloi bombardimet, kryesisht në Shkamin e Sofraçanit, nga Kodrat e Cerenecit.

Historia përsëritet disa herë brenda një shekulli: bombardohet Sofraçani nga turqit, serbët, italianët dhe tashti nga gjermanët. Fshati filloi lëvizjen për mbrojtje. Shkami Sofraçanit ka qenë strehë e përhershme. Gjatë lëvizjes për strehim, hasën me ushtarët e lufta u zhvillua deri trup me trup. Goditja e befasishme nuk ju dha kohë të organizoheshin dhe të bashkoheshin me partizanët, që kishin zënë pozicionet në Qafën e Sofraçanit. Fshatarët e marrë peng, po rezistonin. Mehmeti u bën me dije shokëve se gjermanët po pregatiteshin t'i pushkatojnë.

Mendojnë se si mund të shpëtojnë nga armiqtë, që veç forcës, nuk kishte rrugë tjetër. Atëhere Shaqiri i jep një goditje me shkelm gjermanit e në përleshje e sipër, bashkë me Qerimin shpëtojnë nga kthetrat e agresorit. Por, Ramadani goditet me bajonetë në shpatull e kraharor, ndërsa mbi Mehmetin u derdhën një breshëri plumbash. Pjesa tjetër e ushtrisë mblodhi burrat e fshatit në livadhe të thata. Tridhjetë burra i lidhën, i izoluan 24 orë, pa bukë e ujë. Gjatë kontrolleve të befasishme, pasi dogjën 22 shtëpi të fshatit, nga 35 që ishin gjithsej, u kapën Ali Gjaci, Hysni Gjaci, Ismail Lila e Ibrahim Seferi, të cilët i pushkatuan në Zabelet e fshatit Vlashe. Fashistët nuk kursyen as gratë: dogjën të gjallë Seline Roçin në shtëpinë e saj.

Fshatarët e arrestuar, i morën nga Qafa e Sofraçanit, Qafë- Vlashe e në Homesh i izoluan në oborin e familjes Dema mbushur plot me robër tjerë. Hysni Dema doli garant para gjermanëve, duke u shprehur se janë fshatarë, nuk kanë lidhje me partizanët. Ata u lanë të lirë, shkuan pranë familjeve, organizuan ceremoninë e varrimit të shokëve të vrarë. [7)]

Bilanci i luftimeve ishte 7 të vrarë, 30 të arrestuar, disa të arratisur 22 shtëpi të djegura, shumë bagëti të asgjësuara. Viktimë e luftës njihet edhe Selvije Roçi, e cila u dogj në shtëpi, ishte edhe shtatzënë. Masakër e vërtetë, që tregon se gjermanët nuk erdhën si kalimtarë apo çlirimtarë, siç pretendojnë disa pseudohistorianë, por si pushtues.

Sofraçani si shumë fshatra të Dibrës gjatë një shekulli 1844-1944 është djegur katër herë. Populllsia është masakruar, vrarë e plaçkitur bashkë me atë pak pasuri që kishte grumbulluar në breza.

MEHMET ABAZ DEDA

Lindi më 1892 në një familje të varfër me të kaluar atdhetare. Në moshë të re ai përcolli ngjarje të rëndësishme siç ishin ato të kryengritjeve të mëdha të viteve 1910-1912, gëzimin e madh të shpalljes së pavarsisë së Shqipërisë etj. Me pushtimin e Dibrës nga ana e pushtuesve austriakë, Mehmet Deda merret forcërisht ushtar dhe e kryen këtë shërbim në një periudhë të trazuar të luftës së parë botërore në vitet 1917-1918 larg atdheut në Austri.

Pas mbarimit të shërbimit ushtarak erdhi pranë familjes dhe u muar kryesisht me bujqësi. Mbështeti fuqishëm luftën e madhe Nacional-çlirimtare duke u bërë edhe vetë pjestarë i çetës së Grykës së Madhe.

Më 14 gusht të vitit 1944 mori detyrën për të dërguar një porosi forcave partizane në Vorret e Vrame. Kur po zbriste poshtë për të marrë kalin u arrestua nga gjermanët. Me të ardhur në fshat e arrestuan bashkë me Ramadanin, Qerimin e Shaqir Lilën. Katër të arrestuarit i kërcënuan për vdekje. Mehmeti u tha bashkëfshatarëve se po përgaditen të na pushkatojnë. Ai i kuptonte disa fjalë gjermanisht. Rezistuan forcërisht por pa sukses. Ata vranë Mehmetin e Ramadanin. Me vendim Nr 147, datë 31/12/1972 Mehmet Deda është shpallur "Dëshmor i Atdheut", më i moshuari dëshmor i Sofraçanit.[8)]

RAMADAN JAKUP CANI

Lindi më 1889. Për më shumë se një shekull gjyshi Sulejmani dhe baba i tij Jakupi ishin ndër kundërshtarët kryesor në Grykën e Madhe kundër reformave të Tanzimatit e deri tek ata turqëve të Rinj më 1908. Në rrethet patriotike të Dibrës Jakup Cani njihet si përkrahës i Lidhjes së Prizrenit, i luftës për arsim e shkollë shqipe, bashkëluftëtar i Mersim Demës, Sul Shehut, Destan Pucës në lëvizjet e mëdha për pavarsinë. Udhëheqës i çetës kundër turqëve e serbëve. Mbrojti Qeverinë e Lushnjës, pjesmarrës në lëvizjen e marsit 1922 dhe i revolucionit demokratiko borgjez 1924.

Ramadani ishte rregjistruar në çetën e Grykës së Madhe.Mori pjesë në luftën për çlirimin e Zerqanit, 3 gusht 1943, në luftën e Sofraçanit që u zhvillua më 23 gusht 1943. Ishte ekspozuar për veprimtarinë e tij prandaj ishte këshilluar prej shokëve të ruhej dhe të tregonte kujdes gjatë lëvizjeve nëpër Zerqan apo në fshat. Shtëpia e tij bazë e luftës nacional-çlirimtare. Djali i tij, Arifi, u vra në luftën italo-greke më 1940.

Pas kapitullimit të Italisë fashiste erdhën gjermanët. Më 14 gusht ato sulmuan Sofraçanin. Pas arrestimit të Mehmet Dedes sapo u futën në fshat arrestuan Ramadanin dhe afër Livadheve të Thata e vranë bashkë me Mehmetin, dy atdhetarë të flaktë, ndërkohë dogjën shtëpitë e tyre të parat. Ramadani është shpallur me vendim Nr 50 datë 30/06/1972 "Dëshmor i Atdheut". Ai prehet në varrezat e dëshmorëve në Peshkopi.

IBRAHIM MYSLIM SEFERI

Lindi më 1922 në një familje që u dallua për trimëri, besë e bujari. Ajo priti e përcolli udhëtar e luftëtar nga Gryka e Vogël, Luznia, Gryka e Madhe e Bulqiza. Mbaroi tre vjet të shkollës fillore në Zerqan, pastaj si gjithë moshatarët e tij u muar me bujqësi. U rrit jetim sepse nëna u nda nga jeta në moshë shumë të re. Është nip i oficerit fanolist Muharrem Dervishi nga Krajka. Simpatizant i luftës për liri dhe pavarsi. Shkonte në çetën e Grykës së Madhe sa herë thirrej në luftra apo aksione të ndryshme. Mbante lidhje të përhershme me Ramadan Canin e Këshillin nacional-çlirimtar. Kur gjermanët mësyjnë fshatin ishte në shtrat shumë i sëmurë megjithatë doli e arrestuan dhe vranë në Qafën e Vlashajve. Është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Eshtrat e tij prehen në varrezat e dëshmorëve në Peshkopi. (Fadil Toçi, kujtime, 02/04/2019).

HYSNI SELIM GJAÇI

Rrjedh nga një familje fshatare e varfër, i datëlindjes 1921. I ati Selimi ishte një patriot dhe burrë i zgjuar. Kishte marrë pjesë në luftën kundër serbëve, austro hungarezëve. Përkrahu revolucionin e qershorit 1924. Shkollën fillore Hysniu e mbaroi në Zerqan. Punoi pak vite në bujqësi .Si familje kishte marrëdhënje shumë të mira në fshat, ishin njerëz puntorë e humanë. Pas arrestimit dogjën shtëpinë dhe rrënuan gjithçka. Merret forcërisht me gjithë rezistencën trup me trup me ushtarët gjermanë të shumë të numër dhe të armatosur gjer në dhëmbë, duke u gdhirë 15 korriku 1944 pushkatohet me tre bashkëfshatarë të tjerë nga Sofraçani në Qafë të Vlashajt. Është shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim Nr 147, datë 31/12/1972.

ISMAIL HASAN LILA

Lindi në Sofraçan më 1915 në një kohë kur Shqipëria ishte një arenë lufte siç ishte ajo e luftës së parë botërore. U rrit në varfëri dhe u muar kryesisht me bujqësi. Gjatë periudhës së mbretërisë së Zogut u përpoq të gjej punë në Dibër të Madhe, në Tiranë dhe Durrës por nuk u bë e mundur. Pushtimin italian dhe gjerman e priti me shqetësim të madh, prandaj luftën e tij e bashkoi me atë të çetës partizane të Grykës së Madhe e Bulqizës.Me të marrë sinjalin për futjen e forcave gjermane në fshat, ndonëse tentoi të lajmëronte njerzit të largoheshin drejt shkëmbit dhe qafës së Sofraçanit , për tu bashkuar me partizanët u arrestua. U pushkatua në Qafë të Vlashajt më 15 korrik 1944. Edhe një dëshmor tjetër iu bashkua armatës së madhe të dëshmorëve të luftës nacional-çlirimtare. Është shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim Nr 147, datë 31/12/1972.

ALI MEHMET GJAÇI

Dita e 15 korrikut të vitit 1944 do të ishte dita fatale për jetën e 24 vjeçarit Ali Gjaçi. U rrit në një familje me të kaluar patriotike. Sofraçanasit asnjëherë nuk u pajtuan me pushtuesit por luftuan gjatë kundër turqëve, serbëve,bullgarëve etj.

Në kohë paqeje u endën rrugëve të botës për punë në Ohër, Manastir, Selanik e deri në Stamboll. Aliu kishte provuar luftën kundër fashitëve italianë tek shkëmbi i Hoxhajve. Shtëpia e tij kishte pritur luftëtarë të brigadave partizane. Arrestohet nga gjermanët dhe pushkatohet me dy shokë të tjerë në Qafë të Vlashajve. Emri dhe vepra e tyre do të kujtohen e nderohen brez pas brezi. Është shpallur "Dëshmor i Atdheut" me vendim Nr 147, datë 31/12/1972.

Populli, si kudoherë, nuk u pajtua edhe me pushtuesit, pavarësisht nga demagogjia. Përkundrazi, nuk e pushoi luftën për mbrojtje të Atdheut, lirisë e pavarësisë së tij.

Dëshmorët e Sofraçanit dhanë jetën jetën për lirinë, që gëzuan brezat pas rënies së tyre. Ata do të mbeten në zemrat dhe mendjet e banorëve të Grykës së Madhe e të mbarë popullit tonë.

REFERENCA

1. Këngë kushtuar luftës më 1899, kundwr pushtuesve turq.
2.Vargje të thurura nga populli kushtuar luftës kundër serbëve.
3-Popullore, kushtuar luftës kundwr italianwve, tek Shkambi i Hoxhe, më 23 gusht 1943.
4. Skwnder Cani, vjeç 80, kujtime. Dorwshkrim 2007.
5 Rakip Caka, gazeta "ushtima e maleve", 14 korrik 1984
6. Rakip Caka, po aty.
7. Bajram Cani, kujtime të mbledhura nga Nazmi Koçi, dorwshkrim.
8. Mehmet Deda - rob i Luftës së Parë Botërore, kthyer në fshat më 1918. Kreu ushtrinë në Austri.

homazh

Ndërron jetë **përfaqësuesi** i shquar i **komunitetit dibran** në Tiranë **z.Luan PUSTINA**

Ka ndëruar jetë në moshën 85 vjeçare, z. Luan Pustina, një përfaqësues i nderuar i komunitetit dibran në Tiranë, ish-anëtari i kryesisë së Shoqatës "Bashkësia Dibrane".

Luan Pustina u lind më 23 tetor 1934 në Tiranë. Vinte nga një familje me tradita të shquara atdhetare të qyteti të Dibrës së Madhe. Stërgjyshi i tij udhëhiqte lëvizjen e madhe anti-osmane të fundit të shekullit XIX. Në këngët popullore, për trimërinë e tij, ai cilësohej si "Nurçe Levendi Pustina", pasi fjala e tij zinte vend në parinë dibrane.

Gjyshi i Luaniti, Ali Pustina, ishte ndërlidhës i krahinës së Dibrës me atë të Aqif Pashë Elbasanit dhe me Vlorën e Ismail Qemalit, në përpjekjet shembullore të dibranëve gjatë viteve '12-'15 të shekullit të kaluar, për të mos ua lëshuar trojet dibrane serbëve, deri sa u vra prej tyre në 1915.

Gjate periudhës së diktaturës familja e Luanit u konsiderua si e deklasuar, për arsye se para çlirimit dajat e tij, vëllezërit Shijaku, ishin tregtarë të mëdhenj dhe i ati ishte oficer në Mbretërinë Shqiptare. Luani mbaroi Teknikumin Financiar të Tiranës në vitet 1947-1950 duke qenë kontigjenti i parë që përgatiste kjo shkollë në Tiranë. Menjëherë pas kësaj ai nisi një karrierë të vlerësuar në institucionet shtetërore dhe në ekonomi të bazës. Pas dy viteve punë në Komisionin e Planit të Shtetit, me 1952, transferohet në Ministrinë e Financave me detyrën e revizorit. Në vitin 1954 shkëputet nga puna për të ndjekur Fakultetin Ekonomik. Në vitin 1958 mbaron studimet me rezultate shumë të mira.

Menjëherë pas shkollës së lartë emërohet në seksionin e financës të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, me detyrën e kryeinspektorit të financimit, detyrë që i jepte mundësinë të ndiqte problemet ekonomike, financiare e kontabile të ndërmarrjeve më të rëndësishme të kryeqytetit.

Luani ishte i pari ekonomist i vendit që analizoi të dhënat e 10 ndërmarrjeve të industrisë së lehtë në Tiranë, duke konkluduar mbi pasojat e rënda ekonomike të vlerësimit të veprimtarisë së ndërmarrjeve sipas treguesit unik të vlerës globale.

Duke analizuar investimet që bëheshin në qytetin e Tiranës, Luani vinte re mungesën e analizës paraprake të rentabilitetit të tyre. I tillë ishte rasti i fabrikës së bukës, e ngritur në një cep të qytetit, që ishte me kosto të lartë transporti. Ngritja më pas e 6 gryksheve në çdo zonë të qytetit e rregulloi këtë anomali.

Pas përfundimit të planifikimit buxhetor për ngritjen e Parkut të Madh të Tiranës në kodrat e Liqenit Artificial, në vitin 1970 nisi aktivizimi i Luanit në kooperativat bujqësore të Tiranës, fillimisht në zonën kodrinore të Dajtit, më pas deri në vitin 1979 në kooperativën bujqësore të Pezës. Shumë shpejt, kjo kooperativë, një nga më të mëdhatë e vendit, me pesë mijë punëtorë, dhjetë sektorë dhe njëqind e gjashtëmbëdhjet brigada, arriti rezultate të larta ekonomike e financiare, ku spikaste puna novative dhe reformatore e ekonomistit të talentuar Luan Pustina.

Gjate punës së tij i është dashur të përballet me shumë sfida, që regjimi i kohës i vinte përpara, me shfrytëzimin e kapacitetit të tij, sepse ishte i aftë t'u jepte zgjidhje konkrete problemeve të shumta të ekonomisë.

Studimin për problemet e zhvillimit demografik të rrethit të Tiranes, (i përmasave të mëdha dhe i vëzhgimeve të shumta që duheshin bërë), e realizoi për 9 muaj, në 150 faqe, 80 tabela të plotësuara me përfundime e konkluzione, si dhe vlere aplikative. Profesionalizimi i lartë i kryerjes së studimit ka bërë që disa shkencëtarë shqiptarë i janë referuar këtij studimi në kumtesa e tyre jashtë shtetit.



Veprimtaria e këtij personaliteti nuk mund të kuptohet pa punën që bëri ai si përfaqësues i shoqatës italiane të voluntariatit, e cila asistoi në Shqipëri nga viti 1994 dhe vazhdon edhe sot punën e saj. Në këtë periudhë ai realizoi mbi 250 misione në komuna, bashki...
Luani ishte një njohësi i mirë dhe i thellë i historisë dhe veçanërisht asaj të trevës së Dibrës.

Jetëshkrimi i këtij njeriu nuk do të ishte i plotë, po të mos shënojmë se gjatë kësaj periudhe Luan Pustina ka referuar në shumë konferenca shkencore në Tiranë, në Vlorë, Gjirokastër, Sarandë. Me ftesë personale ka referuar në Milano, Torino, Savona dhe në mars 2011 në Sardenja me tematiken: "Ku investohet në Shqipëri."

Veprimtaria e këtij personaliteti nuk mund të kuptohet pa punën që bënë ai si përfaqësues i shoqatës italiane të voluntariatit, e cila asistoi në Shqipëri nga viti 1994 dhe vazhdon edhe sot punën e saj. Në këtë periudhë ai realizoi mbi 250 misione në njësi ekonomike, komuna, bashki, institucione qendrore dhe njësi private, duke dhënë ndihmë falas në 11 fusha të jetës ekonomiko-shoqërore e kulturore të vendit. Luani ishte një njohësi i mirë dhe i thellë i historisë dhe veçanërisht asaj të trevës së Dibrës.

Mbi tavolinën e punës së Luanit gjen projekte me interes aktual dhe perspektiv për vendin. Mirëpo në shtator 1997, me ndryshimet në qeverisje Luani nxirret në pension, pavarësisht nga projektet që kishte gati.

Ishte një nder themeluesit e Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë që më 25.12.1992 dhe anëtar i kryesisë së saj për vite me radhë.



BASHA: LUAN PUSTINA ME PUNË U KA LËNË BREZAVE TË ARDHSHËM NJË TRASHËGIMI TË FUQISHME

Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë z. Lulzim Basha, i shoqëruar nga Kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane" z. Bujar Kapexhiu, zhvilluan një vizitë në shtëpinë e të njerit Luan Pustina, ku u takuan me familjarët e tij.

Ato u takuan dhe ngushëlluan bashkëshorten e të ndjerit, znj.Gjyltere dhe dy vajzat Andia dhe Laura Pustina, të shkencëtarit, humanistit dhe njeriut model të shoqërisë tonë, Luan Pustinës, i cili ka kontribuar me mjaft mendime të vyera, projekte studimore, ekonomiko-sociale mbi Rrugën e Arbrit etj.

Zoti Lulzim Basha, e quajti humbje të madhe ndarjen nga jeta të intelektualit Luan Pustina, i cili me punë, i ka lënë brezave të ardhshëm një trashëgimi të fuqishme, për të luftuar me intelekt varfërinë, prapambetjen, për të vendosur arsyetimin mbi padrejtësisë. Ai ishte shembulli model i një prindi të nderuar, e që me egon e tij krijoj një shoqëri të veçantë dhe u dallua për projektet të dobi të komunitetit dibran të Tiranës, në studime mbi volontariatin shqiptar, në nisma bamirësie, pjesëmarrës në dhjetëra konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në sesione shkencore, theksoi z. Basha.

Ndërsa kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", z. Bujar Kapexhiu vlerësoj shumë punën e pakursyer dhe të palodhur të Luan Pustinës, figurë që transmetonte vetëm mirësi dhe pozitivitet.

Nën gjurmët e tij, komuniteti dibran, njeh mjaft arritje në realizime aktivitetesh, konferencash dhe sesione shkencore mbi genocidin serb në trojet Shqiptare, projekti ekonomiko-social mbi Rrugën e Arbrit etj.

Ndërsa znj. Gjyltere, vlerësoj kontributin e Luanit si bashkëshort e si prind model në edukimin e fëmijëve e brezave të ri. Ai u largua nga kjo botë, me mjaft projekte të parealizuara. Dy vajzat e z. Luan Pustina, Andia dhe Laura, vlerësuan vizitën e z. Lulzim Basha dhe i përcollën atij respektin e veçantë që babai i tyre kishte për të.

Gjthashtu ato morën anglazhim që të gjitha materialet studimore, problematikat me karakter ekonomik dhe social, të Luan Pustinës ti botojnë në një vëllim shkencor i cili do të mbaj emrin e tij, e që do të promovohet në bashkëpunim me shoqatën "Bashkësia Dibrane" në një akademi solemne.



Homazh për shkencëtarin dhe studiuesin **prof. dr. Agim Pirdeni**

Ishte lajm i hidhur ndarja nga kjo jetë e një tjetër biri të nderuar të komunitetit dibran të Tiranës, të një personaliteti të veçantë të fushës së paleontologjisë Shqiptare, Prof. Dr. Agim Pirdeni.

Shkencëtari Agim Pirdeni rrjedh nga një familje e nderuar me prejardhje nga Dibra e Madhe, ku prindërit e tij, si pasojë e genocidit sllav, largohen nga Dibra e Madhe në shtatorin e vitit 1913 duke u vendosur përfundimisht në Tiranë.

Agim Pirdeni, ka një kontribut gati 50 vjeçar në fushën e shkencës së gjeometrisë, zbulimeve dhe të paleontologjisë urbane. Ai hodhi themelet e kësaj shkence, duke kryer studime në çdo cep të Shqipërisë, duke përgatitur breza të shumtë studentësh e duke udhëhequr disertacionet dhe tezat e tyre.

Ka shkruar një serë artikujsh shkencor e akademik, mbi shkollat e larta, si "Paleontologjia dentare në vitin 1987", "Paleontologjia urbane", studim mbi "Mikrofaciet dhe foraminiferet bentonike triasike ne Albanide", 1988 etj.

Ai mbylli sytë në moshën 76 vjeçare, duke lënë pas bashkëshorten Ermira Pirdeni dhe dy djemtë e tij. Trupi i tij u varros me të gjitha nderimet në qytetin e Riminit, Itali, më 28 korrik 2019 nga bashkëkombas, miqtë dhe të afërmit e tij.

Ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit **<rrugaearberit@gmail.com>**
Një pajtim vjetor kushton: **Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD**. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Peshkopi Bigmarket

DI ÇFARË ZGJEDH!

OFERTAT JANË TË VLEFSHME NGA

8-13 GUSHT

Gëzuar Kurban Bajramin!



AGRIFORM GRANA PADANO 50 GR — ~~125~~ 99 Lekë

AGRIFORM GRANA PADANO 100 GR — ~~240~~ 199 Lekë

AGRIFORM GRANA PADANO 150 GR — ~~420~~ 330 Lekë

AGRIFORM GRANA PADANO RISERVA 250 GR — ~~650~~ 559 Lekë

AGRIFORM PROVOLONE 200 GR — ~~390~~ 270 Lekë

GRAN PRIMO DJATH MIX 100 GR — ~~199~~ 149 Lekë

AGRIFORM PARMIGIANO 70 GR — ~~280~~ 199 Lekë

GALBANI DJATH ME FETA 200 GR — ~~299~~ 239 Lekë

NEGRONI SALCICE PULE 100 GR — ~~85~~ 59 Lekë

NEGRONI PANCETTA DOLCE E TYMOSUR 140 GR — ~~250~~ 199 Lekë

MOZZARELLA 130 GR — ~~150~~ 99 Lekë

MOZZARELLA DIAMOND 250 GR — ~~250~~ 199 Lekë

NEGRONI ARROSTO GJELI 100 GR — ~~159~~ 129 Lekë

NONNA TORTELINI TE MBUSHURA GJIZ /SPINAQ / MISH /PROSHUT 250 GR — ~~150~~ 99 Lekë

PITA EXCELLENT 10 PC — ~~150~~ 129 Lekë

PANE PER TRAMEZZINI 250 GR — ~~199~~ 159 Lekë

CASA DELLA PIADA 420 GR — ~~150~~ 99 Lekë

CRM SFOGLIATA 300 GR — ~~180~~ 129 Lekë

MULINO BIANCO PANCARRE 285 GR — ~~195~~ 125 Lekë

MULINO BIANCO FETTE INTEGRALE 315 GR — ~~199~~ 159 Lekë

NUTELLA ÇOKOKREM 600 GR — ~~570~~ 499 Lekë

ANTONELLI KROASANT 400 GR — ~~250~~ 199 Lekë

MIDI KROASANT 500 GR — ~~330~~ 279 Lekë

KINDER COLAZIONE T10 — ~~420~~ 359 Lekë

RAFFAELLO T15 — ~~420~~ 359 Lekë



DONNA CHIARA MAKARONA 500 GR — ~~75~~ 49 Lekë

COCA COLA 1.5 LT + 330 ML — 1+1 — 149 Lekë

CALVE MAJONEZE 500 ML — ~~189~~ 149 Lekë

BALOCCO BISKOTA 700 GR — ~~220~~ 189 Lekë

PALMOLIVE SHAMPO 350 ML — ~~135~~ 99 Lekë

LENOR DETERGJENT ZBUTES 1.9 LT — ~~450~~ 299 Lekë

DASH DETERGJENT 105 LARJE — ~~2290~~ 1849 Lekë

FAIRY DETERGJENT 800 ML — ~~185~~ 159 Lekë

AJAX DETERGJENT XHAMASH 750 ML — ~~210~~ 169 Lekë

MASTRO LINDO DETERGJENT BANJO 950 ML — ~~190~~ 129 Lekë

LAEN DETERGJENT ENESH 1 LT + 500 ML — 1+1 — 199 Lekë

EPTA DETERGJENT ZBARDHUES 2.5 LT + 1 LT — 1+1 — 199 Lekë

FABULOSO ZBUTES 1.5 LT — ~~350~~ 199 Lekë

CERTO ZBUTES 4 LT — ~~320~~ 279 Lekë

UP DETERGJENT 4 LT — ~~420~~ 349 Lekë

PERWOLL DETERGJENT 2.7 LT — ~~749~~ 659 Lekë

MEGA MAX DETERGJENT 3 KG — ~~350~~ 289 Lekë

BINGO DETERGJENT 2 KG — ~~320~~ 269 Lekë

BIOAKTIV DETERGJENT 3 KG — ~~420~~ 349 Lekë

ARIEL DETERGJENT 15 PC — ~~599~~ 499 Lekë

ARIEL DETERGJENT 1.1 LT — ~~599~~ 499 Lekë

ARIEL DETERGJENT 2 KG — ~~599~~ 499 Lekë

Kurban Bajrami vjen me *Super Oferta*

Big Market Peshkopi

Big Market | www.bigmarket.al | Shërbimi ndaj Klientit: bigmarketo□cial1@gmail.com



cyan magenta yelloë black